



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 12 regjistër (JR)
Datë 15.03.2023

Nr. 3 i vendimit
Datë 29.01.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 29.01.2024, ditën e hënë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 12/2023 (JR), datë 15.03.2023, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike, Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet në ankim të Komisioneres Publike Irena Nino, si dhe konkluzionet përfundimtare nëpërmjet të cilave ajo kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, si dhe shqyrtoi parashtrimet e konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, e cila kërkoi

mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri, ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duke qenë se u gjend në këtë funksion në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuar me ligjin nr. 76/2016, ajo u përfshi në rrethin e subjekteve që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas së cilave:
 - 2.1. ILDKPKI-ja¹, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. DSIK-ja², në përfundim të procesi të kontrollit të figurës, i ka përcjellë Komisionit shkresën nr. {***} prot., datë 24.01.2022, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, dhe ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.
 - 2.3. KLP-ja³ ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor. Pas rishikimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, ku për secilin nga aspektet e aftësive profesionale e ka vlerësuar subjektin “shumë mirë”.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Pas zhvillimit të procesit të rivlerësimit për të tria kriteret, bazuar në gërmën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 606, datë 21.12.2022, Komisioni ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri. Në mënyrë kumulative, Komisioni ka vlerësuar se subjekti:
 - (i) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të gërmës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016;

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 18.10.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mariola Mërtiri”.

² Dërguar me Raportin e DSIK-së (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 21.01.2022, të KDZh-së) dhe shkresën nr. {***} prot., datë 24.01.2022.

³ Raporti i KLP-së nr. {***} prot., datë 19.05.2022, “Raport për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri”.

- (ii) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara nga germa “b” e pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016; dhe
- (iii) ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, pika 1 e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

II.1. Gjetjet e paraqitura nga ONM-ja gjatë hetimit administrativ të Komisionit

4. Gjatë hetimit administrativ në Komision, janë administruar tri gjetje të vëzhguesit ndërkombëtar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), që lidhen me informacione për të tria kriteret e rivlerësimit të subjektit dhe konsistojnë në:

5. *Gjetja 1 – nr. {***} prot., datë 15.07.2020*

5.1. Për kriterin e vlerësimit të figurës:

(i) mosdeklarimi i një kontakti të papërshtatshëm në formularin e DSIK-së;

(ii) të dhëna në lidhje me marrëdhëniet e vazhdueshme shoqërore, familjare e të biznesit të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit të saj dhe të krushqisë së nivelit të dytë, me personat dhe shoqëritë e hetuara nga SPAK;

(iii) punësimi i bashkëshortit që prej vitit 2018 deri në maj 2022 nga “{***}” ShPK, në një pozicion pune të rëndësishëm;

(iv) përveç angazhimit të hershëm, të ngushtë e të vazhdueshëm me personat dhe shoqëritë e përmendura më lart në aktivitete biznesi, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë përdorur automjetet e z. A. M. dhe z. K. Z. gjatë viteve 2019-2020.

5.2. Për kriterin e vlerësimit profesional:

(i) subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në procedimet penale me nr. {***} dhe nr. {***}, me palë shoqërinë “{***}” ShA, ku bashkëshorti i saj ishte i punësuar;

(ii) në procedimin penal nr. {***}, subjekti ka treguar mangësi që duhet të vlerësohen në aspektin profesional.

5.3. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Vëzhguesi Ndërkombëtar ka kërkuar nga Komisioni:

(i) të verifikohet ligjshmëria e të ardhurave të znj. S. G. për të zgjeruar kapitalin bazë të shoqërisë “{***}” ShPK;

(ii) të verifikohet ligjshmëria e burimit të krijimit për shoqëritë e themeluara/administruara nga z. M. M. dhe z. E. M.;

(iii) të verifikohet ligjshmëria e burimit të krijimit të automjetit tip “Audi”, blerë në vitin 2004 me çmimin 4.800 euro, në emër të bashkëshortit;

(iv) të verifikohet nëse çmimi i apartamentit në Fier në vitin 2012 ishte preferencial;

(v) të verifikohet nëse subjekti dhe bashkëshorti i saj plotësonin kriteret ligjore për të marrë një kredi me kushte lehtësuese për blerjen e apartamentit në Fier, veçanërisht duke pasur parasysh të dhënat e deklaruara dhe të administruara për të ardhurat dhe aksionet e bashkëshortit nga 2003-2011;

(vi) të verifikohet nëse shpjegimet e subjektit për huanë që i dha vjehri janë të besueshme;

(vii) të verifikohet nëse çmimi prej 78.800 eurosh për apartamentin prej 127,6 m², porositur në mars 2017, ndodhur tek {***}, në Tiranë, krahasuar me kontrata të tjera të ngjashme në të njëjtën zonë/ndërtesë, ishte apo jo preferencial.

6. Gjetja 2 – nr. {***} prot., datë 06.10.2022

6.1. Për kriterin e kontrollit të figurës:

(i) duhet të analizohen lidhjet e subjektit të rivlerësimit dhe/ose bashkëshortit të saj me z. K. Z.;

(ii) udhëtimi i subjektit me znj. S. G. në vitin 2016, duhet të analizohet lidhur me të dhënat e tjera.

6.2. Për kriterin e vlerësimit profesional:

Procedimet penal me palë/të kallëzuar Bashkinë Fier janë zhvilluar në kushtet e konfliktit të interesit.

6.3. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

(i) Ndikimi në analizën financiare të z. M. M. i: (a) investimeve në aksione në vlerën 4 milionë lekë në shoqërinë “{***}” ShA, dyshohet se i është shitur për 400 mijë lekë një aksionari tjetër; dhe (b) i investimit prej 6 milionë lekësh për 60% të aksioneve në shoqërinë “{***}” ShA, nga z. K. M./M. M. gjatë viteve 2002-2006 dhe kapitali i kthyer z. K./M. M. pas likuidimit të shoqërisë në shumën përafërsisht 2.7 milionë lekë;

(ii) Identiteti i z. M. M. (administrator i shoqërisë “{***}” ShA, i datëlindjes 08.08.1978, i biri i T., banues në Fier) kundrejt z. K. M. (aksionar i shoqërisë, me të dhëna identike si z. M. M.), siç konstatohet në aktet e shoqërisë, si administrator i shoqërisë vepronte z. E. M., në momentin që z. M. M. paraqitej me këto të dhëna;

(iii) Problematikat eventuale etike që kanë të bëjnë me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj lidhur me pagën e deklaruar të tij në deklaratën e pasurisë *vetting* kundrejt asaj të deklaruar para organeve tatimore, për burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit tip “Audi”, në vitin 2004, kur vepronte si administrator i shoqërisë “{***}” ShA;

(iv) Verifikimi i plotësimit të kriterëve të përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese;

(v) Ndikimin në analizën financiare të vjehrit, z. T. M., për shumën 4 milionë lekë të dhëna z. E. M. dhe rrjedhimisht të investuara në shoqërinë “{***}” ShA;

(vi) Shpenzimet eventuale të kryera nga z. T. M. për blerjen e truallit dhe ndërtimin, të cilat shërbyen si kolateral/hipotekë për kredinë me kushte lehtësuese në favor të subjektit në vitin 2011;

(vii) Çmimi eventual preferencial për blerjen e apartamentit në Tiranë.

7. *Gjetja 3 – nr. {***} prot., datë 12.10.2022* – lidhet me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe me plotësimin prej subjektit të kriterëve për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese.

III. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

8. Tri vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”) më datë 16.02.2023, kanë paraqitur rekomandimin për ankim kundër vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë. Në mënyrë të përmbledhur, rekomandimi trajton çështjet që lidhen me vlerësimin e të tria kriterëve për subjektin e rivlerësimit, duke sjellë në pah sa vijon.

8.1. Për kriterin e kontrollit të pasurisë:

8.1.i. Mundësia financiare e z. M. M. për dhurimin e vlerës 1.000.000 lekë

(i) ONM-ja nuk është dakord që në analizën financiare të z. M. M. [për të dhuruar 1 milion lekë subjektit] të mos merren në konsideratë investimet në shoqëritë “{***}” ShA – 6 milionë lekë dhe “{***}” ShA – 4 milionë lekë, për shkak të moscenimit të parimit të proporcionalitetit. Këtë arsyetim ONM-ja e lidh me faktin se nga subjekti këto shoqëri u deklaruan si burimi i krijimit të të ardhurave të ligjshme të z. M. M. për dhurimin [nga punësimet në këto dy kompani]. Sipas ONM-së analiza për shoqërinë “{***}” ShA duhet të shtrihet nga viti 2002, ndërsa për shoqërinë “{***}” ShA nga viti 2004. ONM-ja nuk është dakord as me arsyen se këto investime janë kryer shumë kohë më parë, pasi prej tyre kanë rrjedhur të ardhurat e dhuruesit;

(ii) Sa i takon shitjes së aksioneve të shoqërisë “{***}” ShA nga z. M. me vlerë më të ulët, ONM-ja thekson se nuk ka prova të transaksionit monetar, por edhe nëse ai do të konsiderohej i mirëqenë, subjekti do të gjendej sërish me balancë negative;

(iii) Për sa iu përket të ardhurave të z. M./K. M. nga likuidimi i shoqërisë “{***}” ShA, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të kryerjes së transaksionit financiar të vlerës 2.674.360 lekë. Edhe nëse do të pranohej si i mirëqenë ky transaksion, subjekti do të gjendej përsëri me balancë negative.

8.1.ii. Mundësia financiare e vjehrrit për dhurimin e vlerës 1.260.000 lekë

(i) ONM-ja vëren se fugoni është deklaruar i blerë nga vjehri me të ardhura të tij nga emigracioni në Greqi. Këto të ardhura Komisioni nuk i konsideroi të ligjshme. Për pasojë, edhe të ardhurat nga qiraja e fugonit nuk mund të përfshihen në analizën financiare të vjehrrit;

(ii) Komisioni nuk ka dhënë arsye logjike, përse përjashtoi nga analiza financiare dhurimin 4 milionë lekë nga vjehri të bashkëshorti i subjektit në vitin 2004, që u përdor për të investuar në shoqërinë “{***}” ShA, në një kohë kur momenti i investimit përkon me të ardhurat e dhuruesit nga paga;

(iii) Në vlerësimin e ONM-së, subjekti është treguar selektiv në analizën financiare kur kërkon të përfshihen të ardhura të vjehrrit që në fillimet e viteve '90, përfshirë edhe të ardhura nga paga në shoqërinë “{***}” ShA, ndërsa nga ana tjetër kërkon që të përjashtohen nga analiza balancat negative, siç është dhurimi 4 milionë lekë që vjehri i dha personit të lidhur të subjektit, si dhe [të përjashtohen edhe] investimet/shpenzimet kapitale të kryera nga kunati.

8.1.iii. Përfitimi i kredisë me kushte lehtësuese dhe çështje të tjera të lidhura, ngrenë pikëpyetje në lidhje me zbatimin e etikës prej subjektit, pasi:

- (i) Subjekti nuk paraqiti dokumentacion për të treguar nëse bashkia kishte dijeni për aksionet që zotëronte bashkëshorti i saj në momentin kur aplikoi për kreditë me kushte lehtësuese;
- (ii) Subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues për nivelin minimal të të ardhurave;
- (iii) Subjekti nuk ka shpjeguar përse nuk mund të gjendej kërkesa e saj e aplikimit për kreditë me kushte lehtësuese pranë Bashkisë Fier;
- (iv) Subjekti e ka shitur apartamentin në vitin 2017 në kundërshtim me ligjin nr. 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar;
- (v) Për blerjen e apartamentit në Fier, subjekti nuk ka dhënë sqarime dhe nuk paraqiti dokumentacion provues për çmimin preferencial.

8.1.iv. Mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë vetting i 40% të aksioneve të bashkëshortit në shoqërinë “{*}” ShA dhe mungesa e burimeve të ligjshme.**

- (i) ONM-ja analizon se pavarësisht se subjekti pretendon se shoqëria nuk ka gjeneruar të ardhura, prej kësaj shoqërie deri në vitin 2010 janë paguar z. M. M. dhe znj. S. G.;
- (ii) Subjekti nuk paraqiti dokumentacion për të provuar të ardhurat e vjehrrit nga emigracioni në Greqi e, për rrjedhojë, nuk ka vend për të pretenduar pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacion apo që ato të mund të pretendohen si e ardhur e ligjshme.

8.1.v. Deklarimi i të ardhurave që shërbyen për të blerë automjetin tip “Audi”

- (i) Subjekti nuk i ka deklaruar në mënyrë të saktë të ardhurat e familjes së saj në deklaratën e pasurisë vetting dhe e vë në pikëpyetje qëndrimin e bashkëshortit të subjektit kundrejt shlyerjes së detyrimeve tatimore, sidomos për pozicionin e administratorit të shoqërisë;
- (ii) Mbajtja e identitetit të dyfishtë e z. M. M., edhe si K. M., dhe dijenia e bashkëshortit të subjektit gjatë kohës që ishte administrator i shoqërisë, duhet të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes.

8.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

(i) Subjekti ka qenë inkonsistente në shpjegimet e saj për mosdeklarimin e kontaktit të papërshtatshëm me z. V. Z. alias A. G.. Ajo kishte dijeni për këtë kontakt të papërshtatshëm, pasi tre vjet pas nënshkrimit të kontratës hoqi dorë nga gjykimi i çështjes që përfshinte familjarë të z. Z./G. për shkak të konfliktit të interesit. ONM-ja vlerëson se në kërkesën për heqje dorë nga hetimi subjekti nuk ka paraqitur faktin se kontrata është nënshkruar nga personi i lidhur/bashkëshorti dhe nuk e ka paraqitur veten si e shkëputur prej bashkëshortit, ashtu sikurse ka shpjeguar në Komision. Në përmbajtje të kontratës është specifikuar që palët kanë qenë të dy prezent gjatë hartimit të kontratës. Sipas ONM-së, subjekti duhet ta kishte deklaruar kontaktin sipas paragrafit “d” të pjesës V të shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016. ONM-ja thekson nevojën për të plotësuar deklaratën në mënyrë të saktë, më së paku kur, për këtë rast, subjekti hoqi dorë nga gjykimi për shkak të konfliktit të interesit për këtë kontakt, dhe nga ana tjetër në lidhje me standardet që pretendon dhe ka aplikuar kur ka hetuar Bashkinë Fier.

(ii) Kontakte aktuale të papërshtatshme, që përfshijnë persona të hetuar nga SPAK, për procedurën e prokurimit që lidhej me tenderin e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të vendepozitimeve ekzistuese [...]. Dokumentet e administruara tregojnë që

subjekti dhe bashkëshorti kanë marrëdhënie familjare, biznesi, të punës dhe shoqërore me z. M. M., znj. S. G., z. K. Z. dhe z. A. M., të gjithë të hetuar nga SPAK për krim të organizuar në *çështjen e procedurës prokurimit që lidhet me tenderin e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të vendepozitimeve ekzistuese [...]*. Në këtë drejtim, ONM-ja ka paraqitur si argument marrëdhëniet e faktuara të këtyre personave me subjektin dhe personin e lidhur/bashkëshortin, sikurse edhe udhëtimet e kryera prej tyre në vitin 2016 apo përdorimin e automjeteve në pronësi të K. Z. dhe A. M. në vitin 2019 – 2020 nga subjekti dhe personi i lidhur. Po ashtu, marrëdhënia e punësimit të bashkëshortit në shoqërinë e z. K. Z. dhe të biznesit me znj. S. G. dhe z. M. M., daton që prej vitit 2002, duke filluar me shoqërinë “{***}” ShA. Për më tepër, edhe vjehtëri i subjektit ka qenë i punësuar në shoqëritë e lidhura me incineratorët të z. K. Z. dhe z. A. M., në vitet 2007-2013 dhe 2014-2016.

8.3. Për vlerësimin e aspektit profesional:

(i) Procedimi nr. {***}, lidhet me denoncimin e përfaqësuesve të dy shoqërive kandidate për të marrë pjesë në një procedurë ankandi të zhvilluar nga shoqëria “{***}” ShA. Ata paraqitën kallëzim me pretendimin e paraqitjes së një pengese nga zyrtarë të shoqërisë “{***}” ShA, për të marrë pjesë në këtë procedurë. Nën optikën e ONM-së, subjekti nuk ka kryer hetime të konsiderueshme nga paraqitja e kallëzimit, në qershor 2015 deri më 14.10.2015, kur vendosi të regjistronte çështjen. Pretendimi i subjektit për ngarkesë në punë mbetet deklarativ. Nuk qëndron pretendimi për mungesë të një afati kohor për të verifikuar kallëzimin, në kushtet që udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241/2005, i ndryshuar, ka përcaktuar 30 ditë afat për verifikim fillestar. Sipas ONM-së, edhe pretendimi se nuk kishte autor për t’i atribuar veprën penale nuk qëndron, pasi që në fillim, kallëzimi u bë kundrejt rojeve të objektit të shoqërisë “{***}” ShA. Gjithashtu, subjekti duhet të kishte nxjerrë regjistrimet telefonike, të cilat deduktoheshin nga deklaratimet e palëve dhe të kishte marrë në hetim, *ex officio*, administratorin/Drejtorin e Përgjithshëm të shoqërisë “{***}” ShA. Ky rast, sipas ONM-së, duhet të verifikohet në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit.

(ii) Kallëzimi nr. {***}, lidhet me denoncimin e një qytetari ndaj ish-subjektit të rivlerësimit A. B. për fshehje të pasurisë dhe deklaram të rremë. Subjekti ka vendosur mosfillim të procedimit penal me argumentin se është çështje administrative dhe Komisioni duhet ta kishte referuar si çështje në prokurori, nëse do të kishte gjetur shkelje me natyrë penale. Sipas ONM-së, subjekti nuk e ka përmbushur barrën e provës, pasi nuk ka shpjeguar bindshëm rreth çështjeve të ngritura, përfshirë këtu edhe përjashtimin nga hetimi çështjet që bazohen mbi një kallëzim të qytetarëve. Gjithashtu, Komisioni dështoi të paraqesë një pamje të qartë dhe analizë të çështjes.

(iii) Kallëzimi nr. {***} është kryer nga Sektori kundër Krimit Financiar dhe ka për objekt përdorimin e fondeve publike nga Bashkia Fier në ndërtimin e pallatit të sportit. Kallëzimi u regjistrua në datën 18.04.2013. Në datën 14.05.2013, subjekti vendosi mosfillim të procedimit penal. Sipas ONM-së, hetimi i kryer nga subjekti i rivlerësimit konsistoi në dërgimin e një shkrese Bashkisë Fier, e cila rezultonte me mungesë dokumentacioni nga auditi i vitit 2012. Vendimi i mosfillimit të procedimit ka mangësi substanciale në arsyetim, ndërsa mungon arsyetimi për mungesën e hetimit dhe për paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike të trashëguara nga vitet pararendëse pa një akt që të justifikojë veprimet.

(iv) Procedimi penal bazuar në kallëzimin nr. {***} të z. A. K., për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh, kundrejt Bashkisë Fier, në një procedurë të rregullimit të territorit. Kallëzuesi ka pretenduar se bashkia ka favorizuar firmën e ndërtimit, e cila më tej i ka cenuar të drejtën e pronësisë. Më datë 26.05.2014, vetëm pesë ditë pasi ishte bërë denoncimi, subjekti vendosi të mos fillojë procesin penal, me arsyetimin se nuk ka vepër penale. Ajo e udhëzoi kallëzuesin që të zgjidhte çështjen në rrugë gjyqësore civile/administrative. Nën optikën e ONM-së, subjekti nuk ka dhënë shpjegime të besueshme për çështjet e ngritura. Subjekti e ka marrë vendimin e mosfillimit pa marrë në konsideratë dyshimet për cenim të të drejtave të pronësisë. Subjekti nuk dha sqarime për mungesën e hetimit dhe për konfliktin e interesit.

(v) Procedimi penal bazuar në kallëzimin nr. {***} nga z. B. Xh., për dyshime për veprime të kundërligjshme të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Fier. Subjekti ka vendosur mosfillim të procedimit penal, pasi prishja e objektit në pronësi të z. Xh. u bë pas një vendimi të këshillit bashkiak për zhvillimin e një projekti me interes publik dhe fakti nuk përbënte vepër penale. Sipas ONM-së, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar veprimet e inspektoratit dhe të bashkisë në lidhje me respektimin e ligjit për shpronësimin ose zhvillimin e territorit, i cili parashikon ndër të tjera, procedura të gjata shpronësimi, duke përfshirë negociatat me pronarët privatë. Sipas rekomandimit, subjekti nuk ka sqaruar në mënyrë të besueshme mungesën e hetimeve apo arsyetuar çështjet e ngritura. Po ashtu, subjekti nuk ka sqaruar konfliktin e interesit me Bashkinë Fier. Në përfundim, ky rast duhet të vlerësohet në aspektin profesional të subjektit.

(vi) Kallëzimi penal nr. {***}, lidhet me një denoncim për dyshime rreth falsifikimit të dokumenteve dhe abuzim me detyrën, në lidhje me asete të cilat bashkia kishte për qëllim që t'i përfshinte në një projekt të ndërtimit të Pallatit të Sportit, në 2011. Subjekti nuk paraqiti kërkesë për heqje dorë nga gjykimi. Sipas ONM-së, kjo çështje duhet analizuar në këndvështrimin profesional që lidhet me konfliktin e interesit.

(vii) Kallëzimi penal nr. {***} – subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim për mosfillim të procedimit penal më datë 05.06.2012, pasi ka gjetur të pabazuara pretendimet e denoncuesit për “Shpërdorim detyre” dhe “Shkatërrim prone”, ndaj kryetarit të bashkisë z. B. Z. dhe inspektorëve të ndërtimit.

IV. Shkaqet e ankimit

9. Më datë 28.02.2023, ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit, Komisionerja Publike, znj. Irena Nino (në vijim “Komisionerja Publike” dhe/ose “Komisionerja”), në zbatim të rekomandimit të ONM-së. Sipas Komisioneres Publike, vendimi i Komisionit është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Në këtë rast, evidentohen çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për të tria kriteret. Pjesë integrale e ankimit janë parashtrimet në rekomandim, si dhe në tri gjetjet e paraqitura nga ONM-ja, gjatë hetimit në Komision.

9.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: Komisionerja Publike kërkon që kontrolli i mundësive financiare të personave të tjerë të lidhur në Kolegj të kryhet përtej kufijve të dhurimit të tyre dhe të përfshijë edhe investimet/shpenzimet e dokumentuara të tyre.

9.1.i. Për apartamentin në Fier: Komisionerja Publike vlerëson se analiza e kryer nga Komisioni nuk përputhet me aktet në dosje dhe me atë çka ka rezultuar nga hetimi. Arsyetimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit duhet të justifikojë burimin e ligjshëm brenda kufijve të shumës objekt dhurimi nuk është bindës. Në analizë, më së paku, duhet të përfshihen edhe shpenzimet që kanë shërbyer për krijimin e biznesit nga i cili ka buruar edhe vlera e dhuruar. Në këtë kuptim, për një analizë objektive, duhet të bëhet interpretim i zgjeruar për pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se ky është një rast specifik. Konkretisht:

*i) Në lidhje me dhurimin e shumës 1 milion lekë nga kunati [z. M. M.], si burim krijimi i apartamentit, Komisionerja Publike kërkon që në analizë të përfshihet investimi i këtij personi tjetër të lidhur në shoqërinë “{***}” ShA, me vlerë 10.000.000 lekë, ashtu sikurse edhe investimi në vitin 2004 në themelimin e shoqërisë “{***}” ShA, me vlerë nominale 4.000.000 lekë. Në këndvështrimin e Komisioneres Publike, shpenzimet e investimeve paraqesin lidhje organike dhe logjike, të cilat nuk mund të ndahen për efekt të procesit të rivlerësimit. Në analizë duhet të përfshihen të ardhurat e krijuara/përfituara dhe investimet për krijimin e këtyre shoqërive.*

*ii) Për shumën 1.260.000 lekë, e dhuruar nga vjehrrri, si burim krijimi i apartamentit, në analizën e mundësisë financiare të tij nuk duhet të ishin përfshirë të ardhurat nga qiraja dhe nga shitja e autobusit. Subjekti deklaroi se vlera e dhuruar ka për burim të ardhurat nga punësimi informal në Greqi. Për të vlerësuar mjaftueshmërinë e të ardhurave të vjehrrit të subjektit për të dhuruar 1.260.000 lekë, duhet të mbahet në konsideratë që të ardhurat e vjehrrit kanë shërbyer për të mbuluar edhe kapitalin e investimit të vlerës 4.000.000 lekë të dhuruar personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit në shoqërinë “{***}” ShA, në vitin 2004. Nga kjo analizë e burimeve financiare të ligjshme të personit tjetër të lidhur do të rezultonte pamjaftueshmëri në vlerën prej 3.000.000 lekësh, për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shumat e dhuruara bashkëshortit të subjektit në vitet 2004-2011.*

iii) Për përfitimim e kredisë me kushte lehtësuese, çmimin në dukje preferencial dhe shitjen e apartamentit në Fier:

*a) Subjekti nuk plotësonte kriteret për të përfituar kredinë me kushte lehtësuese nga Bashkia Fier. Familja e saj kishte të ardhura të larta, që varionin nga 170.000 lekë deri në 190.000 në muaj, sikurse edhe vlerën e aksioneve që zotëronte bashkëshorti në shoqërinë “{***}” ShA.*

b) Subjekti e ka shitur këtë banesë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 20 të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar, i shfuqizuar (në vijim “ligji nr. 9232/2004”), duke cenuar me këtë sjellje, integritetin dhe figurën, pasi duket që ky përfitim është rrjedhojë e qenies së subjektit prokurore.

c) Në vlerësimin tërësor të çështjes, përfitimi i kredisë në kundërshtim me kriteret e ligjit bën që subjekti të ketë cenuar besimin e publikut, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

9.1.ii. Për mosdeklarimin në deklaratën vetting të 40% të aksioneve të zotëruara nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit në shoqërinë “{*}” ShA:**

Subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë e të pamjaftueshëm, pasi nuk deklaroi aksionet në vlerën 4.000.000 lekë në shoqërinë “{***}” ShA, që zotëronte personi i lidhur/bashkëshorti në deklaratën e pasurisë *vetting*.

9.1.iii. Për deklarimin e pagës së bashkëshortit në funksion të blerjes së një automjeti

Subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Paga e bashkëshortit, deklaruar prej saj në vlerën 70.000 lekë në muaj, nuk përputhet me vërtetimin e ISSh-së, sipas së cilit paga varionte nga 10.000 lekë në muaj deri në 14.000 lekë në muaj. Pretendimi se diferenca nga paga e deklaruar (14.000 lekë) në atë faktike (70.000 lekë) bëhej në *cash* është i pambështetur në ligj e në prova.

Për kriterin e kontrollit të figurës: Komisionerja Publike është mbështetur në Rekomandimin e ONM-së, përmbajtjen e gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në vlerësimin tërësor të çështjes. Në ankim, Komisionerja Publike ka potencuar se ka disa rrethana nga të cilat konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, Komisionerja analizon si vijon:

9.2.i. Subjekti i rivlerësimit e ka plotësuar me mangësi shtojcën nr. 3 të ligjit nr. 84/2016, “Deklarata për kontrollin e figurës”, pasi nuk ka deklaruar kontaktin me një person të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe shkëmbimin/shitblerjen e pasurisë ndërmjet tyre. Mosdeklarimi i këtij kontakti përbën të metë që në këndvështrimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe në kuptim të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.

9.2.ii. Komisionerja Publike ndan një vlerësim të ndryshëm nga ai i Komisionit lidhur me kontaktet faktike të papërshtatshme të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, jo vetëm me familjarë, por edhe marrëdhënie biznesi/punësimi, me z. M. M., z. K. Z. dhe znj. S. G.. Faktet që pasqyrojnë gjetet e ONM-së tregojnë vazhdimësi lidhjesh midis subjektit, bashkëshortit, kunatit, kunatës dhe vjehrrit dhe, më tej, me partnerët/punëdhënësit e tyre në biznes, gjatë viteve 2002-2022. Hetimet e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (në vijim “SPAK”) për këta persona janë shtrirë edhe në aktivitetet private prej viteve 2011, 2014 e në vijim. Për këtë arsye, hetimi i Komisionit është i mangët, pasi u kufizua me momentin kur është regjistruar hetimi penal. Qoftë ngjarjet e vitit 2018, kur çështja u bë publike, ashtu edhe ato të vitit 2020, kur çështja u referua në SPAK, janë relevante për t’u vlerësuar, për qëllim të procesit të rivlerësimit, në ndikimin që kanë në besimin e publikut.

9.2. *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:* Gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, Komisioni ka administruar dhe gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, të cilat ngrenë çështje për vlerësimin e etikës, konfliktit të interesit dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Nga hetimi administrativ kanë rezultuar disa mangësi, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës. Ankimi bazohet në një analizë të veprimeve të subjektit në çështje penale, që lidhen me kallëzime/hetime me palë shoqërinë “{***}” ShA dhe Bashkinë Fier, konkretisht:

9.3.i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer hetim me të meta të dukshme procedurale dhe materiale në një çështje që lidhet me shoqërinë “{***}” ShA, për veprën penale të shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera. Hetimi mund të përfshinte edhe persona të tjerë, përveç atyre të

hetuar, përfshirë eprorin e bashkëshortit të subjektit, administrator i shoqërisë. Në këtë rast, konstatohet edhe një situatë e mundshme konflikti interesi⁴.

9.3.ii. Në hetimet me palë Bashkinë Fier, për përdorimin e fondeve, si dhe për ndërtimin e një pallati sporti në vitin 2011, subjekti ka treguar mangësi, në kuptim të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket aftësisë për të hetuar, marrë vendime e urdhra. Subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak të kredisë së butë të marrë nga ky institucion⁵. Mangësitë duhet të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, lidhur me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

9.3.iii. Në dy çështje të tjera penale që kanë në fokus, po ashtu Bashkinë Fier, procedime të vitit 2014 dhe 2015, subjekti ka treguar mangësi në aftësinë për të hetuar e marrë vendime, në kuptim të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 dhe, si më lartë, ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Së bashku me mangësitë e vërejtura, këto fakte përbëjnë bazë për vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, lidhur me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

9.3.iv. Në çështjen penale nr. {***}, të sjellë në vëmendje nga një denoncues, që lidhet me kallëzimin penal kundër një ish-gjyqtari të shkarkuar nga Komisioni, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

9.3.v. Sipas Komisioneres Publike, në vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti ka treguar mangësi, në kuptim të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket aftësisë për të hetuar, marrë vendime e urdhra, si dhe ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Po ashtu, ka një sërë rrethanash nga të cilat arrihet në konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut, parashikuar në pikën 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Komisionerja Publike vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për t'u konfirmuar në detyrë. Mbështetur në shkaqet e ngritura në ankim, në parashtrimet e datës 11.01.2024, si dhe në bisedimet përfundimtare të datës 23.01.2024, ajo kërkoi që Kolegji të vendosë ndryshimin e vendimit, nr. 606, datë 21.12.2023, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri.

V. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit në Kolegj

10. Në parashtrimet e depozituara në datën 08.01.2024, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse në Komision dhe ka kërkuar nga Kolegji lënien në fuqi të vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Pretendimet e subjektit për secilin kriter përmbledhen si vijojnë.

10.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

10.1.i. Përfshirja e shpenzimeve në *analizën financiare të personit tjetër të lidhur*, disa prej të cilave shumë kohë përpara dhurimit, bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, objektivitetit, si dhe praktikën e konsoliduara të Kolegjit. Sipas subjektit, është e paqartë përse rasti i saj për Komisioneren Publike përbën një rast specifik dhe përse analiza financiare e personit tjetër të lidhur duhet të përfshijë gjithë shpenzimet e jetës së tij, *shumë kohë përpara dhurimit*, në kushtet që ligji nuk e parashikon një detyrim të tillë. Analiza financiare duhet të

⁴ Përkatësisht procedimet penale nr. {***} dhe nr. {***}.

⁵ Ky rast, lidhet me kallëzimin penal nr. {***}.

kufizohet vetëm në mundësinë e krijimit të vlerës së huazuar nga personat e tjerë të lidhur deri në masën e vlerës së huazuar.

10.1.ii. *Sa i takon përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese*, subjekti parashtron se i ka plotësuar kriteret për përfitimin e saj. Në momentin kur është disbursuar kredia nga banka, të ardhurat e saj ishin pakësuar. Pavarësisht vërtetimit se paga e bashkëshortit ishte 73.000 lekë/muaj, ai mbeti pa punë në këtë periudhë. Gjithashtu, subjekti pretendon se nuk ka pasur të ardhurat në masën që citon shkresa e institucionit të prokurorisë depozituar pranë Bashkisë Fier, pasi komandimi në Njësinë e Përbashkët Hetimore, nuk ishte e ardhur e sigurtë/e vazhdueshme. Sipas saj, të ardhurave të familjes duhet t'i zbritet qiraja mujore prej 10.000 lekësh dhe kështu e kredisë që paguheshin në Raiffeisen Bank. Sikurse në Komision, edhe në Kolegj, subjekti ngre pretendimin se nuk ka siguruar banesë nëpërmjet programeve sociale -- banesë me kosto të ulët -- por nëpërmjet blerjes në tregun e lirë. Për këto arsye, nuk gjen zbatim kriteri i nivelit të të ardhurave të pamjaftueshme, sipas pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 9232/2004 dhe as përlllogaritja nivelit të të ardhurave nuk mund të kryhet sipas njëjtë ligj. Në vlerësim të subjektit, banka ka kontrolluar përpara disbursimit të kredisë nëse familja kishte aftësi paguese. Sipas subjektit, ndonëse niveli i të ardhurave nuk rezulton të jetë kriter ligjor, ky pretendim i Komisionerit rezulton të jetë i pambështetur në dokumentacion.

10.1.iii. *Për mosdeklarimin në deklaratën vetting të 40% të aksioneve të zotëruara nga bashkëshorti i subjektit në shoqërinë “{***}” ShA*

Shoqëria “{***}” ShA ka qenë me status pasiv dhe me humbje, që nënkupton pa fitim të realizuar, referuar shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Për këtë shoqëri duhet të ishin nisur procedurat e falimentit. Në kuptim të elementëve të pronësisë (e drejta e disponimit, e gëzimit dhe e posedimit), sipas Kodit Civil, subjekti/bashkëshorti nuk e posedonte vlerën e kapitalit, pasi nuk ushtronte sundim efektiv. Kësaj pasurie i mungonin tërësisht tagrat e sipërcituara; ajo nuk mund të shitej, nuk mund të kryhej mbyllja e saj apo të sillte ndryshim pronësie me shtim të ardhurash. Për këto shkaqe, nuk u deklarua.

10.1.iv. *Për ligjshmërinë e burimit të krijimit të vlerës së investuar në kapitalin e shoqërisë*

Sikurse në Komision edhe në Kolegj, subjekti pretendoi se vjehri ka krijuar të ardhura të konsiderueshme nga emigracioni, ndërkohë që ka qenë kryesisht i punësuar informalisht. Nuk disponon dokumentacion për periudhat në të cilat ka qenë i siguruar për shkak të kohës që ka kaluar. Për shkak të kësaj distance kohore, që daton në vitet 1992-1998, është e pamundur një përlllogaritje e saktë e të ardhurave *neto* të një familjeje emigrantësh e, për pasojë, gjendet në pamundësi të sigurimit të dokumentacionit, sipas pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti kërkon nga Kolegji që të mbahet në konsideratë që kjo pasuri është krijuar para martesë, dhe se vetë ajo nuk ka përfituar të ardhura prej saj. Po ashtu, ajo kërkoi që të mbahen në konsideratë disponimet e Kodit të Familjes në lidhje me regjimin pasuror martesor. Kjo pasuri duke qenë e bashkëshortit, sipas nenit 95 të Kodit të Familjes, nuk mund të përfshihet në procesin e rivlerësimit të subjektit. Subjekti kërkon që faktet e mësipërme të merren parasysh edhe nën dritën e jurisprudencës së Kolegjit për pasuritë/të ardhurat e krijuara përpara emërimit në detyrë dhe përpara martesë.

10.1.v. *Për deklarimin e pagës së bashkëshortit që shërbeu për blerjen e autoveturës tip “Audi”*

Subjekti parashtron se deklarimi i saj ka qenë i saktë. Ajo ka sqaruar se një pjesë e pagës prej 70.000 lekësh është marr *cash* e, për pasojë, nuk ka qenë vlere mbi të cilën janë derdhur kontributet shoqërore. Për më tepër, ky punësim i bashkëshortit ka ndodhur përpara se ajo të krijonte lidhje dhe këto të ardhura nuk kanë krijuar pasuri për bashkësinë.

10.2. Për kriterin e kontrollit të figurës

10.2.i. Për mosdeklarimin në formular të kontaktit të papërshtatshëm

Në parashtrime subjekti theksoi të njëjtat pretendime sikurse në Komision duke argumentuar se pretendimi i Komisioneres Publike se nuk ka deklaruar shkëmbimin/shitblerjen e pasurisë me një person të përfshirë në krimin e organizuar, sipas germës “e” të pjesës së pestë të shtojcës nr. 3 “Deklarata e kontrollit të figurës” e ligjit nr. 84/2016, është tërësisht i pambështetur në ligj.

10.2.ii. Për lidhjen e vazhdueshme mes saj/bashkëshortit me z. K. Z. dhe z. A. M., subjekti parashtron se Komisionerja Publike ka tejkualuar tagrat e hetimit administrativ dhe paraqet pretendime të pakonfirmuara nga një hetim penal, i cili i nënshtrohet sekretit hetimor. Ankimi i referohet të dhënave nga portale mediatike që i përkasin individëve me të cilët subjekti nuk ka njohje e, për rrjedhojë, nuk mund të jenë pjesë e këtij hetimi administrativ. Nga aktet provohet se bashkëshorti i subjektit nuk ka asnjë lidhje biznesi me znj. S. G., z. K. Z. dhe z. A. M.. E vetmja lidhje biznesi mes tyre i ka pasur fillesat në vitin 2004, me z. M. M.. Hetimi i kryer nga Komisioni për familjarët e bashkëshortit ka tejkualuar qëllimin e procesit të rivlerësimit, pasi subjekt rivlerësimi është ajo vetë. Pavarësisht, ajo ka përmbysur barrën e provës dhe ka provuar se bashkëshorti nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie biznesi me personat në fjalë, ndryshe nga sa pretendon Komisionerja Publike. Ajo [subjekti] ka provuar se bashkëshorti ka pasur marrëdhënie biznesi vetëm me vëllanë e tij në vitin 2004 deri në vitin 2007, kohë kur subjekti nuk ishte prokurore dhe as bashkëshorte e tij. Nga kjo marrëdhënie tregtare bashkëshorti nuk ka përfituar asnjë të ardhur pasi u martua në vitin 2008.

10.2.iii. Përdorimi në ankim i termit “afera e incineratorëve” është paragjykes dhe aspak profesional. Ky paragjykim ka ndikuar mbi të tri kriteret e rivlerësimit, veçanërisht atë të figurës. Të dhënat e paraqitura shtrembërojnë faktet. Referuar ankimit, të dhënat për *çështjen e incineratorëve*, nuk janë shpjeguar për lidhjen që kanë me subjektin. Sipas subjektit, pyetja që lind *natyrshëm* është kur ndërthuret *interesi privat me interesin publik*, përse hetimi duhet të afektojë kriterin e *figurës së subjektit* dhe cila është baza ligjore e këtij pretendimi? Rënditja që i bën Komisionerja Publike rrethanave faktike, si pjesë e lidhjeve sociale, nuk është e saktë dhe përbën keqinterpretim dhe kapërcim të ligjit nr. 84/2016, e ndikuar vetëm nga ngjarjet e mediatike, kundrejt të cilave subjekti nuk ka asnjë mundësi objektive të mbrojë veten për shkak të funksionit që ushtron. Subjekti referoi në mbështetje të këtij argumenti vendimin e GjEDNj-së në *Prager* dhe *Oberschlick* kundër Austrisë⁶.

10.2.iv. Udhëtimi në Austri me znj. S. G. dhe z. M. M., i referuar në ankim, është i vetmi udhëtim familjar me ta në 15 vite martesë. Udhëtimi ka ndodhur në vitin 2016, kur ata nuk ishin të

⁶ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57926%22%5D%7D>

proceduar penalisht. Raporti familjar nuk të jep të drejtën e aksesit në jetën e dikujt. Këta kufij ajo i vendos në jetën e saj personale, familjare dhe akoma më tepër në jetën profesionale.

10.2.v. Cilësinë e personit *tjetër* të lidhur, z. M. M., e ka marrë në një moment kur nuk ishte proceduar penalisht, e konkretisht në prill 2011. Ngjarjet e ndodhura në dhjetor të vitit 2021 e në vijim, në kuadër të çështjes së incineratorëve, nuk mund të afektojnë kriterin e figurës, për arsye se:

- Në momentin e plotësimit të formularit të dekriminalizimit për qëllim të ligjit nr. 84/2016, (më datë 25.01.2017), këta persona nuk kanë qenë të dënuar apo proceduar për ndonjë nga veprat penale, parashikuar në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar. Në këtë moment, znj. S. G. dhe z. M. M. nuk mund të konsiderohen kontakt i papërshtatshëm, pasi në atë datë kanë qenë në cilësinë e personave nën hetim, për të cilët ende nuk rëndonte një vendim fajësie i formës së prerë e, për pasojë, prezumohen të pafajshëm;
- Parashikimet ligjore në nenet 34 -- 39 të ligjit nr. 84/2016, janë plotësim i kriterit të figurës së magjistratit në kuadër të procesit të rivlerësimit, sipas pikës DH të Aneksit të Kushtetutës. Periudha prej së cilës kryhen verifikime në kuadër të këtij procesi është data 01.12.2012 deri ditën e deklarimit 25.01.2017, dhe ka si qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe ndershmërisë së magjistratit në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës;
- DSIK-ja ka konkluduar përshtatshmërinë në detyrë të saj [subjektit] në dy raporte. Nuk është konstatuar asnjë kontakt i papërshtatshëm gjatë ushtrimit të detyrës prej atij institucioni;
- Në kuptimin e ligjit, *kontakti* duhet të jetë i provuar, real dhe *jo i supozuar* për shkak të marrëdhënies familjare, e cila është një marrëdhënie për shkak të ligjit, që nuk zgjidhet nga subjekti. Kontakti duhet të jetë i konsumuar në një nga format që parashikon ligji specifik dhe nuk mund të merret i mirëqenë duke u ngarkuar padrejtësisht subjekti;
- Marrëdhënia e punësimit të bashkëshortit në shoqërinë “{***}” ShPK -- me administrator z. K. Z. -- është ndërprerë në gusht të vitit 2022. Nuk është e lehtë për një kryefamiljar që ka në ngarkim dy fëmijë të mitur të largohet nga puna. Duhet mbajtur në konsideratë edhe pasiguria për shkak të procesit të rivlerësimit, i cili u paragjykua nga hetimet e nisura për këtë shoqëri.

10.2.vi. Për përdorimin e automjeteve

a) Sikurse edhe në Komision, subjekti pretendon se nuk dinte cili ishte pronari i mjetit me të cilin ka udhëtuar në Mal të Zi, pasi ndodhi në mënyrë rastësore. Ishte pasagjere në udhëtimin e datës 23.01.2019 në këtë automjet, ndërsa z. A. M., pronari i këtij automjeti, nuk ishte i proceduar penalisht për një nga veprat penale që e bëjnë atë kontakt të papërshtatshëm, përpos që vetë subjekti nuk ka njohje me të. Nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi, sepse duhet të parashikonte diçka që do të ndodhë në të ardhmen. Përgjegjësia lind për shkak të ngjarjeve që kanë ndodhur tashmë dhe jo për ngjarje që pritet të ndodhin në të ardhmen.

b) Znj. S. G. dhe z. M. M. nuk kanë qenë persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kohën kur ka pasur marrëdhënie apo kur bashkëshorti ka përfituar dhurimin për blerjen e apartamentit. Për pasojë, nuk mund të konsiderohen si kontakte të papërshtatshme;

c) Të dhënat për vlerësimin e kriterit të figurës që pasqyron Komisionerja Publike në ankim janë jologjike, të padrejta, që bien ndesh me provat e administruara, me nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

d) Fakti që shoqëria “{***}” ShA ka qenë me humbje që prej vitit 2007, përjashton vazhdimësinë e marrëdhënies së biznesit të bashkëshortit me z. M. M.. Ndërsa për lidhjet e biznesit apo shoqërore të z. K. Z. dhe z. A. M. me personat e tjerë të lidhur (M. M./S. G. dhe T. M.), nuk ka dijeni, pasi janë lidhje mes këtyre individëve e jo asaj/bashkëshortit. Kontrolli i ligjshmërisë së shoqërive tregtare i përket Drejtorisë Rajonale Tatimore. Ajo nuk mund të bënte hetim privat, pasi do të ishte në shkelje të ligjit.

10.3. Për kriterin e vlerësimit profesional

Sikurse në Komision, edhe në Kolegj subjekti ka shpjeguar se: (i) nuk ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesit; (ii) vendimet e saj janë kontrolluar dhe lënë në fuqi nga drejtuesi i prokurorisë; (iii) në vendimet për zgjatjen e afateve të hetimit dhe regjistrimin e veprave penale pa autor, afati i hetimeve fillon në momentin që në regjistrin e njoftimit të veprave penale shënohet emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale. Kur vepra është pa autor, nuk mund të procedohet me shënimin e emrit. Në përfundim, subjekti kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 606, datë 21.12.2023, të Komisionit.

VI. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

11. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

12. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Nga shqyrtimi i korrespondencës, konstatohet se ankimi kundër vendimit objekt shqyrtimi, është regjistruar pranë Komisionit më datën 28.02.2022 dhe është pranuar si i paraqitur brenda afatit 15 ditor, në datën 01.03.2023. Në këto kushte, Komisionerja Publike legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

13. Në përputhje me pikën 3 të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të Komisionit, i paraqitur në Kolegj nga Komisionerja Publike, kryhet në seancë publike. Për

rjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisioneres Publike ndaj vendimit të Komisionit nr. 606, datë 21.12.2023, për subjektin e rivlerësimit Mariola Mërtiri, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve.

13.1. Nëpërmjet parashtrimeve të datës 08.01.2024 dhe në seancën gjyqësore të datës 16.01.2024, subjekti kërkoi që të administrohen disa akte⁷ në cilësinë e provës nëpërmjet riçeljes së hetimit gjyqësor. Në seancën gjyqësore të datës 16.01.2024, bazuar në pikën 3 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të riçelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues ia nënshtroi ato debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti iu përgjigj edhe disa pyetjeve të parashtruara nga vëzhguesi ndërkombëtar.

13.2. Denoncimet e depozituara në Kolegji nga tri individë⁸ iu dërguan respektivisht subjektit të rivlerësimit dhe Komisioneres Publike në datën 11.01.2024. Pasi dëgjoi palët në seancën dëgjimore të datës 16.01.2024, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të mos i hetojë këto denoncime, duke vlerësuar se ato nuk përmbajnë rrethana apo fakte që përbëjnë provë për procesin, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

13.3. Në datën 23.01.2024, Kolegji zhvilloi seancën gjyqësore dhe dëgjoi konkluzionet e palëve. Komisionerja Publike kërkoi ndryshimin e vendimit objekt ankimi të Komisionit dhe shkarkimin e subjektit nga detyra. Subjekti kërkoi mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit për konfirmimin e saj në detyrë.

13.4. Në përfundim të hetimit gjyqësor, trupi gjykues mori në analizë dhe shqyrtoi shkaqet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike, ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet parashtrimeve dhe konkluzioneve përfundimtare dhe gjithë aktet në fshikujt e Komisionit, aktet e administruara gjatë gjykimit në Kolegji e sa rezultoi nga debati gjyqësor në Kolegji.

B. Vlerësimi i themelit të pretendimeve

I. Kriteri i vlerësimit të pasurisë

14. Komisioni ka arsyetuar se bazuar në provat që disponon si dhe bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, deklarim të saktë të pasurive të saj dhe personave të lidhur dhe ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e tyre. Ndër pasuritë, për të cilat Komisioni ka shtrirë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, Komisionerja Publike ka potencuar probleme për tre

⁷ Aktet e referuara nga subjekti e të administruara në cilësinë e provës në seancë, përbëhen nga: dy (2) vërtetime, përkatësisht nga Raiffeisen Bank dhe Banka Kombëtare Tregtare, që mbajnë datat 26.12.2023 dhe 30.11.2023; dy (2) kopje të vendimit nr. {***}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe një vendimi të së njëjtës gjykatë me nr. {***}; tre (3) shkresa kthim përgjigje përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; dhe dy (2) nga ajo në Tiranë, që mbajnë datat 27.12.2023, 22.12.2023 dhe 27.12.2023.

⁸Përkatësisht, z. V. V., znj. L. M. dhe znj. E. C..

aspekte, e konkretisht: (i) një apartament banimi në Fier, (ii) një automjet, blerë nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit në vitin 2004 (deklaruar në deklaratën *vetting*); dhe (iii) një investim të bashkëshortit, i barasvlershëm me 40% të aksioneve, në një person juridik [{"***"} ShA]. Secili prej këtyre aspekteve shtjellohet në vijim të arsyetimit së bashku me konkluzionin e trupit gjykues të Kolegjit.

I/a. Për burimet e krijimit të apartamentit me sipërfaqe 83,88 m², në Fier

15. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *vetting*, në bashkëpronësi me bashkëshortin dhe krijuar në vitin 2011, në vlerën 4.500.000 lekë. Subjekti po ashtu ka specifikuar se kësti i parë është paguar më 24.06.2011 me burime 1.000.000 lekë *dhurim* nga vëllai i bashkëshortit [z. M. M.] dhe 1.260.000 lekë nga babai i bashkëshortit [z. T. M.]. Kësti i dytë prej 2.240.000 lekësh është shlyer më 02.08.2011 nëpërmjet një kredie bankare [nga Banka Kombëtare Tregtare, dega Fier]. Për të konfirmuar dhurimet në fjalë në prill 2011, në funksion të këstit të parë, subjekti ka referuar dy deklarata noteriale të lëshuara nga dhuruesit përkatësisht në korrik dhe shtator 2012. Si burim krijimi i dhurimeve referohen përkatësisht të ardhurat e vjehrrit nga kursimet familjare, nga emigracioni në Greqi në vitet 1992-1998 dhe punësimi në blegtori e në transportin e udhëtarëve. Në fund të këtyre katër burimeve, subjekti ka referuar shprehimisht në faqen 8 të deklaratës: "*Periudhë punësimi informale*". Për sa i përket burimeve të dhurimit nga vëllai i bashkëshortit, subjekti ka deklaruar të ardhura nga *paga e biznesi* dhe shtuar si referencë një kontratë shitjeje të *kuotave të shoqërisë [{"***"} ShPK*.

15.1. Pasi ka hetuar për burimet e sipër referuara dhe kaluar subjektit barrë prove për secilin prej tyre, Komisioni ka konstatuar burime të ligjshme të mjaftueshme të personave të tjerë të lidhur. Në analizën e mundësisë së krijimit të vlerës së dhuruar nga vjehrrit, Komisioni ka përfshirë: (i) të ardhurat nga paga e vjehrrit dhe vjehrrës së subjektit për periudhën 2005 deri në mars 2011; (ii) të ardhura nga qiraja e autobusit nga viti 2005 deri në tetor të vitit 2007; dhe (iii) të ardhurat nga shitja e autobusit në vitin 2007. Komisioni zbriti nga këto të ardhura vetëm shpenzimet e jetesës nga viti 2004 deri në vitin 2011. Nga ana tjetër, investimi në shoqërinë [{"***"} ShA dhe [{"***"} ShA, i kryer nga vjehrrit i subjektit në favor të bashkëshortit të saj në vitin 2004, nuk u përllogarit në analizën e burimeve të disponuara, meqenëse ka ndodhur vite para dhurimit në funksion të blerjes së apartamentit. Komisioni ka vlerësuar po ashtu edhe që kredia lehtësuese e përfitur nga Bashkia Fier ka kaluar të gjitha fazat dhe është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Fier. Pasi ka riprodhuar një vështrim teorik të hapave ligjorë që duhet të ndiqnin organet e pushtetit vendor për miratimin e kredive lehtësuese për programin e banesave me kosto të ulët dhe që nga organet kontrolluese [...] deri më sot nuk ka rezultuar ndonjë revokim i miratimit [...] nga organet miratuese [...] apo edhe nga gjykata⁹, Komisioni ka konstatuar se subjekti dhe bashkëshorti kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit objekt analize.

15.2. Komisionerja Publike nuk është dakord me vlerësimin e kryer, qoftë për sa i përket qasjes së ndjekur në analizën financiare kryer në Komision, ashtu edhe për sa i përket analizës së sipër përmbledhur për mënyrën e përfitimit të kredisë në kushte lehtësuese, që përbën këstin e

⁹ Paragrafët 1.55 deri në 1.60 të vendimit të Komisionit. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-M-Mertiri.pdf>.

dytë të pagesës së apartamentit. Konkretisht, Komisionerja potencon se analiza financiare e personave të tjerë të lidhur/dhuresve nuk duhet të ishte kufizuar vetëm në vlerën e shumës objekt dhurimi, por në analizë të përfshiheshin edhe të ardhurat dhe shpenzimet e tjera të dokumentuara të tyre, mbi bazën e një interpretimi të zgjeruar të kësaj dispozite dhe për shkaqe *specifike* të çështjes. Të njëjtin qëndrim, Komisionerja e mbajti edhe gjatë gjykimit në Kolegj, duke argumentuar se aktet në fashikujt e administruar në Komision tregojnë se analiza nuk do të ishte objektive dhe tërësore nëse përjashtohen këto të dhëna *a priori*, për shkak të një interpretimi të ngushtë të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

15.3. Për sa më sipër, Komisionerja Publike potencoi nevojën e përfshirjes në analizë edhe të investimit të dhuruesit, z. M. M., në shoqërinë tregtare “{***}” ShA, në vitin 2004, si dhe zotërimin e 40% të aksioneve, me vlerë nominale 4.000.000 lekë, në kushtet që prej kësaj shoqërie tregtare, dhuruesi gjeneroi të ardhurat nga të cilat u mundësua edhe dhurimi në favor të bashkëshortit të subjektit. Me të njëjtin arsyetim, nga Komisionerja u kërkua të përfshihen në analizë edhe përfitimet nga shitja e kuotave të kësaj shoqërie tregtare, më datë 03.09.2004 – me vlerën 400.000 lekë, si dhe të ardhurat e përfituara – me vlerë 2.600.000 lekë, për harkun kohor 2004 – 2006 nga likuidimi i shoqërisë “{***}” ShA.

15.4. Po ashtu, Komisionerja Publike kërkoi që në analizën financiare të vjehrrit të subjektit, z. T. M., si dhurues i shumës 1.260.000 lekë, ndryshe nga sa ka vepruar Komisioni, (i) të *mos përfshihen* të ardhurat nga qiraja dhe nga shitja e një autobusi, të cilat nuk janë deklaruar si burim për dhurimin; (ii) të *përfshihet* vlera 4.000.000 lekë, të cilën subjekti ka pretenduar gjatë hetimit administrativ se vjehri ia dhuroi bashkëshortit të saj për investimin në shoqërinë “{***}” ShA; (iii) të *mos përfshihen* të ardhurat e vjehrrit nga punësimi informal në transportin e udhëtarëve apo punësimi informal në emigracion, në kushtet që sipas akteve dhe deklarimeve të subjektit, ato u përdorën për dhurimin në funksion të investimit në të njëjtën shoqëri tregtare [e nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e shumës që i dhuroi bashkëshortit të subjektit për blerjen e apartamentit]. Me të njëjtën logjikë, të ardhurat e vjehrrit nga qiraja dhe shitja e autobusit kanë shërbyer për shpenzimet e jetesës.

15.5. Për sa i përket kriterëve ligjore për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, në pikëvështrimin e Komisioneres Publike, mbështetur edhe në gjetjet e ONM-së, Komisioni ka kryer një vlerësim të gabuar. Sipas Komisioneres Publike, përfitimi i kredisë në kundërshtim me kriteret ligjore, në vlerësimin tërësor të çështjes, çon në aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për cenim të besimit të publikut, dhe se të metat e konstatuara nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Sjellja e subjektit në këtë drejtim, cenon integritetin, pasi duket se ky përfitim është rrjedhojë e qenies prokurore. Këtë fakt Komisionerja Publike e lidh edhe me gjendjen në kushtet e konfliktit të interesit të subjektit në hetimet ndaj administratës së Bashkisë Fier [trajtuar në analizën e kriterit të vlerësimit profesional]. Më konkretisht, Komisionerja Publike pretendoi se: (i) subjekti kishte të ardhura të larta, që varionin nga 170.000 lekë deri në 190.000 në muaj, në krahasim me familjet e tjera përfituese dhe, për këtë arsye, nuk e plotësonte kriterin e të ardhurave maksimale që të kualifikohej në listën e familjeve përfituese; (ii) në analizën e të ardhurave të familjes së subjektit, duhet të shtohet edhe vlera e aksioneve që bashkëshorti zotëronte në shoqërinë “{***}” ShA; si dhe (iii) kërkoi mbajtjen në konsideratë të faktit që subjekti e ka blerë këtë

banesë me një çmim në dukje preferencial dhe e ka shitur në kundërshtim me pikën 1 të nenit 20 të ligjit nr. 9232/2004.

15.6. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti i kundërshtoi të gjitha aspektet e shkaqeve të ankimit të përmbledhura më sipër. Konkretisht, subjekti argumentoi se shtrirja e analizës financiare të personave të tjerë të lidhur përtej kufijve të dhurimeve të tyre do ta ngarkonte atë me një barrë disproporcionale për të justifikuar të gjithë pasuritë e personave të tjerë të lidhur. Sipas subjektit, Komisionerja Publike nuk ka argumentuar përse rasti i saj është *specifik*, për të lejuar kryerjen e një analize që vjen në kundërshtim edhe me praktikën e Kolegjit. Si përfundim, subjekti parashtrroi se analiza e kryer nga Komisioni është e drejtë dhe duhet të pranohet si e tillë nga Kolegji.

15.7. Subjekti po ashtu argumentoi se përfitimi i kredisë në kushte lehtësuese është në përputhje me ligjin nr. 9232/2004. Ajo dhe bashkëshorti plotësonin të gjitha kriteret, përfshirë ato financiare, pasi të ardhurat e tyre nuk ishin gjithmonë në nivelin e potencuar nga Komisionerja Publike, nuk kishin në pronësi banesë tjetër dhe përmbushnin kushtet familjare të përcaktuara nga ligji. Banesa e blerë në tregun e lirë nuk përbënte banesë sociale. Po ashtu, subjekti potencoi se nuk ka kryer procedime penale në kushtet e konfliktit të interesit me palë Bashkinë Fier apo Këshillin Bashkiak.

15.8. Pasi analizoi aktet në fashikull, shpjegimet e subjektit dhe provat e administruara në procesin gjyqësor, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi *pjesërisht të drejtë* kërkimin e Komisioneres Publike. Në vijim të këtij vlerësimi dhe analizës së kryer, *së pari*, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme të mjaftueshme për mbulimin e kështit të parë të apartamentit. *Së dyti*, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ketë plotësuar kriteret ligjore për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, sikurse edhe të ketë vepruar në përputhje me detyrimet ligjore që ndalojnë tjetërsimin e banesave të përfituara nga programet sociale. Arsytimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion i trupit gjykues të Kolegjit detajohet në vijim.

I.a.1. Pagesa e kështit të parë

15.9. *Së pari*, e në parantezë të analizës, trupi gjykues vëren se nga aktet rezulton se sipas kontratës¹⁰ për “Shitje sendi në të ardhmen”, palët shprehen se kësti i parë prej 2.260.000 lekësh u shlye ditën e nënshkrimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale. Kësti i dytë me vlerë 2.240.000 lekë do të likuidohej pas lëvrimit të kredisë. Ky deklaram përputhet me deklaramin e subjektit në deklaramin periodike vjetore për vitin 2011. Në kontratën e kredisë datë 02.08.2011, lidhur midis BKT-së dhe subjektit e personit të lidhur, është përcaktuar se vlera që disbursohej prej kredisë do të kalojë me transfertë bankare në llogari të shitësit [z. E. B. dhe znj. H. B.]. Blerësit/kredimarrës kanë vendosur si garanci pasuri të paluajtshme¹¹. Nga aktet rezulton, po ashtu, se kredia u disbursua më 24.08.2011. Në datën 25.08.2011 është likuiduar vlera 2.207.800 lekë në llogari të z. E. B., me përshkrimin *likuidim blerje apartamenti*. Përfundimisht, apartamenti rezulton të jetë fituar me kontratën e shitblerjes¹² datë 17.04.2012. Sipas shënimit në kontratë, likuidimi u bë tërësisht jashtë zyrës noteriale nëpërmjet bankës.

¹⁰ Kontrata nr. {***} rep/kol., datë 24.06.2011.

¹¹ Subjekti e bashkëshorti, për të garantuar kontratën e kredisë me bankën kanë vendosur në hipotekë truall e ndërtesë, me sipërfaqe 419,5 m² në pronësi të vjehrrit të subjektit.

¹² Nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2012.

Trupi gjykues vëren se pala shitëse në kontratën përfundimtare të shitjes është e ndryshme nga pala shitëse e referuar në kontratën e premtim shitjes¹³. Nuk rezulton të jetë hetuar ky aspekt e, për pasojë, nuk ka as shpjegime të subjektit në procesin e hetimit administrativ.

15.10. Nën dritën e sa përcakton neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016¹⁴, trupi gjykues i Kolegjit, në përputhje me jurisprudencën dhe orientimet e tij në çështjet e mëparshme, e shtriu analizën e burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur vetëm brenda kufijve të kontributit të tyre kundrejt krijimit të pasurive të deklaruara në deklaratën *vetting* të subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë e këtij vlerësimi, bazuar në analizën e të ardhurave të dokumentuara të personave të tjerë të lidhur, vjehri i subjektit të rivlerësimit rezultoi në pamundësi për të mbuluar dhurimin prej 1.260.000 lekësh në vitin 2011. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit rezultoi në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme dhe të pasaktësisë së deklarimeve, analizuar nën dritën e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, sikurse përcaktuar në germen “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

15.11. Në analizën e kryer sipas vlerësimit të mësipërm, për kufijtë e verifikimit të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, kriteri i përcaktuar në zbërthim të gjuhës së përdorur nga legjislatori për detyrimet e subjekteve në procesin e rivlerësimit, nga një lexim harmonik i pikës 4 të nenit 32 dhe pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ka gjetur elaborim të zgjeruar në përsëritje ndër vite në praktikën e Kolegjit. Konkretisht, trupa të ndryshëm gjykues të Kolegjit kanë vlerësuar në mënyrë konsistente që kontrolli i pasurive të personave të tjerë të lidhur do të shkojë përtej kufijve të kontributit të tyre vetëm nëse institucionet e rivlerësimit kanë indicie për të hetuar për pasuri të fshehura të subjekteve të rivlerësimit¹⁵. Përkundër pretendimit të Komisioneres Publike, trupi gjykues ka argumentuar në mënyrë konsistente se arsyetimi *jo i ngushtë* i kufijve që dikton neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 do të gjejë zbatim dhe pasuria e personave të tjerë të lidhur do t’i nënshtrohet verifikimit përtej kufijve të kontributit të tyre në drejtim të konfliktit të interesit. Në këtë drejtim, dhe pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht në vendime të mëhershme, trupi gjykues i Kolegjit çmon të ritheksojë se kontrolli i pasurive të personave të tjerë të lidhur apo ngarkimi i subjekteve me përgjegjësi për justifikimin e gjithë pasurive përtej kontributit të personave të tjerë të lidhur do të ishte, jo vetëm një barrë disproporcionale, por edhe e padrejtë e në kapërcim të qëllimit të procesit të rivlerësimit.

15.12. Përpos analizës së sipër referuar në nivel parimor, në rrethanat faktike konkrete, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë edhe specifikat e mundësive financiare të njërit prej personave të tjerë të lidhur, kunatit të subjektit të rivlerësimit, z. M. M., kushtëzuar

¹³ Konkretisht, ndërsa kontrata e datës 24.06.2011 ka për shitës z. E. B. dhe znj. H. B., kontrata përfundimtare e shitjes ka për palë shitëse z. M. G. dhe znj. E. G., të përfaqësuar me prokurë nga z. V. Z.

¹⁴ “[4.] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. [...]”.

¹⁵ Elaboruar, ndër të tjerë, në paragrafët 107-110, të vendimit të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit D. Rreshka (JR) nr. 15/2019, <https://kpa.al/juridiksion-rivleresimi-vendime-2019/>; paragrafin 13 dhe nënpjesët e tij dhe paragrafët 15.4 e 15.5 të vendimit të Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit R. Selimi (JR) nr. 22/2022 https://kpa.al/wpcontent/uploads/2022/09/Vendim_Rilinda_Selimi_perfshire_mendimet_paralele_anonimizuar.pdf; paragrafët 51 e 52 të vendimit të Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit I. Balli (JR) nr. 14/2021 https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/09/Vendimi_Irma-Balli_perfshire_mendim_pakice_anonimizuar.pdf; paragrafët 17.12-17.16 dhe paragrafin 18.7 të vendimit të Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit E. Toro (JR) nr. 2/2023 <https://kpa.al/wp-content/uploads/2023/04/Vendim-JR-Elona-Toro-i-anonimizuarpdf.pdf>.

potencialisht nga aktivitetet fitimprurëse të krijuara prej tij dhe bashkëjetueses. Pas këtij konstatimi, trupi gjykues konkludoi që hetimi i mundësive financiare të këtij individ, përtë kufijve të dhurimit, do të paraqitej me cilësi qenësisht të ndryshme nga natyra e hetimit administrativ që kryhet në procesin e rivlerësimit. Po ashtu, në kushtet kur Komisioni nuk ka kryer hetim të thelluar për interesat e tjerë financiarë të kunatit, dhe mungojnë akte për të analizuar saktësisht fondet që ai mund të ketë pasur në dispozicion për të mbuluar investimet, kërkesa e Komisioneres Publike, që kërkon të përfshihen në analizë edhe investimet, do të ishte e pamundur.

15.13. Me fjalë të tjera, edhe duke abstraguar nga parimet e procesit të rivlerësimit elaboruar më lart, në gjendjen që janë aktet, trupi gjykues i Kolegjit nuk ka të dhëna shteruese apo mundësi për të konstatuar saktësinë e tyre, për të konkluduar nëse dhuruesi ka pasur të ardhura të tjera të ligjshme për t'i përfshirë në analizë, sikurse as të dhëna për sa i përket investimeve dhe shpenzimeve të këtij personi tjetër të lidhur. Për këtë shkak, në mungesë të dokumentacionit të plotë, përfshirja në analizë e investimeve, duke tejkalluar kufijtë e përcaktuar nga pika 4, e nenit 32 e ligjit nr. 84/2016, u vlerësua edhe në rrethanat konkrete se do të përbënte një zgjedhje arbitrare, të padrejtë për subjektin, dhe të pamundur e në mospërputhje me efikasitetin gjyqësor dhe qëllimet e procesit të rivlerësimit.

15.14. Në vijim të këtij qëndrimi, u krye analiza e mundësive financiare të kunatit/personit tjetër të lidhur të subjektit, për të dhuruar vlerën 1.000.000 lekë, bazuar në të ardhurat nga paga e tij dhe ajo e bashkëjetueses, sipas dokumentacionit mbështetës të përcjellë nga subjekti në Komision duke zbritur shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare ndër vite. Nga kjo analizë, këta persona rezultuan me mundësi financiare të mjaftueshme për të dhuruar shumën 1.000.000 lekë në vitin 2011. Në drejtim të arsytimit të këtij konkluzioni, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në pah disa elementë. *Së pari*, në analizën e kryer në Kolegj, sikurse edhe në Komision, nuk u përllogaritën të ardhurat e referuara si burim për këtë dhurim në deklaratën *vetting*, nga shitja e kuotave në “{***}” ShPK, në shtator 2007. Në kushtet që jo vetëm nuk është administruar dokumentacion për vlerën e investimit *fillestar* apo *ecurinë* e tij -- nëse ka gjeneruar shtesë/pakësim apo ka qëndruar në të njëjtën vlerë -- gjatë kohës që ka qenë zotëruar prej bashkëjetueses së kunatit, znj. G., të ardhurat nga kjo kontratë nuk u përfshinë në përllogaritjen e burimeve në disponim të personave të tjerë të lidhur, nën dritën e dispozitave të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016¹⁶, pasi mungon qartësia e dokumentacioni mbështetës për pyetjet e sipër renditura.

15.15. *Së dyti*, dhe ç'është më e rëndësishme, në ndryshim nga Komisioni, në Kolegj analiza përfshiu edhe vitin 2004. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi jo objektiv dhe kontradiktor në vetvete qasjen e Komisionit për të vendosur vitin 2005 si kufi kohor të analizës së mundësive të personit tjetër të lidhur për dhurimin, meqenëse *investimi është bërë shumë kohë para dhurimit*. Lëvizja në kohë është e pabazuar, pasi jo vetëm që përfshin vetëm një vit, duke shkuar mbrapsht në kohë gjashtë vite përkundër shtatë, dhe nuk pasqyron as deklaratimet dhe as aktet e sjella nga subjekti. E thënë ndryshe, në kushtet kur Komisioni, gjithsesi, ka përfshirë në analizë edhe të ardhura të krijuara nga personat e tjerë të lidhur disa vite përpara dhurimit

¹⁶ “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelitit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. [...]”

objekt analize, vendosja e kufirit kohor ndarës në vitin 2005 dhe jo në vitin 2004 – ndonëse ky i fundit është kufiri kohor i vendosur shprehimisht dhe mbështetur të ardhurat me dokumentacion nga subjekti – praktikisht ka vetëm një efekt: *përrjashton* nga analiza e personave të tjerë të lidhur shpenzimet e kryera prej tyre në vitet 2002 – 2004, kur ata kanë kryer investimet kryesore e të konsiderueshme.

15.16. Ky qëndrim i Komisionit duket alogjik edhe duke mbajtur në konsideratë që përbën ndryshim nga vlerësimi i mëparshëm i tij [Komisionit] për kufijtë e analizës financiare për personat e tjerë të lidhur, pasi ka marrë prapësimet e subjektit për rezultatet e hetimit, bazuar në dy interpretime të ndryshme të së njëjtës dispozitë, nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, nga vendimi rezulton se Komisioni ka përfshirë investimet e kunatit të subjektit dhe bashkëjetueses së tij në shoqërinë “{***}” ShA dhe “{***}” ShA, duke referuar në mënyrë të shprehur gjetjen e Vëzhguesit Ndërkombëtar depozituar në datën 06.10.2022 dhe nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në vijim, mbi bazën e të njëjtës dispozitë, Komisioni nuk ka përfshirë investimet e personave të tjerë të lidhur *bazuar në vendimet e konsoliduara të Kolegjit*, ndonëse vendimet e Kolegjit [referuar edhe më sipër në paragrafin 15.10- 15.11], për kufijtë e hetimit të personave të tjerë të lidhur, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ishin të shpallura e të aksesueshme në faqen zyrtare edhe në momentin kur Komisioni ka përfunduar hetimin administrativ dhe dërguar subjektit rezultatet e hetimit¹⁷, nëpërmjet të cilave ka interpretuar ndryshe të njëjtën dispozitë. Në vendimin e Komisionit nuk rezulton ndonjë arsyetim në kuptim të peshës provuese të ndryshuar që i ka dhënë Komisioni përfundimisht Gjetjes së Vëzhguesit Ndërkombëtar, pas vlerësimit fillestar që duket të ketë qenë për ta pranuar si provë, në kuptim të nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016¹⁸.

15.17. Në përmbledhje dhe pas analizës së kryer në Kolegj, mbi bazën e vlerësimit të çështjeve si referuar më sipër, balanca pozitive e përfutur nga analiza e kryer nga Komisioni ndryshon në vlerë¹⁹ në analizën e kryer në Kolegj, por gjithsesi mbetet pozitive. Për rrjedhojë, në kushtet kur kunati i subjektit rezulton me mundësi të dhurimit të vlerës me të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëjetueses²⁰, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se mbetet pa rëndësi përcaktuese përfshirja e të ardhurave nga likuidimi i shoqërisë “{***}” ShA, në vitin 2006, potencuar si jo përcaktuese edhe nga Komisionerja Publike në ankim²¹, ndonëse në një kah të ndryshëm nga analiza e mësipërme e Kolegjit.

15.18. Për sa i përket burimit tjetër financiar që ka shërbyer për këstin e parë të apartamentit, dhurimi nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, në analizën e kryer në Kolegj u mbajtën në konsideratë vetëm të ardhurat e dokumentuara, sikurse parashtruar edhe nga Komisionerja Publike në ankim. Po ashtu, në analizën e burimeve të ligjshme u përllorarit si shpenzim edhe

¹⁷ Përfunduar më 01.11.2022, sikurse referohet në paragrafin 12 të vendimit të Komisionit.

¹⁸ “[10.] Gjetja, e paraqitur në formën e një deklaratë, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelitimit e çmon gjetjen si të barasvlerëshme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelitimit. [...]”.

¹⁹ Konkretisht, nga analiza e kryer në Komision, personi tjetër i lidhur/kunati i subjektit rezulton me një balancë pozitive prej 2.683.549 lekësh edhe pas përlloraritjes së dhurimit. Kjo balancë në Kolegj rezultoi në vlerën 2.039.509 lekë.

²⁰ Konfirmuar nga Drejtoria e Arkivit Qendror, për kontributet mbi pagën për periudhën e dokumentuar prej vitit 2004 deri në momentin e dhurimit të vlerës objekt analize.

²¹ Paragrafi 16.1.4. i ankimit.

dhurimi i vitit 2004, në favor të personit të lidhur me subjektin/bashkëshortin, që ka shërbyer për të financuar aksionet e zotëruara në kapitalin e një personi juridik²². Kjo pasuri analizohet në detaj në vijim, në paragrafin nr. 16. Përfshirja në analizë e këtij dhurimi është në përputhje me sa referon vjehri i subjektit në deklaratën noteriale të datës 03.02.2016²³. Në kushtet që kjo pjesëmarrje/investim i bashkëshortit ka vijuar dhe, sipas akteve, ishte aktiv edhe në momentin kur subjekti ka dorëzuar deklaratën *vetting*, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar përjashtimin nga analiza e kësaj vlere, sikurse ka vlerësuar Komisioni.

15.19. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se vlerësimi përfundimtar i Komisionit, nëpërmjet të cilit është anashkaluar dhurimi prej 4.000.000 lekësh nga analiza e kryer për personin tjetër të lidhur, përbën një qëndrim inkohorent, përveçse të pabazuar. Në ndryshim nga vlerësimi i kryer gjatë hetimit administrativ, pasi ka administruar prapësimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka rishikuar edhe interpretimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke barazuar në thelb dhurimin me investimet e kryera nga personat e tjerë të lidhur për interesa financiare të tyre të palidhura me subjektet e rivlerësimit. Konkretisht, siç rezulton nga paragrafi 1.49 i vendimit, Komisioni e ka përjashtuar dhurimin e vitit 2004 nga vjehri për shkak të *kohës* kur ka ndodhur, për shkak të parimit të *proporcionalitetit*, si dhe duke referuar kufijtë e hetimit që zbatohen për investimet personale/familjare të *personave të tjerë të lidhur*, ndonëse në rrethanat konkrete bëhej fjalë për një dhurim personit të lidhur me subjektin.

15.20. Të tria këto baza arsyetimi nuk qëndrojnë. *Së pari*, neni 30 i ligjit nr. 84/2016 dikton kontrollin e pasurive të personave të lidhur me subjektet. Kjo dispozitë nuk kushtëzohet *a priori* nga ndonjë moment kohor për personat e lidhur. Edhe duke abstraguuar nga kontrolli *ipso lege*, të cilit i nënshtrohen personat e lidhur, lëvizja në kohë e kontrollit të mundësive financiare të vjehrit për vetëm një vit, gjithsesi, vite përpara dhurimit të vitit 2011 – nga viti 2004 në vitin 2005 – ka pasur si pasojë vetëm përjashtimin nga analiza e këtij shpenzimi. Pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër për të njëjtën qasje që ka zgjedhur Komisioni për analizën e mundësive të kunatit, në të njëjtën linjë, trupi gjykues i Kolegjit vëren inkoherencën e këtij qëndrimi që konsiston vetëm në një vit. Me fjalë të tjera, nëse koha e gjatë ishte realisht kriteri që duhet të përjashtonte veprimet juridike të kryera nga vjehri i subjektit si parim, ndryshimi prej një viti – nga shtatë në gjashtë vite përpara dhurimit – nuk mund të argumentohet se shëron kontrollin për dhurimin e *bërë shumë vite përpara dhurimit të shumës subjektit*, sikurse arsyetohet në vendim. Kjo zgjedhje e Komisionit ka passjellë moskontrollimin e veprimeve të kryera në vitin 2004, sikurse edhe për kunatin e subjektit e, si rrjedhojë, edhe mënjanimin nga analiza të veprimeve financiare në vlera të konsiderueshme.

15.21. Përpos sa arsyetuar më sipër, personi juridik tek i cili është materializuar ky dhurim në favor të bashkëshortit të subjektit ekzistonte edhe pas martesë²⁴ dhe krijonte të ardhura për kunatin e bashkëshorten e tij, të cilët janë deklaruar si dhurues të shumës tjetër të përdorur për këstin e parë të apartamentit, me burim nga pagat e tyre prej kësaj shoqërie, sikurse arsyetohet

²² “{***}” ShA. Në kohën kur subjekti plotësoi deklaratën *vetting*, sipas përgjigjes së Qendrës Kombëtare të Biznesit, ajo ende ishte me status *aktiv*.

²³ Deklarata noteriale e vjehrit të subjektit nr. {***} rep., nr. {***} kol.

²⁴ Sipas Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, shoqëria kishte fituar status pasiv në datën 06.05.2010 ndërsa sipas QKB-së ishte me status aktiv deri më 01.08.2017, minimalisht.

në paragrafët 15.9-15.17. Me fjalë të tjera, pavarësisht nga koha kur është kryer dhurimi, është e pamundur të argumentohet se subjekti nuk krijon përfitime prej tij.

15.22. *Së dyti*, Komisioni referon parimin e proporcionalitetit pa e shoqëruar me një arsyetim përse gjen zbatim për këtë aspekt të veçantë nën dritën e rrethanave faktike e ligjore të sipër përmbledhura, sikurse as sesi vlerësohet në raport me konkluzione të tjera, dhe përse është gjetur me vend zbatimi i këtij parimi, pasi i ka kaluar subjektit barrë prove edhe për këtë dhurim.

15.23. *Së treti*, analogjia me kufijtë e kontrollit të pasurive të personave të tjerë të lidhur, me fokus kunatin e subjektit edhe në rastin e vjehrrit, është haptazi e pakuptimtë e bie ndesh me ligjin. Ndërsa nën dritën e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet mundësia e personit/personave të tjerë të lidhur për të kontribuar në krijimin e pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit. Përjashtimi i dhurimeve në favor të personit të lidhur e më pas edhe vetë subjektit të rivlerësimit, sikurse ka vepruar Komisioni, duke e barazuar me investim për emër e të kryer nga një person tjetër i lidhur – referuar shprehimisht në paragrafin 1.49 të vendimit – përbën një qëndrim të pakuptimtë e arbitrar, pasi bie ndesh me ligjin, por edhe me logjikën e qëndrimeve të mbajtura për të njëjtën çështje ligjore te personi tjetër i lidhur/kunati i subjektit. Me fjalë të tjera, Komisioni ka trajtuar dhurimin nga vjehri i subjektit si investim të tij, ndonëse në asnjë çast apo fazë të procesit, as subjekti dhe as deklaruesi/dhuruesi nuk kanë kontestuar natyrën e vërtetë të kësaj shume të dhënë, që ishte *dhuratë* në favor të personit të lidhur/subjektit.

15.24. Duke iu rikthyer analizës së kryer në Kolegj për mundësinë e dhurimit të dy shumave nga vjehri i subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka përfshirë në të ardhurat e vjehrrit të subjektit, përveç të ardhurave nga pagat edhe të ardhura nga dhënia me qira e autobusit për vitet 2005 – 2007, sikurse edhe nga shitja e tij. Komisionerja Publike ka argumentuar kundër përfshirjes së të ardhurave nga qiradhënia e automjetit dhe shitja e tij, duke mbajtur parasysh që të ardhurat nga është krijuar kjo pasuri e luajtshme, emigracioni, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizë, pasi nuk provohet ligjshmëria e tyre.

15.25. Në prapësim të këtyre kërkimeve të Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si në Komision edhe gjatë gjykimit në Kolegj. Ajo kërkoi përfshirjen e të gjitha të ardhurave, sipas analizës përfundimtare të Komisionit. Nga parashtrimet e saj në Kolegj, rezultoi që subjekti u përpoq të fokusojë te të ardhurat e gjeneruara prej aktivitetit të vjehrrit në Shqipëri, duke mos i dhënë peshë të ardhurave nga emigracioni i vjehrrit. Konkretisht, subjekti u fokusua në faktin që detyrimet tatimore për qiranë e automjetit i përkisnin qiramarrësit, si dhe theksoi mungesën e detyrimit tatimor në ngarkim të vjehrrit në momentin e shitjes së autobusit. Subjekti, po ashtu, kontestoi mosnjohjen e të ardhurave të deklaruara nga aktiviteti blegtoral.

15.26. Nga analiza e kryer mbi bazën e akteve në fashikull nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të bazuar këtë pretendim të Komisioneres. Si rrjedhojë, edhe në analizën e kryer në Kolegj në vlerësim të këtij shkaku ankimi, ndër të ardhurat e vjehrrit të subjektit nuk u përfshinë ato me burim nga: (i) emigracioni; (ii) blegtorial dhe kostot e investimit në aktivitetin blegtoral; (iii) kthimi i një huaje vjehrrit të subjektit; si

dhe (iv) qiraja e autobusit. Në këtë konkluzion, trupi gjykues u bazua në aktet dhe analizën e referuar në vijim.

15.27. Në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar si burim për dhurimin nga vjehri: (i) kursime familjare; (ii) të ardhurat nga emigracioni në vitet 1992-1998, në Greqi; (iii) të ardhura nga punësimi në blegtori në Gjirokastrë; si dhe (iv) në transportin e udhëtarëve. Për të ardhurat nga shërbimi i vjehrit në transportin e udhëtarëve, subjekti ka përfshirë edhe kontratën e blerjes së automjetit në vitin 1999. Këtë periudhë subjekti e ka cilësuar si *periudhë punësimi informale*. Subjekti ka bashkëlidhur një kontratë huaje nëpërmjet të cilës vjehri, në cilësinë e huadhënësit, i ka dhënë një individ 960.000 lekë në vitin 1994. Përkundër sa më sipër, në deklaratën *periodike të vitit 2011*, subjekti ka deklaruar si burim të të ardhurave të vjehrit kursimet e tij nga *puna dhe emigracioni*.

15.28. Në vijim, nëpërmjet përgjigjeve në pyetësorë, subjekti ka parashtruar pamundësinë objektive për të provuar të ardhurat e vjehrit nga emigracioni, ka paraqitur një deklaratë noteriale të hartuar në vitin 2020²⁵, sipas së cilës huamarrësi shprehet se ka kthyer shumën 960.000 lekë vjehrit të subjektit në vitin 2009, të ardhura nga qiradhënia e një autobusi në vitet 2002 – 2007 dhe të shitjes së tij në vitin 2007, një vërtetim për ushtrim aktiviteti blegtorie, si dhe vërtetim të ardhurash nga punësimi i vjehrit²⁶ e të ardhura nga punësimi i vjehrrës.

15.29. Nga sa më sipër, rezulton se ndërsa të ardhurat nga emigracioni, të cilat kanë shërbyer për krijimin e automjetit, mbetën në nivel deklarativ, dhe subjekti nuk ka provuar burime të tjera për krijimin e likuiditeteve që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive, vjehri i subjektit ka identifikuar si burim të ardhurash në shkurt 2016 vetëm ato nga emigracioni, përfshirë edhe për blerjen e automjetit të dhënë me qira më pas. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të bazuar pretendimin e Komisioneres Publike për mospërfshirjen e të ardhurave nga qiraja e autobusit, nga shitja e tij apo të të ardhurave të gjeneruara, si edhe të ardhurat e deklaruara të krijuara me këtë burim. Edhe në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, këto të ardhura nuk përmbushin kriterin e ligjshmërisë përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

15.30. Në analizën e kryer në Kolegj u përfshinë vetëm të ardhurat e dokumentuara të prindërve të bashkëshortit të subjektit nga viti 1994 e deri në momentin e dhurimit. Në mungesë të dokumentacionit të administruar nga Komisioni për përbërjen familjare ndër vite, në Kolegj u zbritën shpenzimet e jetesës vetëm për dy persona. Nga kjo analizë, vjehri i subjektit rezultoi me mungesë burimesh për të dhuruar shumën 1.260.000 lekë në vitin 2011. Balanca negative do të thellohej nëse shpenzimet e jetesës do të pasqyronin përbërjen familjare duke filluar nga viti 1994.

15.31. Sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit nuk përfshiu në analizë të ardhurat nga kthimi i huasë, që sipas huamarrësit ka ndodhur në vitin 2009. Edhe në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, kthimi i shumës në atë moment kohor është në mospërputhje me gjithë aktet dokumentare, përveçse nuk ka lënë asnjë gjurmë në veprime bankare apo të tjera të periudhës përpara rivlerësimit. Konkretisht, në kontratën e huas, që mban datën 26.11.1994, lidhur në prani të një avokateje, palët kanë rënë dakord që kthimi të bëhet brenda një viti, deri

²⁵ Nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.06.2020.

²⁶ Punësuar pranë shoqërisë "{***}" ShA: shoqërisë "{***}" ShPK dhe shoqërisë "{***}" ShA.

në datën 26.11.1995 dhe me kusht që në çdo datë 26 [të muajve të ndërmjetëm] huamarrësi të likuidojë huanë me nga 30.000 lekë brenda afatit të përcaktuar. Në këto kushte, pretendimi se ndonëse palët kanë identifikuar në mënyrë specifike detyrimet e huamarrësit për çdo muaj gjatë harkut kohor njëvjeçar dhe pikën fundore të shlyerjes së detyrimit, deklarata noteriale e hartuar prej huamarrësit gjatë procesit të rivlerësimit [shih më sipër], sipas së cilit në fakt ai ka shlyer pagesën 14 vjet pasi ka përfunduar afati, është jobindëse dhe e pambështetur në asnjë akt të kohës. Ky burim krijimi nuk rezulton të jetë identifikuar prej vjehrrit të subjektit qoftë në kontratën e dhurimit të vitit 2012 dhe mbi të gjitha në deklaratën noteriale të vitit 2016. Për këto arsye, ndonëse ekzistenca e marrëdhënies së huas në vetvete nuk paraqet probleme besueshmërie, deklarata e vitit 2020 u vlerësua si përpjekje e subjektit për të provuar pretendimet e saj gjatë procesit të rivlerësimit për likuiditete të disponuara nga vjehri në një kohë të përafërt me dhurimin e vitit 2011. Nën dritën e testit të përcaktuar në pikën 4²⁷ të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për një vendimmarrje mbi bazë të akteve që janë në pajtueshmëri me provat e tjera, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit²⁸, trupi gjykues vlerëson se huaja duhet të ketë ndjekur rrjedhën e parashikuar e dakordësuar nga palët dhe kthyer në vitin 1995. Duke pasur parasysh kohën e gjatë mes kthimit, në vitin 1995, e momentit të dhurimit për apartamentin, në vitin 2011, sikurse edhe pretendimet e shpjegimet e subjektit për të ardhurat e vjehrrit që kanë shërbyer për këtë dhurim -- duke nisur nga viti 2004 -- kjo shumë nuk u përfshi në analizën financiare të tij për dhurimin për këstin e parë të apartamentit.

15.32. Duke pasur në konsideratë deklarimin e subjektit në deklaratën *vetting*, si dhe deklaratën noteriale të vjehrrit në vitin 2016, ku punësimi në *emigracion* referohet si informal [*si emigrant i paligjshëm* dhe nga *periudhë informale punësimi*], përjashtohet edhe përmbushja e kriterit të ligjshmërisë parashikuar nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pika 19 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, nga aktet në fashikull provohet marrëdhënia e qirasë së automjetit e lidhur nga vjehri i subjekti me një person juridik në vitet 2004-2007 dhe shlyerja e detyrimeve tatimore prej këtij të fundit²⁹. Duke mbajtur në konsideratë informalitetin e krijimit të këtyre të ardhurave, mungesën e të dhënave të sakta për sasinë e krijuar dhe kohën gjatë së cilës ato janë gjeneruar, sikurse edhe faktin që e gjithë kjo marrëdhënie është bazuar mbi të drejta pronësie të krijuara nga të ardhura deklarative nga emigracioni dhe punësimi informal, që përfshin në mënyrë specifike [sipas deklaratës *vetting*] të ardhurat nga emigracioni dhe blegtoria, edhe për të ardhurat nga transporti i udhëtarëve, trupi gjykues e vlerësoi të bazuar pretendimin e Komisioneres Publike. Këto të ardhura nuk u përfshinë në analizën e kryer për

²⁷ Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

²⁸ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit nr. 34/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Entela Prifti, paragrafi 85.2; vendimin e Kolegjit nr. 29/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi, paragrafët 32.5 dhe 34.3; vendimin e Kolegjit nr. 11/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri, paragrafi 20.2; si dhe vendimin e Kolegjit nr. 11/2022 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Elizabeta Imeraj, paragrafi 31.13.

²⁹ Vërtetim i inspektores së Degës së Tatimeve Fier, datë 13.02.2020, që konfirmon shlyerjen e detyrimit të qirasë për vitin 2004 dhe 2005. Në dosje është administruar edhe një vërtetim i vitit 2007, lëshuar po ashtu nga Inspektori i Degës së Tatimeve, pa vulë institucioni, i cili ka një përmbajtje të paqartë, por duket sikur midis palëve – vjehrrit të subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK – ekziston një kontratë me vlerë mujore 10.000 lekë dhe tatimi vjetor është 120.000 lekë. Citimi nga vërtetimi: “Vërtetohet se qiradhënësi T. M. dhe qiramarrësi “{***}” periudhën 01.01.07 deri më 31.12.07 kontrate ngarkes 10.000 lekë mujore dhe pagesë 120.000 tatimi lekë”.

të verifikuar mundësinë e dhurimeve në favor të subjektit dhe personit të lidhur, përfshirë edhe për apartamentin. Pas kontrollit të kësaj analize, u konstatua pamundësia e vjehrrit të subjektit për të dhuruar vlerën 1.260.000 lekë me të ardhura të ligjshme, pasi ai rezulton në balancë negative në vlerën (-) 4.010.293 lekë për të mbuluar dy dhurimet.

1.a.2. Kësti i dytë i apartamentit

15.33. Kësti i dytë i apartamentit është deklaruar i shlyer nëpërmjet kredisë me kushte lehtësuese akorduar nga Bashkia Fier, në vitin 2011. Sikurse referuar më sipër, Komisionerja Publike e ka argumentuar këtë shkak ankimi në drejtim të vlerësimit të pasurisë, por edhe të integritetit, si pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes, duke potencuar se subjekti nuk përmbushte disa prej kriterëve për të përfituar këtë lloj kredie që, sipas saj, përbën përfitim për shkak të funksionit si prokuror. Po ashtu, Komisionerja Publike argumenton se subjekti e ka shitur apartamentin në shkelje të dispozitave që normojnë kushtet dhe kufizimet që gjejnë zbatim në rastet e këtyre kredive, ndërsa blerjen e ka kryer kundrejt një çmimi preferencial. Në tërësi, Komisionerja Publike argumentoi se subjekti ka cenuar besimin e publikut nëpërmjet veprimeve që lidhen me përfitimin e kësaj kredie dhe shitjen e apartamentit të fituar nëpërmjet saj.

15.34. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi të gjithë argumentet e Komisioneres Publike në procesin e zhvilluar në Kolegj, duke potencuar se ajo dhe bashkëshorti plotësonin të gjitha kriteret. Ajo kundërshtoi qoftë çmimin në dukje preferencial të blerjes me argumentin se apartamenti është blerë në tregun e lirë dhe faktin që shitja është kryer për të mundësuar krijimin e një banese tjetër gjithsesi. Së fundmi, subjekti potencoi se mosgjetja e dokumentacionit të depozituar prej saj për përfitimin e kredisë është përgjegjësi e Bashkisë dhe, si e tillë, nuk duhet t'i ngarkohet në përgjegjësi asaj.

15.35. Në vlerësim të akteve në fashikull, shpjegimeve të subjektit dhe nga analiza e kryer nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se pretendimi i Komisioneres Publike është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ketë plotësuar kriteret ligjore për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, sikurse as të ketë vepruar në përputhje me detyrimet ligjore që ndalojnë tjetërsimin e banesave të përfituara nga programet sociale. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

15.36. Nga aktet rezulton se kredia objekt analize i është akorduar subjektit dhe familjes së saj (me tre anëtarë), në vijim të miratimit të listës së përfituesve, miratuar nga Këshilli Bashkiak Fier, në korrik 2010. Në datën 02.08.2011, është miratuar kredia në vlerën 2.240.000 lekë me afat 20-vjeçar dhe normë interesi 3% në muaj. Nëpërmjet kësaj kredie, të disbursuar më datë 24.08.2011, subjekti ka paguar këstin e dytë të apartamentit objekt analize. Më pas, në vitin 2017, subjekti e ka shitur këtë apartament me çmimin 5.500.000 lekë, duke përfituar 1.100.000 lekë nga transaksioni, ndërsa vijonte shlyerjen e kredisë me kushte lehtësuese.

15.37. Sipas ligjit nr. 9232/2004 dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, nr. 6257/2008 “*Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti*” (në vijim Udhëzimi nr. 6257/2008), programet sociale të strehimit kanë për fokus familjet apo individët të cilët për shkaqe ekonomike e sociale nuk mund të përballojnë çmimet e banesave

në treg apo atë të kredive hipotekore. Ligji mundëson ndihmën e shtetit për të krijuar kushte strehimi të përshtatshme dhe të përballeshme për familjet në nevojë. Në nenin 3 të këtij ligji, janë përcaktuar tri lloje programesh sociale të familjeve në nevojë, që përfshijnë: (i) *programe të banesave sociale me qira, [...]; (ii) programe të banesave me kosto të ulët; si dhe (iii) programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë.*

15.38. Subjekti dhe familja e saj referohet të kenë përfituar këtë trajtim mbi bazën e pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 9232/2004, me statusin e të pastrehut. Sipas kësaj dispozite³⁰, lexuar në harmoni me nenin 25 të të njëjtit ligj, të ardhurat modeste – sipas parametrave të përcaktuar – ishin kriter thelbësor, ndërsa masa e subvencionit nga të ardhurat nga buxheti i shtetit, në funksion të shlyerjes së kësaj kredie, kushtëzohej nga ky kriter³¹. Me fjalë të tjera, të ardhurat modeste ishin një kusht thelbësor për të përfituar kredi hipotekore për blerje nga tregu i lirë. Udhëzimi nr. 6257/2008, në pikat 5 dhe 6, parashikonte si kushte kumulative mungesën e një banesë në pronësi, së bashku me kriterin e të ardhurave *brenda kufijve që përcaktohen nga Ministria që mbulon fushën e strehimit, në bashkëpunim me bankën dhe që mosplotësimi i dy kushteve të mësipërme përbënte kriter skualifikues*. Ndërsa, sipas nenit 4³² të këtij ligji, familjet që klasifikohen për t'u trajtuar sipas programeve sociale të strehimit, ndër të tjerat, *nuk duhet të kishin banesë në pronësi*. Në njërën nga këto kategori, përfshihen vetëm ato familje që kishin të ardhura të pamjaftueshme. *Së dyti*, ligji parashikonte kufizime të shprehura për tjetërsimin e banesës, deri në 15 vjet pas shlyerjes së detyrimeve³³. *Së treti*, ligji përcaktonte përparësi për çiftet që moshën e kombinuar duhet ta kishin nën 55 vjeç³⁴.

15.39. Në kushtet që mosdisponimi i banesës në pronësi nuk kontestohet³⁵ çështja e mosplotësimit të kriterëve financiarë mbetet kriteri përjashtues, të cilin subjekti *nuk e*

³⁰ *Kjo dispozitë parashikonte: "[2]. Për përcaktimin e këtyre kufijve zyrat përkatëse në bashki bazohen: (a) në vlerën e banesës së ndërtuar ose të blerë në treg; (b) në aftësinë paguese të familjes, nivel i pranueshëm i së cilës merret pagesa e kësteve mujore të kredisë, e cila nuk duhet t'i kalojë 35 për qind të të ardhurave të familjes; (c) në të ardhurat e familjes, të cilat, pas pagesës së kësteve të kredisë, nuk duhet të bien më poshtë se niveli i plotë i ndihmës ekonomike të miratuar nga Këshilli i Ministrave".*

³¹ *Neni 25 i ligjit nr. 9232/2004, parashikonte: 1. Familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore, me kushte lehtësuese, nga një institucion financiar që ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave për menaxhimin e kredive. Kushtet e dhënies nga bankat të kredisë për familjet përcaktohen me marrëveshje të përbashkët të Ministrisë të Financave, ministrit që mbulon fushën e strehimit dhe institucionit që jep dhe menaxhon kredinë. 2. Ndihma e shtetit jepet në formën e subvencionimit të interesave të kredisë për ato familje që nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar, sipas shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 19 të këtij ligji. Masa e subvencionimit të interesave të kredisë jepet sipas aftësisë paguese të familjes dhe përcaktohet nga Ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin që mbulon fushën e strehimit. [...] [Udhëzim nr. 6257/2008]".*

³² *Neni 4 i ligjit të sipër referuar parashikonte: "1. Familjet, që klasifikohen për t'u trajtuar me programe sociale të strehimit, miratohen me vendim të këshillit bashkiak, sipas kriterëve të mëposhtme: (a) nuk kanë në pronësi një banesë; [...]. 2. Përfshihen në një nga shkronjat "a", "b" dhe "c" vetëm ato familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit 6 të këtij ligji. [...]".*

³³ *Neni 20 parashikonte: "1. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t'i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë te një person tjetër, apo ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë. 2. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët dhe e ka shlyer atë, duke u bërë pronare e saj, detyrohet të mos e shesë për një periudhë 15-vjeçare. Kur familja, për arsye të ndryshme, kërkon ta shesë banesën brenda këtij afati, ajo detyrohet t'ia shesë këtë banesë subjektit, të cilit ia ka blerë dhe me vlerë jo më shumë sesa vlera me të cilën është blerë".*

³⁴ *Trajtohen me përparësi individët ose familjet që plotësojnë kushtet e nenit 4 pika 1 dhe që kanë këto specifika:[...] e) çiftet e reja me moshë totale deri në 55 vjeç;[...]*".

³⁵ *Gjatë procesit të hetimit në Komisionit, në përgjigje të pyetësor standard, subjekti ka deklaruar që nga nëntori 2008 deri në dhjetor 2011 ka jetuar me qira dhe nuk e disponon kontratën e qirasë. Po ashtu, nga certifikata e pronësisë rezultoi se shtëpia në lagjen "[***]", Fier, ajo rezultoi në pronësi të vjehrrit të subjektit. Nga informacioni i ASHK-së, dërguar pranë Bashkisë Fier nga subjekti në kuadër të dorëzimit të dokumentacionit të*

përmbushte në momentin e përfitimit të kredisë. Niveli minimal dhe maksimal i të ardhurave të familjeve që aplikonin, sipas nenit 19 të ligjit nr. 9232/2004, referon një formulë specifike. Nga aktet e depozituara në momentin e aplikimit për këtë kredi, rezulton se paga *bruto* e subjektit ishte 120.763 lekë dhe *neto* 96.851 lekë, ndërsa paga e personit të lidhur ishte 73.000 lekë. Sipas vërtetimeve të pagave të dorëzuara prej tyre³⁶, pas përfshirjes në listë nga Bashkia Fier, të ardhurat nga pagat bashkërisht arrinin në vlerën 174.000 lekë *bruto*/muaj dhe afërsisht 120.000 *neto*/muaj. Në të njëjtën kohë, bashkëshorti i subjektit zotëronte edhe aksione në vlerën 4.000.000 lekë në shoqërinë “{***}” ShA.

15.40. Subjekti ka paraqitur një shkresë të dytë, që mban datën 26.04.2022, nga Prokuroria pranë Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Sipas kësaj shkrese, të ardhurat e saj nga paga ishin më të ulëta sesa ato të përcjella prej saj bashkisë në vitin 2011, referuar një shkresë të të njëjtit institucion, duke paraqitur të ndarë pagën nga një fond i veçantë që ajo ka përfituar nga Njësia e Përbashkët Hetimore. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi këtë akt pa peshë provuese për dy arsye. *Së pari*, kjo shkresë e dytë, paraqet një panoramë financiare të ndryshme nga ajo e parashtruar në funksion të përfitimit të kredisë, mbi bazën e të cilës është bërë vlerësimi i kriterëve për përfitimin. *Së dyti*, kjo shkresë është hartuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe dukshëm paraqet një përpjekje për të ndryshuar situatën në favor të pretendimeve të saj gjatë këtij procesi. Për rrjedhojë, vërtetimi i pagës, mbi bazën e të cilit është miratuar kredia, u vlerësua akti zyrtar me fuqi të plotë i mbështetur edhe nga vetëdeklarimi i saj, për këtë qëllim, për të ardhura mujore në vlerën 150.000 lekë.

15.41. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit në rezultatet e hetimit se në muajin mars 2011 u ulën të ardhurat familjare, pasi bashkëshorti ishte pa punë, u vlerësua po ashtu pa peshë, gjithsesi në kushtet që në momentin e aplikimit dhe kualifikimit për kredi në fillim të vitit 2011, vendimi i Bashkisë Fier është bazuar mbi vërtetimin sipas të cilit bashkëshorti i subjektit paguhej me të ardhura bruto 73.000 lekë në muaj nga “{***}” Fier. Me fjalë të tjera, në kushtet që përmbushja e kriterëve vihet në pikëpyetje nën dritën e shkresave të paraqitura në momentin e aplikimit, është vetëm vlera financiare mbi të cilën është bazuar miratimi ajo që paraqet rëndësi në raport me shkakun ankimor konkret.

15.42. Në vijim të këtij arsyetimi, konkluzioni i Komisionit për këtë çështje, i bazuar mbi shkresën e mësipërme të vitit 2022 dhe dorëzuar nga subjekti në prapësim të rezultateve të hetimit, është i pabazuar dhe i pakuptimtë. Komisioni ka pranuar tërësisht shpjegimet e subjektit dhe nuk ka hetuar në drejtim të nivelit të të ardhurave që duhet të plotësonin personat që kualifikoheshin për strehim social, por ka konkluduar se procedura është ndjekur, kontrolluar dhe finalizuar nga Bashkia Fier, si organi përgjegjës, dhe se kredia nuk është revokuar. Për rrjedhojë, Komisioni ka konsideruar se përfitimi i kredisë ishte në përputhje me kriteret.

15.43. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në kushtet kur nuk është në diskutim *sasia* e të ardhurave familjare, por fakti nëse subjekti i përmbushte kriteret ligjore e nënligjore të kohës

nevojshëm për aplikim për kredinë me kushte lehtësuese, rezulton se as subjekti as bashkëshorti nuk kanë banesë në pronësi.

³⁶ Vërtetim i datës 13.01.2011 lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ku është përcaktuar paga bruto në masën 102.000 lekë/muaj (dhe neto 80.733 lekë) dhe vërtetimin e pagës bruto të bashkëshortit si Drejtor i Degës së Shitjes pranë “{***}” Fier që ishte në masën 72.000 lekë/muaj.

sipas akteve [dhe vlerave të referuara në to] në momentin e aplikimit, konkluzioni i Komisionit, bazuar në pretendimet e subjektit për të ardhura të ndryshme nga këto akte, është i pakuptimtë. Aplikimi i suksesshëm për kredi mbi bazën e të ardhurave të referuara në ato akte zyrtare është fakt i pakontestueshëm. Aktet e sjella nga subjekti gjatë dhe në funksion të ndryshimit të rezultatit të hetimeve, 11 vjet më pas, nuk janë ato mbi të cilat është mbështetur përfitimi i suksesshëm i kredisë. Pretendimi i subjektit se të ardhurat e saj familjare ishin më të ulëta nuk ishte njohur nga bashkia në momentin e miratimit. Për këto shkaqe, qoftë pretendimi i subjektit apo konkluzioni i Komisionit, për ta pranuar atë dhe zhbërë faktet e provat mbi të cilat është marrë vendimi, është alogjik.

15.44. Nga verifikimi i formulës së përlllogaritjes së kufirit maksimal të të ardhurave, në referim të dokumentacionit që përfshin vërtetimet e pagave të të dy bashkëshortëve, rezulton se Bashkia Fier ka miratuar kredinë me kushte lehtësuese, që si parim akordohet për familjet në nevojë, ndonëse subjekti e bashkëshorti përfitonin thuajse dyfishin e tavanit të pagave të vendosur si kriter i përcaktuar në lidhjen C të ligjit nr. 9232/2004. Sipas kësaj formule, në mënyrë që subjekti të kualifikohej për të përfituar kredinë me kushte lehtësuese, maksimumi duhet të ishte 61.296 lekë në muaj. Të ardhurat e subjektit e bashkëshortit rezultojnë afërsisht sa dyfishi i maksimumit, duke qenë përafërsisht 120.000 lekë *neto*/muaj apo 174.000 lekë *bruto*. Po ashtu, nëse këto të ardhura krahasohen me ato të familjeve të tjera përfituese, pasqyruar në listën e dërguar nga Bashkia Fier pranë BKT-së, më datë 30.03.2011, të ardhurat mujore të familjeve të përbëra nga tre anëtarë që kishin përfituar kredinë, sikurse subjekti, variojnë nga 35.000 deri në 78.000 lekë/muaj. Në këtë listë vetëm familja e subjektit me tre anëtarë dhe një familje që përbëhej nga pesë (5) anëtarë kishin deklaruar të ardhura në vlerën e deklaruar 120.000 lekë/muaj.

15.45. Për sa më lart, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit se nuk ka përfituar nëpërmjet programeve sociale parashikuar nga ligji nr. 9232/2004, duket se devijojnë nga qëllimi i këtij ligji. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 53/2005 “*Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale*”, që referon subjekti, nuk është i zbatueshëm në rastin konkret. Ky akt nënligjor iu referohet rasteve të përfitimit të strehimit nga programet e banesave sociale me qira. Subjekti nuk ka përfituar banesë sociale me qira, por ka përfituar banesë me kosto të ulët. Baza ligjore në rastin konkret është Udhëzimi nr. 6257/2008, i nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 9232/2004.

15.46. Një element tjetër që është kundërshtuar nga subjekti është edhe kriteri i përparësisë, që lidhej me moshën e kombinuar të çifteve të reja që përfitonin këto lloj kredish sipas ligjit. Ndonëse me më pak peshë sesa gjendja financiare që nuk përkon me atë të një familjeve në nevojë, edhe ky kriter duket se është anashkaluar në rastin e kredisë së akorduar subjektit. Në germën “e” të nenit 5 të ligjit nr. 9232/2004, në momentin kur subjekti ka kryer aplikimin dhe kualifikuar për kredinë, ishte përcaktuar edhe si kriter përparësie, mosha e çifteve të reja në total, që sipas dispozitës në fuqi, ishte 55 vjeç. Në vitin 2010, mosha e kombinuar e subjektit dhe bashkëshortit ishte 56³⁷ vjeç, ndërsa në momentin e akordimit të kredisë ishte 57 vjeç.

³⁷ Subjekti dhe bashkëshorti janë respektivisht të vitlindjeve 1984 dhe 1980.

15.47. Së fundmi, në kohën kur ka aplikuar për kreditë me kushte lehtësuese, subjekti nuk ka deklaruar zotërimin e aksioneve të bashkëshortit në shoqërinë “{***}” ShA. Sipas shpjegimeve të saj, shoqëria tregtare në fjalë nuk kishte fitim, ishte e krijuar nga bashkëshorti përpara se të lidhej martesë dhe subjekti nuk përfitonte të ardhura nga ai aktivitet. Po ashtu, ajo potencon se aktet ligjore të zbatueshme, në rastin e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, nuk e parashikonin në mënyrë të shprehur detyrimin për të deklaruar aksionet apo interesat të tjera private financiare, përfshirë edhe pronësinë e një shoqërie tregtare, por kërkohej deklarimi i të ardhurave dhe pasurive.

15.48. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se qëllimi i ligjit nr. 9232/2004, materializuar në kriteret për përfitimin e banesave sociale, është ndihma për strehim nga shteti e familjeve në nevojë, të cilat përndryshe nuk do të mund të përballonin me të ardhurat e tyre vlerat e tregut. Në këtë logjikë, një individ që përfiton të ardhura familjare në dyfishin e vlerës maksimale kualifikuese dhe, për më tepër, posedon interesat financiare të materializuara në investim prej 4.000.000 lekësh në një shoqëri tregtare, siç është rasti i bashkëshortit të subjektit, nuk mund të argumentohet si person në nevojë. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit se investimi nuk gjeneronte të ardhura është i pakuptimtë, pasi ai përbënte kapital të bashkëshortit në momentin e aplikimit për kredi me kushte lehtësuese, vlerë e cila nuk rezultoi të ketë humbur atë të tregut apo pësuar rënie, e cila do ta bënte investimin e dështuar apo të zeruar. Për më tepër, kjo vlerë përbënte gjendje pasurore në momentin e aplikimit për kreditë me kushte lehtësuese. E parë në terma financiare, kjo pjesë takuese përkthehet në kapital -- në masën prej 4.000.000 lekësh -- e cila ekzistonte qoftë edhe e konvertuar në aksione. Me fjalë të tjera, në vlerësimin tërësor të situatës financiare të subjektit dhe personit të lidhur, asetet e tyre përfshinin edhe këtë vlerë thuajse të barabartë me atë të apartamentit dhe afërsisht sa dyfishi i kredisë së përfituar.

15.49. Në kushtet që subjekti mbante detyrën e prokurores, duke pasur në konsideratë detyrimin për të zbatuar ligjin me përpikëri si funksionare e drejtësisë dhe për shkak të formimit të saj profesional, duke analizuar të gjitha këto aspekte që lidhen me profilin e familjeve që tipikisht kanë nevojë të shtuara për ndihmën e shtetit, është e pamundur të argumentohet se subjekti e personi i lidhur e konsideronin gjendjen e tyre financiare ekuivalente të individëve e familjeve vulnerabël për shkaqe të ndryshme sociale e shëndetësore. Në pikën fundore, vlerësimi mbetet në diskrecionin e bashkisë vetëm nëse subjekti do të kishte deklaruar edhe këtë aspekt të interesave private.

15.50. Në këtë këndvështrim, për të vlerësuar përfitimin e shërbimeve nga funksionarët publikë, nën dritën e parimeve të konfliktit të interesit, sipas ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, ato [shërbimet] duhet të analizohen në raport me të tjerët. Në rastin konkret, ky përfitim u analizua në raport me individët që plotësojnë kushtet apo kanë aplikuar për të përfituar kredi me kushte lehtësuese, nën dritën e parimit të përcaktuar nga neni 21³⁸. Argumentimi i subjektit se ndonëse bashkëshorti kishte interesat private në një vlerë minimalisht të barabartë me atë të apartamentit, ato nuk duheshin konsideruar si asetet e cilat duhet t’ia nënshtronte vlerësimin të saj për kualifikim në kategorinë e personave që nuk

³⁸Neni 21, pika 4/b – b) ka të bëjë me marrjen nga zyrtari të një shërbimi, që ofrohet nga institucioni publik [...], si dhe me kushtin që shërbimi nuk i jepet zyrtarit në mënyrë favorizuese apo si trajtim preferencial në raport me të tjerët.

janë në gjendje të përballojnë vlerat e tregut, ndërkohë që kompania kishte shtuar vlerën e aksioneve në të njëjtin vit, paraqiten jobindëse nën këtë dritë. Në këto kushte, mosdeklarimi i gjendjes pasurore – aksioneve të bashkëshortit në shoqërinë “{***}” ShA, pranë Bashkisë Fier, në momentin e aplikimit për kredinë me kushte lehtësuese -- ka krijuar një panoramë të pavërtetë për gjendjen e saj financiare. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi që situata financiare e subjektit dhe personit të lidhur ishte dukshëm më e favorshme dhe, për pasojë, në mospërputhje me qëllimin e akordimit të këtij fondi, që ishte ndihma e familjeve në nevojë apo vulnerabël.

15.51. Subjekti dhe personi i lidhur e kanë shitur apartamentin objekt analize *në vitin 2017* me një fitim prej 1.100.000 lekësh. Ndërkohë, sipas deklaratës periodike të vitit 2017, subjekti është ende në proces shlyerje të kredisë me kushte lehtësuese. Pas konstatimit fillestar se shitja ishte në kundërshtim me ligjin, në vendim, Komisioni ka konkluduar se nuk konstatohet problematikë lidhur me shitjen e apartamentit. Konkluzioni i Komisionit kryesisht bazohet në konstatimin që meqenëse veprimet janë lejuar nga organet e tjera, nuk duhet të ketë pasur kufizime për shitjen dhe ndalimi i shitjes sipas nenit 20 të ligjit nr. 9232/2008 nuk duhet të ketë pasur zbatim për rrethanat konkrete.

15.52. Komisionerja Publike, mbështetur edhe në rekomandimin e ONM-së, e ankimon konkluzionin e Komisionit si të gabuar dhe argumenton se subjekti e ka shitur këtë banesë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 20 të ligjit nr. 9232/2004. Komisionerja Publike mbajti të njëjtin qëndrim edhe gjatë seancës gjyqësore në Kolegj duke e vlerësuar këtë aspekt të kontrollit të pasurisë në drejtim të aftësive profesionale si sjellje në kundërshtim me përmbajtjen e standardeve të etikës profesionale. Parë së bashku me disa procedime penale ndaj Bashkisë Fier, ndjekur nga subjekti, duke filluar nga viti 2011, Komisionerja potencoi se gjen zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

15.53. Sikurse në Komision, edhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti ka shpjeguar se ndalimi i shitjes, parashikuar nga neni 20 i ligjit nr. 9232/2004, nuk aplikohet për të, pasi nga leximi literal i dispozitës në fjalë, subjekte të këtij ndalimi *janë vetëm familjet që kanë përfituar banesë me kosto të ulët*. Ajo ka blerë një banesë në tregun e lirë, për të cilin ka aplikuar dhe përfituar një kredi të butë.

15.54. Nga analiza e akteve në fashikull dhe shpjegimeve të subjektit e pretendimeve të Komisioneres Publike, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se shitja e këtij apartamenti, ndërsa vijonte shlyerja e kredisë me kushte lehtësuese, është e ndaluar në mënyrë të shprehur në nenet 20 dhe 25 të ligjit nr. 9232/2004 dhe pikës 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 148/2008 “Për përcaktimin e procedurave për blerjen e banesave me kosto të ulët në treg”, të lexuara në harmoni, sikurse edhe me kontratën e kredisë. Ndërsa në këto akte përcaktohet shprehimisht ndalimi i tjetërsimit të pasurisë së përfituar nga këto programe si gjatë shlyerjes së kredisë, ashtu edhe deri 15 vjet *pas* shlyerjes, subjekti ka shitur banesën e përfituar në saj të kësaj kredie në vitin 2017, gjashtë vite pasi e kishte blerë, ndërkohë që vijon të shlyejë kredinë dhe me përfitim financiar. Në këto kushte, rezulton që shitja e banesës së përfituar nga subjekti dhe personi i lidhur, për shkak të programeve sociale, është në kundërshtim me kuadrin ligjor të përfitimit të kësaj pasurie. Ky konkluzion shtjellohet në arsyetimin që vijon.

15.55. Neni 3 i ligjit nr. 9232/2008 përcakton tri lloje programesh sociale të familjeve në nevojë, përkatësisht: (1) programe të banesave sociale me qira; (2) *programe të banesave me kosto të ulët*; dhe (3) programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë. Për arsye të qarta, subjekti nuk mund të ketë përfituar sipas pikës 1 apo 3. Për rrjedhojë, baza ligjore e vetme që deduktohet, në kushtet që në gjithë aktet referenca ligjore është ligji nr. 9232/2004 dhe subjektit i është dhënë kredi me kushte lehtësuese, është banesa *me kosto të ulët*, sipas pikës 2 të nenit 3 të këtij ligji. E njëjta linjë deduktohet edhe nga kontrata e kredisë e lidhur mes subjektit e bashkëshortit dhe BKT-së³⁹, në të cilën, ndër të tjera, rezulton qartë që qoftë pushteti qendror (nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike e Transportit dhe asaj të Financave) apo dhe pushteti vendor, vazhdojë të luajnë një rol specifik në rast të mospërbushjes së detyrimeve nga ana e kredimarrësve. Me fjalë të tjera, nga përmbajtja e kontratës, roli ndërmjetësues e garantues i bashkisë kundrejt bankës tregon që krijimi i të drejtave pasurore për kredimarrësit kryhet për shkak kriteresh të caktuara dhe nën ndërmjetësimin për qëllime sociale që merr shteti kundrejt institucionit financiar. Fakti që subjekti ka blerë apartamentin në tregun e lirë, nuk zhbën faktin që për shkak të shumës prej 2.8 milionë lekësh që i është akorduar asaj me një interes minimal prej 3% -- meqenëse diferenca e interesit merrej përsipër nga shteti – tjetërsimi do t'i nënshtrohej detyrimeve dhe kufizimeve që parashikon ligji për kreditë e fituara për banesat sociale, statusit të pastrehut etj. Kjo frymë rezulton qartë edhe nga neni 25 i të njëjtit ligj – referuar më sipër në paragrafin 15.38 [dhe poshtëshënimin 31].

15.56. Më tej, në kushtet që ligjvënësi ka parashikuar që përfitimi i një banese sipas këtyre programeve, passjell edhe detyrime që synojnë të ndalojnë abuzimin, duke ndaluar tjetërsimin apo qiradhënien të tretëve⁴⁰, gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë dhe mbi të gjitha, ndalim shitjeje brenda një harku kohor prej 15 vjetësh, përfshirë edhe për banesat për të cilat është shlyer kredia, shitja e apartamentit nga subjekti brenda gjashtë (6) viteve nga blerja dhe ndërkohë që ende shlyente kredinë bie haptazi ndesh njëkohësisht me disa nga ndalesat ligjore të parashikuara në pikën 2 të nenit 20⁴¹ të ligjit nr. 9232/2004. Konkretisht, nëse ndiqet dispozita ligjore që kushtëzon marrjen e kredisë, subjekti do të duhet të mos e tjetërsonte apartamentin deri në vitin 2026, edhe nëse do të ishte shlyer kredia më përpara. Të dy këto kushte nuk janë respektuar. Subjekti e ka shitur apartamentin në vitin 2017 dhe deri në kohën kur u mor vendimi i Komisionit, vijonte të shlyente kredinë. *Së dyti*, dispozita që përcakton kufizimet për kredifituesit parashikon që edhe nëse është e nevojshme që për arsye të ndryshme të kryhet shitja brenda këtij afati, familja detyrohet t'ia shesë këtë banesë subjektit, të cilit ia ka blerë dhe me vlerë jo më shumë sesa vlera me të cilën është blerë. Subjekti e ka shitur apartamentin kundrejt një fitimi, një individi tjetër, duke gjeneruar fitim nga transaksion për një pasuri për të cilën ka paguar interesa thuajse të papërfillshme, pasi vlera e vërtetë e tregut për kredinë subvencionohej nga fondet publike.

15.57. Për rrjedhojë, pretendimi i Komisioneres Publike se shitja është bërë në kundërshtim me ligjin është i mbështetur në ligj. Shitja e apartamentit në vitin 2017 është bërë në

³⁹ Paragrafët 5.2 dhe 9.6 të kontratës noteriale të kredisë lidhur më datë 02.08.2011 mes subjektit e bashkëshortit nga njëra anë dhe Agjencia “{***}” (Fier), në cilësinë e përfaqësuesve të BKT-së nga ana tjetër.

⁴⁰ Neni 21 pika 1 e ligjit nr. 9232/2004.

⁴¹ Referuar edhe në poshtëshënimin nr. 33: “[2.] Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët dhe e ka shlyer atë, duke u bërë pronare e saj, detyrohet të mos e shesë për një periudhë 15-vjeçare. Kur familja, për arsye të ndryshme, kërkon ta shesë banesën brenda këtij afati, ajo detyrohet t'ia shesë këtë banesë subjektit, të cilit ia ka blerë dhe me vlerë jo më shumë sesa vlera me të cilën është blerë”.

kundërshtim me ligjin, pavarësisht nëse organet e tjera kanë vlerësuar të mos kontrollojnë respektimin e kushteve ligjore. Po ashtu, ndryshe nga sa analizon Komisioni, fakti që në kartelën e pasurisë nuk ka kufizim që pasqyron situatën e mësipërme, nuk konfirmon që shitja e kryer është në përputhje me ligjin. Gjithashtu, ky veprim nuk mund të ishte një kufizim që pasqyrohet në kartelën e pasurisë, sepse asnjë parashikim ligjor nuk e përcakton si të tillë. Në këto kushte, mospasqyrimi në kartelën e pasurisë nuk arrin të zhbëjë sa është arsyetuar më sipër, duke analizuar në mënyrë rigorozë dispozitat ligjore që gjejnë zbatim.

15.58. *Së fundmi*, lidhur me këtë pasuri, Komisionerja Publike pretendon që apartamenti është blerë me çmim preferencial, krahasuar kostot që parashikon për referencë Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”). Nga aktet në fashikull rezulton që Komisioni të ketë hetuar për këtë aspekt dhe në vijim ka pranuar shpjegimet e subjektit, sipas së cilës diferenca nuk është e mirëfilltë, pasi në vlerën e paguar prej saj e personit të lidhur është përfshirë vetëm sipërfaqja që referohet në certifikatën e pronësisë, ndërsa sipërfaqet e përbashkëta nuk i nënshtrohen tatimit. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se çmimi më i ulët është vendosur edhe pasi apartamenti ishte në një pozicion që e ekspozon ndaj *zhurmave*. Diferenca prej 205.164 lekësh është e *papërfillshme* dhe çmimi mesatar [sipas EKB] nuk është kategorik, është shprehur subjekti.

15.59. Nga analiza e kryer mbi bazën e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i Komisioneres në thelb është jo përcaktues e pa peshë në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë. Sipas përlllogaritjes së bazuar në çmimet e referencës së EKB-së, edhe në analizën e kryer në Kolegji, diferenca rezulton thuajse e papërfillshme dhe përputhet më atë të referuar nga subjekti, prej përreth 200 mijë lekësh. Konkretisht, kjo nënkupton që vlera sipas referencës së EKB-së do duhet të ishte 4.705.164,72 lekë kundrejt 4.500.000 lekë që ka qenë kontrata e shitjes mes palëve⁴². Nga ky verifikim, sipas të dhënave nga EKB-ja, rezulton se subjekti e ka blerë apartamentin me një diferencë çmimi prej 205.164 lekësh, nga vlera e tregut përcaktuar nga institucioni përgjegjës EKB-ja. Pavarësisht se në këtë vlerë Kolegji nuk përfshiu sipërfaqet e përbashkëta, përsëri diferenca është e evidente dhe nuk mbështet pretendimin e subjektit. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë përcjellë kontrata të ngjashme për të konfirmuar pretendimin e saj në drejtim të zbatimit të parimit të lirisë kontraktore të palëve për të përcaktuar çmimin. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit që lidhet me tatim të përjashtuar për sipërfaqe të përbashkëta nuk ka relevancë në përcaktimin e vlerës së apartamentit apo bazë ligjore. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i shfuqizuar dhe Udhëzimi nr. 5, datë 31.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nuk parashikojnë që sipërfaqet e përbashkëta përjashtohen nga pagesa e tatimit. Në të njëjtën kohë, trupi gjykues arsyeton se shpjegimet e subjektit, që i referohen pozicionimit të apartamentit, shkak i cili ka sjellë edhe çmimin më të ulët se ai i referencës, nuk gjejnë pasqyrim në kontratën e shitblerjes.

15.60. *Së fundmi*, marrja e dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, përbën kufizime të interesave privatë të zyrtarit për parandalimin e konfliktit të interesit për çështje të veçanta⁴³, përfshirë edhe ndalimin e përfitimit të trajtimeve preferenciale për shkak

⁴² Në kohën kur është kryer veprimi i kalimit të pronësisë, çmimi për metër/katror, sipas EKB-së ishte 56.094 lekë/m². Nga përlllogaritja matematike, 83,88 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 6,40 m² Për zbatimin e këtij akti nënligjor ka dalë udhëzimi i 2010. Udhëzimi i vitit 2011 ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2011, që nënkupton një periudhë kohore pas nënshkrimit të kontratës së shitjes, për pasojë është i zbatueshëm udhëzimi i vitit 2010.

⁴³ Referuar ligjit nr. 9367/2005, neni 23, pika 1.

të pozicionit. Në rastin konkret, nga aktet e përcjella nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, nuk rezulton që subjekti të ketë pasur ndonjë proces penal me shitësit. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se në rrethanat konkrete faktike çmimi i aplikuar për blerjen e apartamentit nuk mund të vlerësohet bindshëm si trajtim preferencial për subjektin nën dritën e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”. Për pasojë, trupi gjykues i vlerësoi këto faktorë pa peshë në vlerësimin e përgjithshëm të subjektit.

15.61. Në vijim dhe si përmbledhje e arsytimit të mësipërm, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredinë me kushte lehtësuese pa përmbushur kriteret ligjore. Po ashtu, edhe shitja e apartamentit dhe gjenerimi i një fitimi si pasojë e shitjes u vlerësuan si veprime në mospërmbushje të detyrimeve të subjektit në respektimin e ligjit në përgjithësi, në kushtet që pasuria kishte kufizime ligjore për shkak të lehtësive financiare të akorduara subjektit dhe personit të lidhur nga buxheti i shtetit. Këto konkluzione u vlerësuan nga trupi gjykues i Kolegjit në kontekstin e përgjegjësisë së subjektit si magjistrate për të respektuar ligjin edhe në jetën personale. Një ndër Parimet e Bangalores për sjelljen e gjyqtarit që mund të aplikohet, *mutandis mutandis*, për prokurorët, në pikën 4.9 që parashikon se: “Një gjyqtar nuk duhet të përdorë apo të cenojë prestigjin e postit të gjyqtarit për interesa private të tij apo të një anëtari të familjes së tij, apo të kujtdo tjetër, dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen apo të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se kushdo me pozitë të veçantë ndikon padrejtësisht në punën e tij gjatë ushtrimit të profesionit”. Kjo situatë ligjore dhe faktike u bë pjesë e vlerësimit tërësor, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, konkluzioni për cenim të besimit të publikut do të kualifikohet, sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016⁴⁴.

*I.b. Aksionet në shoqërinë “{***}” ShA*

16. Personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti posedon aksione në masën 40% në vlerën 4.000.000 lekë në shoqërinë tregtare të sipër referuar. Komisioni ka konstatuar se këtë fakt subjekti e ka deklaruar vetëm në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, por jo më pas, përfshirë edhe deklaratën *vetting* apo më parë, në deklaratën përpara fillimit të detyrë më 02.12.2008. Edhe bashkëshorti i subjektit ka qenë subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003 dhe e ka deklaruar këtë interes pasuror në vitin 2009. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi në deklaratat periodike dhe në atë *vetting* ka ardhur për shkak se kjo shoqëri duhet të ishte likuiduar që në vitin 2007, sipas nenit 104 të ligjit nr. 992,0 datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Njëkohësisht, subjekti ka pretenduar se: ka qenë *shoqëri pa asnjë fryt*; nga tatimet ka rezultuar me status “pasiv”; ai investim është konsideruar i humbur, pasi nuk ka sjellë asnjë fitim; është krijuar 4 vite para se subjekti të njihej me bashkëshortin; si dhe mosdeklarimi nuk ka pasur si qëllim fshehjen. Pasi i ka kaluar subjektit barrë prove për të provuar mundësinë financiare të krijimit të 40% të pronësisë së aksioneve në shoqërinë tregtare në fjalë, në vendim, Komisioni konkludoi se problematikat e konstatuara, që lidhen me pasuritë e personit të lidhur të krijuara përpara martesës, nuk mjaftojnë për të ngarkuar me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

⁴⁴ Shih edhe arsytimin e Kolegjit në vendimet (JR) nr. 2/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, dhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 37/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Bernina Kondi, parag. 26.5.

16.1. Komisionerja Publike pretendon se mosdeklarimi i këtyre interesave pasurore të konsiderohet si deklarim i pasaktë e i pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Sipas saj, ndonëse nuk ka gjeneruar fitime, prej kësaj shoqërie janë përfituar të ardhura në formë page, të cilat janë përdorur prej personave të tjerë të lidhur, z. M. M. dhe znj. S. G., për dhurimin kundrejt këstit të parë të apartamentit në Fier, analizuar më sipër.

16.2. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegji vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar. Ndonëse personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti, ka kryer investimin përpara martesës, në kushtet që personi juridik i krijuar vazhdonte të ekzistonte në momentin e hartimit të deklaratës *vetting*, ai përbën pasuri që i nënshtrohej deklarimit pasuror, nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 3 pika 11 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, kuadri ligjor i rivlerësimit parashikon në mënyrë të shprehur kontrollin e pasurive të *personave të lidhur* me subjektet e rivlerësimit, duke mos bërë dallim mes pasurive të krijuara përpara apo pas martesë. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

16.3. Nga aktet rezulton se shoqëria “{***}” ShA është themeluar në vitin 2004. Bashkëshorti i subjektit ka kontribuar me vlerën 4.000.000 lekë në kapitalin fillestar, vlerë e cila përkon me 40% të aksioneve të shoqërisë. Nga informacioni i përcjellë nga Qendra Kombëtare e Biznesit⁴⁵, shoqëria ka qenë me status *aktiv* dhe gëzonte personalitet juridik edhe në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting* -- nga shkresa e Qendrës Kombëtare të Biznesit, sikurse rezulton edhe në ekstraktin e thjeshtë, kjo shoqëri ka qenë e regjistruar në regjistrin tregtar me status “aktiv”, të paktën deri më datë 01.08.2017, kur është nxjerrë ekstrakti i regjistrit tregtar. Po ashtu, sipas vërtetimit të ISSh-së [nr. {***}, datë 27.01.2020], deri të paktën në nëntor të vitit 2010, z. M. M. ka përfituar paga prej kësaj shoqërie. *Së fundmi*, Drejtoria e Tatimeve Tiranë⁴⁶, në një përgjigje drejtuar shoqërisë gjatë hetimit administrativ në Komision, ka referuar se që prej datës 06.05.2016 statusi i shoqërisë ishte “pasiv”.

16.4. Referuar pikës 3 të nenit 3 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9901/2008”), një shoqëri tregtare e fiton personalitetin juridik në momentin që regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe vijon të ekzistojë deri në momentin e çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose gjykatë. Shoqëria e humbet personalitetin juridik/zotësinë juridike vetëm si pasojë e çregjistrimit⁴⁷. Me fjalë të tjera, pavarësisht mënyrës se si shoqëria tregtare administrohet apo pavarësisht nëse deklarohet me humbje, fitim apo pa aktivitet, ajo e ruan personalitetin juridik dhe konsiderohet ekzistente për qëllimet e ligjit. Po ashtu, nga legjislacioni që rregullon procedurat tatimore rezulton se një person juridik/subjekt tatimpagues është pjesë e regjistrit të administratës tatimore deri në momentin e çregjistrimit⁴⁸.

⁴⁵ Shkresa nr. {***} prot., datë 02.08.2017, dërguar ILDKPKI-së.

⁴⁶ Datë 27.01.2020 dhe shkresa nr. {***} prot., datë 01.11.2021.

⁴⁷ Sipas nenit 53 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”: “[...] Çregjistrimi i personave juridikë nga regjistri tregtar ka si pasojë humbjen e personalitetit juridik të subjekteve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme. [...]”.

⁴⁸ Sipas nenit 45 të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”: “[...] 1. Subjektet/tatimpaguesit, të cilët janë regjistruar në administratën tatimore, sipas pikave 1 deri 4, të nenit 40 dhe të nenit 42, të këtij ligji, çregjistrohen nga regjistri i administratës tatimore vetëm pas çregjistrimit të tyre në Qendrën

16.5. Nga ana tjetër, statusi *pasiv*, që referon subjekti, sipas shkresës që Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë (në vijim “DRT”) i ka drejtuar shoqërisë tregtare në vitin 2020, nuk ka asnjë efekt sa i takon deklaramit të zotërimit të aksioneve nga aksionarët. Ky status ka efekt për administratën tatimore, në rast se për një periudhë tatimore për 12 muaj të njëpasnjëshëm, një subjekt tregtar nuk ushtron veprimtari, nuk dorëzon deklaratën tatimore ose deklaron pezullim veprimtarie tregtare. Sipas dispozitave ligjore që gjejnë zbatim⁴⁹ në periudhën kur shoqëria është me status pasiv, përjashtohet nga masat administrative sikurse gjoba, për shkak të mosdeklarimit tatimor. Ky status vendoset me dijeninë e personit juridik dhe nuk ka efekt mbi pronësinë e aksioneve dhe ndryshimi i statusit ndodh me rifillimin e veprimtarisë. Me fjalë të tjera, pasja e statusit pasiv pranë administratës tatimore apo mosgjenerimi i fitimeve nuk passjell humbjen e pronësisë mbi aksionet, dhe që përbën shkas ligjor për të prezumuar inekzistencën e aktivitetit në terma ligjorë.

16.6. Për sa më sipër, pavarësisht nga statusi që ka referuar për qëllimet tatimore DRT-ja, subjekti dhe personi i lidhur do të duhet ta kishin deklaruar pjesën takuese/aksionet në deklaratën *vetting*. Po ashtu, në kushtet që më 25.01.2017 [data e deklaratës *vetting*], shoqëria “{***}” ShA, gjithsesi ka qenë me status “aktiv”, pjesa takuese e personit të lidhur me subjektin/bashkëshortit do të duhet të ishte deklaruar. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit thekson edhe faktin që aksionet përbëjnë pasuri sipas përkufizimit ligjor të pasurive⁵⁰, pasi janë *tituj pronësie nga të cilët rrjedhin përfitime*⁵¹. Nën dritën e këtij arsytimi, përtej argumenteve të subjektit në Kolegj se shoqëria nuk kishte *animus* dhe *corpus*⁵², për sa kohë ajo ishte e regjistruar, mund të hynte në qarkullim civil e të kryente aktivitete tregtare lirisht, pavarësisht me humbje apo fitim. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për arsyet për të cilat nuk u deklaruan këto aksione janë jobindëse, parë edhe në kontekstin e formimit ligjor të subjektit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vëren se pretendimi i Komisioneres Publike është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë të pasurisë në deklaratën *vetting*, në kuptim të gërmës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

I.c. Vlera e pagës së personit të lidhur si burim krijimi pasurie

17. Një ndër pasuritë e mbërritura në deklaratën *vetting*, e që i është nënshtuar kontrollit në procesin e rivlerësimit, është edhe një automjet, i blerë nga personi i lidhur me

Kombëtare të Biznesit dhe/ose në gjykatë. [...] 3. Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve, që janë pjesë e regjistrimit të Qendrës Kombëtare të Biznesit: 3.1 Çregjistrimi i subjektit/tatimpaguesit nga regjistri i administratës tatimore fillon në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe, pas çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, bëhet çregjistrimi në regjistrin e administratës tatimore. [...]

⁴⁹*Ibid. Pika 1 e nenit 44: “[...] Kalimi në regjistrin pasiv 1. Administrata tatimore, kur zotëron prova se tatimpaguesi, për një periudhë tatimore për 12 muaj të njëpasnjëshëm: (a) nuk ushtron më veprimtari tregtare; (b) nuk dorëzon deklaratën tatimore; (c) deklaron pezullim veprimtarie tregtare, transferon regjistrimin e një tatimpaguesi nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, që mbahet nga administrata tatimore. [...] Në këtë rast, për të gjithë periudhën e qëndrimit në regjistrin pasiv nuk llogariten gjoba për mosdeklaramit tatimor. 3. Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e transferimit të regjistrimit në regjistrin pasiv, njofton tatimpaguesin me shkrim. [...]”*

⁵⁰*Neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 përkufizon: “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit [...]*

⁵¹*Pika 1, e nenit 2 të ligjit nr. 9049/2003, përcakton: “[...] “Aksion” është titull pronësie, që përfaqëson një të pjesë të cilat është ndarë kapitali i një shoqërie dhe që i jep të drejtën zotëruesit të saj të marrë pjesë në fitime. [...]*

⁵²*Paragrafi 132 i parashtrimeve të subjektit në Kolegj.*

subjektin/bashkëshorti përpara martese në vlerën 4.800 euro, në vitin 2004. Përpos specifikimit të faktit që kjo pasuri është krijuar përpara se ajo të merrte detyrën e prokurores, subjekti ka referuar si burim pagat e bashkëshortit në vlerën 70.000 lekë nga punësimi si administrator në shoqërinë “{***}” dhe të ardhurat familjare. Pasi i ka kaluar barrën e provës për të provuar mundësitë financiare të bashkëshortit për të krijuar këtë pasuri dhe për deklarim të pasaktë të të ardhurave mujore të bashkëshortit nga biznesi privat, Komisioni ka konkluduar se kjo pasuri është krijuar para martese, është pasuri vetjake e bashkëshortit dhe nuk ka sjellë asnjë përfitim pasurie bashkëshortore dhe problematikat nuk përbëjnë shkaqe objektive dhe proporcionale, për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit. Komisioni ka vlerësuar që subjekti nuk ka deklaruar saktë pagën e bashkëshortit në shoqërinë “{***}” ShA. Komisioni ka konstatuar nga aktet që automjeti rezulton të jetë çregjistruar në datën 28.08.2017.

17.1. Në mbështetje të rekomandimit të ONM-së, Komisionerja Publike vëren se sipas akteve⁵³ paga mujore e bashkëshortit të subjektit si administrator i shoqërisë “{***}” ShA ka qenë në shumat 10.000-14.000 lekë e, për pasojë, nuk përputhet me vlerën 70.000 lekë, sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit. Në vlerësim të Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të të ardhurave të bashkëshortit nga pagat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie dhe që pretendimet për përfitimin e diferencës së pagës në *cash* gjenden të pambështetura.

17.2. Në procesin e zhvilluar në Kolegj, subjekti i rivlerësimit i qëndroi shpjegimeve të dhëna në hetimin administrativ të zhvilluar në Komision, duke theksuar që edhe të ardhurat e paguara në *cash* janë fituar prej bashkëshortit. Po ashtu, prapësimet e subjektit në Kolegj u fokusuan në pretendimin që kjo pasuri nuk mund të passjellë masë disiplinore për të duke qenë se është krijuar vite përpara martese, me të ardhura vetjake të bashkëshortit. Gjatë hetimit administrativ, në pyetësorët e drejtuar nga Komisioni, subjekti ka potencuar edhe që në Sigurimet Shoqërore kryhet deklarimi mbi bazën e pagës minimale, ndërkohë që pjesa tjetër/diferenca e pagës paguhej *cash*.

17.3. Pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se pretendimi i Komisioneres Publike është i bazuar. Për rrjedhojë, është i pasaktë deklarimi i vlerës prej 70.000 lekësh në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë të ardhurat, në kundërshtim me përcaktimet e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe pretendimi i Komisioneres Publike gjendet i saktë dhe i mbështetur në ligj e në prova. Arsyeimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion detajohet në vijim.

17.4. Nga aktet në fashikull rezulton se në deklaratën para fillimit të detyrës [që mban datën 02.12.2008], subjekti ka deklaruar krijimin e kësaj pasurie me të ardhurat e bashkëshortit nga paga dhe si *pagë aktuale* ka referuar vlerën 50.000 lekë. Edhe bashkëshorti i saj rezulton të ketë referuar të njëjtën vlerë page në deklaratën periodike për vitin 2009 si subjekt deklarues⁵⁴. Nga ana tjetër, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, sikurse referuar më sipër, rezulton se paga nga punësimi i tij pranë shoqërisë “{***}” ShA, si

⁵³ Shkresa me nr. {***} prot., datë 24.01.2017, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

⁵⁴ Për shkak të detyrës së tij si Drejtor i Zyrës “{***}” në Fier.

administrator i shoqërisë, për periudhën 2003-2006, përfitonte pagën nga 10.000-14.000 lekë/muaj.

17.5. Trupi gjykues sjell në vëmendje detyrimet e shprehura të kuadrit kushtetues, ligjor e nënligjor për rivlerësimin kalimtar⁵⁵, që subjektet e rivlerësimit kanë për të deklaruar plotësisht e saktësisht pasuritë dhe të ardhurat në deklaratën *vetting*. Në vijim të këtyre përcaktimeve, subjekti duhet të deklaronte saktësisht të ardhurat e bashkëshortit nga pagat, në kushtet që deklarohet një pasuri e cila ishte ende në pronësi të tij në momentin kur është hartuar deklarata *vetting*. Nën dritën e këtyre konstatimeve, pretendimet e subjektit që tentojnë të reduktojnë pasaktësinë e kryer prej saj në deklaratën *vetting*, si një çështje pasurie të krijuar përpara martesë apo përpara marrjes së detyrës prej saj, u vlerësua nga trupi gjykues në drejtim të sinqeritetit e bashkëpunimit të treguar prej saj në procesin e rivlerësimit.

17.6. Konkretisht, ndërsa është fakt i pakontestuar që pasuria objekt analize dhe pagat me të cilat ajo është krijuar datojnë vite përpara se subjekti të merrte detyrën, çështja e ngritur në shkakun e ankimit lidhet me deklarimin e pagës së bashkëshortit në deklaratën *vetting*, në janar 2017. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që vlera e referuar si pagë e bashkëshortit në deklaratën *vetting* është e pasaktë. Së fundmi, dhe përpos sa më sipër, trupi gjykues vëren edhe problematikën që paraqet pranimi dhe normalizimi që tenton të potencojë subjekti duke specifikuar se paga e bashkëshortit e deklaruar në institucionet shtetërore nuk përkon me vlerën e vërtetë të përfituar prej tij. Ky konstatim paraqet peshë të shtuar nën dritën e faktit që bashkëshorti i subjektit kryente detyrën e administratorit në këtë person juridik, e me fjalë të tjera, personalisht përgjegjës për mënyrën e deklarimit pranë institucioneve.

17.7. Në konkluzion të kontrollit të kriterit të pasurisë trupi gjykues i mbajti në konsideratë përfundimet e mësipërme, në vlerësimin e përgjithshëm për të tria kriteret, sipas pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

II. Kriteri i kontrollit të figurës

- 18.** Komisioni ka hetuar edhe për kriterin e figurës, ndër të tjera, bazuar në dy Gjetje të Vëzhguesit Ndërkombëtar dhe shtojcat përkatëse, administruar përkatësisht më 15.07.2022 dhe më 06.10.2022. Në to referoheshin problematika që lidhen me mosdeklarimin e një kontakti të papërshtatshëm dhe kontakte të papërshtatshme faktike, siç rezultonte edhe nga përdorimi i disa automjeteve në pronësi të disa individëve apo shoqërive tregtare. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se për subjektin e bashkëshortin nuk janë konstatuar kontakte të papërshtatshme me tre individët e vlerësuar si të tillë⁵⁶.

18.1. Komisionerja Publike potencon në ankim se vlerësimi i Komisionit bazohet në një interpretim të ngushtë të dispozitave ligjore të zbatueshme, qoftë për kontaktin e papërshtatshëm të vitit 2012 apo edhe të momentit të procedimit penal nga SPAK, për personat (dhe shoqëritë tregtare të krijuara prej tyre) që janë konstatuar si kontakte të papërshtatshme faktike të subjektit dhe personave të lidhur me të. Përfundimisht, ajo thekson se për subjektin gjenden fakte të cilat e bëjnë atë të papërshtatshme për vazhdimin e detyrës, parë edhe në vlerësimin tërësor të çështjes, në drejtim të cenimit të besimit të publikut.

⁵⁵ Neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, ligji nr. 84/2016 dhe udhëzimi nr. 4095/2016, i ILDKPKI-së.

⁵⁶ Referuar si V.Z., K.Z., dhe A.M., në paragrafin 1.6 të rubrikës së vlerësimit të figurës në vendimin e Komisionit.

18.2. Subjekti i rivlerësimit theksoi edhe në procesin e zhvilluar në Kolegj se vlerësimi i kryer nga Komisioni është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi. Sipas saj, ajo dhe bashkëshorti nuk kanë pasur kontakt direkt asnjëherë me z. G./Z., nuk janë takuar as edhe gjatë nënshkrimit të kontratës, pasi pagesa e apartamentit i është shlyer investitorit [i afërm i tij, z. E. B.], më herët. Po ashtu, nuk përmbushet as kriteri tjetër i parashikuar nga ligji, që kontakti të jetë i papajtueshëm me ushtrimin e detyrës, parashikuar nga pika 6 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Ka kërkuar dorëheqjen në vitin 2015 nga procedimi penal i vitit 2012, në ngarkim të këtij individi, pasi kishte marrëdhënien e shitjes me z. B., që është kunati i tij. Për sa i përket kontakteve faktike me persona të hetuar për vepra penale që përfshihen në krimin e organizuar, nëpërmjet lidhjes për shkak të ligjit, janë ato me kunatin dhe bashkëshorten e tij, sikurse edhe ajo e biznesit të bashkëshortit me të vëllanë, M. M.. Kjo marrëdhënie biznesi mes tyre ka përfunduar që në vitin 2007, përpara lidhjes së martesës ligjore të saj me bashkëshortin.

18.3. Pasi analizoi pretendimet e Komisioneres Publike, Gjetjet e Vëzhguesit Ndërkombëtar, aktet në fashikull dhe shpjegimet e palëve gjatë debatit gjyqësor në Kolegj, trupi gjykues vlerëson se për kriterin e kontrollit të figurës subjekti i rivlerësimit gjendet në kushte të cilat afektojnë procesin e saj të rivlerësimit. Për këtë arsye, pretendimet e Komisioneres Publike u gjetën të bazuara. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë qoftë çështje të saktësisë së deklaramit për kontrollin e figurës, por edhe pasjen e kontakteve të papërshtatshme konkrete që kanë vijuar edhe pasi subjekti dhe personi i lidhur ishin në dijeni të rrethanave që i jepnin këtyre individëve këtë cilësi sipas ligjit. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

II.a. Mosdeklarimi i kontaktit të papërshtatshëm me z. V. Z., alias A. G. në formularin e figurës

18.4. Nga hetimi administrativ i Komisionit, referuar edhe gjetjes së Vëzhguesit Ndërkombëtar⁵⁷, ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar në prill 2015 të përjashtohet nga një procedim penal i nisur në dhjetor 2012 në ngarkim të z. V. Z./A. G. dhe familjarëve të tij⁵⁸. Këta persona po hetoheshin për transaksione të dyshimta dhe veprimtari kriminale jashtë vendit, duke krijuar të ardhura të cilat investoheshin më pas nëpër biznese në Shqipëri. Nga hetimi ka rezultuar, po ashtu, se z. G./Z. ka qenë i dënuar në Itali për veprat penale të “*Prostitucion dhe pjesëmarrje në organizatat kriminale me qëllim trafikimin e drogës*”⁵⁹. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në pyetësorë që në vitin 2012, z. Z./G. i ka shitur bashkëshortit të saj apartamentin me sipërfaqe 95 m², në Fier. Në kërkesën për heqje dorë nga hetimi, subjekti ka paraqitur nevojën e evitimit të konfliktit në dukje të interesit, për shkak të lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes me këtë person, sikurse edhe meqenëse ky individ

⁵⁷ Sipas vendimit Nr. {***} ({***) të Gjykatës së Lartë, V. Z./A. G. është dënuar 3 herë në Itali, së paku që prej vitit 2004, për veprat “*prostitucion*” dhe “*pjesëmarrje në organizatë kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike*”. Z. u arrestua në Fier më 20.01.2014, ndërkohë që ishte në kërkim ndërkombëtar. Sipas të njëjtit vendim të Gjykatës së Lartë, Z. u ekstradua në Itali më 03.07.2014. Aktet e procedimit penal nr. {***}, përveç V. Z./A. G., i referohen edhe pjesëtarëve të tjerë të familjes së shtetasit A. G./Z., si persona të përfshirë në këtë çështje (periudha e referimit: 2009 – 2012), si vijon: (a) R. G., i dënuar në Belgjikë në vitin 2009 për shfrytëzim prostitucioni, pjesëmarrje në krimin e organizuar, etj.; (b) O. G., vëllai i R. G., që ka llogari bankare të dyshimta dhe të pajustificuara me R. G. dhe E. B., si dhe pasuri të pashpjeguara; (c) E. B. (kunati i shtetasit A. G./Z.), i cili ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me bashkëshortin e subjektit në vitin 2011 për apartamentin me sip. 95 m².

⁵⁸ Si më sipër.

⁵⁹ Nga vendimi i mësipërm rezulton se V. Z./A. G. është i dënuar në total prej 32 vjet e 6 muaj, në Itali/Romë, Autoritetet italiane kanë lëshuar urdhër arresti për të më datë 12.06.2009.

ishte edhe kunati i shitësit të apartamentit, z. E. B.. Kërkesa për heqje dorë u pranua nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe subjekti u zëvendësua në procedim.

18.5. Përkundër sa ka parashtruar në vitin 2015, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti është shprehur se çmimi i është shlyer tërësisht kunatit të z. Z./G. [z. E. B.] në vitin 2011 dhe, për pasojë, lidhja e kontratës së shitblerjes *ishte vetëm një formalitet*, që do të mundësonte regjistrimin e apartamentit. Po ashtu, subjekti deklaroi se as ajo e as bashkëshorti nuk kanë pasur komunikim, kontakt apo takim me z. V. Z., i cili në kontratën e shitjes ishte përfaqësues me prokurë i palës shitëse/kunatit të tij. Subjekti argumenton se e ka plotësuar saktësisht deklaratën për kontrollin e figurës në kushtet kur z. V. Z. nuk ka qenë kontakt i saj apo bashkëshortit, nën dritën e rrethanave të lidhjes së kontratës dhe të heqjes dorë prej saj nga hetimi i çështjes. Edhe nëse do të kishte ekzistuar, kontakti i personit të lidhur do ishte rastësor, për shkak të kësaj marrëdhënie kontraktuale.

18.6. Në kushtet që nuk kontestohet që veprat për të cilat është proceduar z. Z./G., pra, personi i përfshirë në krimin e organizuar, dhe marrëdhënia me personin e lidhur/subjektin e bëjnë atë kontakt të papërshtatshëm sipas përkufizimit ligjor⁶⁰, çështja ligjore që analizoi trupi gjyqësor ishte nëse shpjegimet e subjektit për mosdeklarimin janë të bazuara e bindëse. Nga kjo analizë, e kryer nën dritën e nenit 38 pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016⁶¹ dhe pjesës V të Shtojcës nr. 3 të këtij ligji, rezulton që rrethanat që diktuan heqjen dorë të subjektit nga hetimi duhet të ishin mbajtur në konsideratë prej saj edhe në kohën e plotësimit të deklaratës së kontrollit të figurës, plotësuar pas përrreth 21 muajsh dhe të pasqyroheshin në deklaratën e figurës. Subjekti nuk e ka deklaruar marrëdhënien juridike në fjalë, sipas detyrimeve të sipërcituara ligjore, ndonëse në prill 2015 e vlerësoi mjaftueshëm me peshë e si konflikt të mundshëm interesi në dukje apo si një arsye papajtueshmërie, sipas dispozitave të neneve 26 pika 1 dhe 17, germa “e” e Kodit të Procedurës Penale, për të mos vijuar procedimin penal.

18.7. Nga ana tjetër, argumentet e potencuara nga subjekti në procesin e rivlerësimit, për arsyet për të cilat ka zgjedhur mosdeklarimin e këtij kontakti në deklaratën e figurës, janë minimalisht inkohere në vetvete. Është inkohere që ndërsa transaksioni në vitin 2012 i shitjes së apartamentit është konsideruar mjaftueshëm me peshë edhe tri vite më pas, për të përbërë bazë për heqjen dorë, e njëjta ngjarje juridike/kontratë shitblerjeje pretendohet se nuk përbënte shkak për ta përfshirë në deklarimin nën germën “f” të pjesës V të Shtojcës nr. 3, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të rivlerësimit pas më pak se dy vjetësh. Për këtë arsye, shpjegimet e subjektit në procesin e zhvilluar në Kolegj u vlerësuan jobindëse. Në kushtet që ajo e ka konsideruar marrëdhënien e krijuar të atillë që të passillte papajtueshmëri në ndjekjen personalisht të procedimit penal prej saj për këtë individ, kjo marrëdhënie nuk mund të argumentohet logjikisht se është e atillë që nuk përbën as edhe kontakt të bashkëshortit për të passjellë deklarimin në procesin e rivlerësimit.

⁶⁰ Përcaktuar në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016: “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë [...]”.

⁶¹ “[6.] Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm janë kur: a) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme; [...]”.

18.8. Nga sa më sipër, rezulton se pretendimi i Komisioneres Publike është i bazuar dhe që subjekti nuk ka deklaruar saktësisht në deklaratën e figurës. Trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi si deklarative dhe jorelevante shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se ka qenë bashkëshorti nënshkrues i kontratës dhe jo ajo, sikurse edhe që palët kanë nënshkruar kontratën noteriale në kohë të ndryshme – që nënkupton që takimi konkret mes bashkëshortit dhe z. G./Z. nuk është materializuar. Nën dritën e faktit që ajo vetë ka hequr dorë nga procedimi penal me shitësin/përfaqësuesin me prokurë të shitësit nga procedimin penal në vitin 2015, pyetja nëse ka ndodhur apo jo takimi në zyrën e noterit nuk paraqet relevancë. Njëkohësisht këto dy pretendime janë edhe deklarative përderisa nuk mbështeten qoftë nga përmbajtja e kontratës së shitjes -- ku prania e palëve referohet të ketë qenë e njëkohshme – apo nga natyra e marrëdhënies që rezulton nga krahasimi mes kërkesës për heqje dorë nga procedimi në vitin 2015 kundrejt përshkrimit të potencuar në procesin e rivlerësimit që janë në kontradiktë.

18.9. Fakti që subjekti e ka ndjerë të nevojshme të kërkonte heqjen dorë në vitin 2015 tregon se edhe perceptimi i saj për rolin që z. Z./G. në transaksionin që passolli blerjen e apartamentit prej bashkëshortëve Mërtiri nuk mund të ishte episodik apo *rastësor* sikurse përshkruhet prej saj në Kolegj. Me fjalë të tjera, relativizimi dhe minimizimi i pranisë së këtij individ apo rolit që ai mbante në drejtim të tjetërsimit të pasurisë, potencuar gjatë procesit të rivlerësimit, duket inkonsistent me perceptimin që krijohet nga kërkesa që ka passjellë zëvendësimin e saj në procedimin penal. Për këtë arsye, trupi gjykues e vlerësoi situatën konkrete faktike e ligjore si një mosdeklarim në deklaratën e figurës dhe e përfshiu këtë konstatim në vlerësimin tërësor.

II.b. Për kontaktet faktike të papërshtatshme

18.10. Në vijim të dy gjetjeve të paraqitura nga Vëzhguesi Ndërkombëtar, Komisioni ka hetuar për: (i) marrëdhëniet e ngushta të biznesit dhe ato familjare të subjektit dhe bashkëshortit me z. M. M., bashkëjetuesen e tij, znj. S. G., z. K. Z. dhe z. A. M.; (ii) punësimin e bashkëshortit të subjektit në një pozicion të rëndësishëm nga vitit 2018 deri në vitin 2022 nga shoqëria “{***}” ShPK, e cila është e lidhur ngushtë me shoqërinë “{***}” ShPK, në pronësi të z. K. Z.; si dhe (iii) përdorimin nga subjekti të automjeteve të z. A. M. dhe z. K. Z.. Duke i cilësuar këta persona si *kontakte faktike të papërshtatshme*, Vëzhguesi Ndërkombëtar ka potencuar për Komisionin se znj. S. G., z. K. Z. dhe z. A. M. janë deklaruar në kërkim për veprat penale të parashikuara nga nenet 25, 245 dhe 287, geramat “a” dhe “b” të Kodit Penal dhe hetohen prej korrik/nëntorit 2020. Sipas së dhënave të *TIMS*, subjekti dhe bashkëshorti kanë udhëtuar bashkërisht me z. M. M. e znj. S. G. në janar 2016.

18.11. Përfundimisht, në vendim Komisioni ka konkluduar se kunati i subjektit dhe bashkëshortja nuk kanë qenë të dënuar apo proceduar në momentin e plotësimit të formularit të kontrollit të figurës nga subjekti dhe nuk është konstatuar ndonjë kontakt pas regjistrimit të procedimit penal. Marrëdhënien e biznesit me z. M. M. bashkëshorti i subjektit e ka pasur në vitin 2004 në shoqërinë “{***}” ShA. Komisioni nuk ka konstatuar marrëdhënie biznesi, punësimi apo kontakte të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit me z. K. Z. dhe z. A. M.. Komisioni ka vlerësuar se ndonëse në funksionin e drejtorit në shoqërinë “{***}” ShPK, bashkëshorti i subjektit nuk kishte funksione drejtuese e vendimmarrëse. Automjetet janë përdorur nga subjekti e bashkëshorti në kohën kur ndaj këtyre personave nuk kishte nisur procedim penal dhe nuk ishin të dënuar.

18.12. Komisionerja Publike argumenton se Komisioni ka marrë vendim mbi një interpretim të gabuar të ligjit, pasi bashkëshorti i subjektit ka pasur marrëdhënie, jo vetëm familjare, por edhe biznesi/punësimi me individët në fjalë, të cilët përbëjnë kontakte faktike të papërshtatshme për subjektin. Faktet e pasqyruara në gjetet e ONM-së tregojnë vazhdimësi lidhjesh midis subjektit, bashkëshortit, kunatit, kunatës dhe vjehrrit, me partnerët/punëdhënësit e tyre në biznes gjatë periudhës 2002-2022. Hetimet e SPAK-ut për këta persona janë shtrirë edhe në aktivitetin privat prej vitit 2011, 2014 e në vijim. Këto fakte e bëjnë subjektin të *papërshtatshëm* për vazhdimin e detyrës. Ky vlerësim negativ qëndron edhe nga një vlerësim tërësor i çështjes, pasi gjenden një sërë rrethanash, për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, parashikuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Gjatë seancës së zhvilluar në Kolegj, Komisionerja Publike ka shtuar se edhe me vendimin e GjKKO-së të datës 05.10.2023⁶², z. K. Z., z. M. M. dhe znj. S. G. u deklaruan fajtorë. Siç duket qartë nga kronologjia kohore, faktet e mësipërme kanë dalë në dritë, pasi subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën e kontrollit të figurës.

18.13. Në prapësim të pretendimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit parashtroi se personat në fjalë nuk përbëjnë kontakte të papërshtatshme. Ajo argumentoi se: (i) nuk kanë lidhje biznesi me bashkëshortin e saj; (ii) znj. S. G. dhe z. M. M. janë bërë kontakte të papërshtatshme në vitin 2021 dhe 2022, që kapërcen periudhën e parashikuar në Kushtetutë dhe ligjin nr. 84/2016. Derisa vendimi të marrë formë të prerë këta individë prezumohen të pafajshëm; (iii) marrëdhënia me kunatin e familjen e tij nuk është marrëdhënia e pashmangshme fisnore dhe prej së cilës ajo nuk ka mundësinë dhe zgjedhjen të distancohet; (iv) referimi i rrethanave lehtësuese dhe kuadrit ligjor të kontrollit të figurës nuk është korrekt, për sa kohë ky përcaktim ligjor e kushtetues i referohet vërtetësisë së plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës që i përket periudhës kohore 01.01.2012 – 25.01.2017; si dhe (v) konstatimet në lidhje me kontaktet e faktit janë të supozuara. Në to nuk pasqyrohet asnjë formë kontakti, vendi apo mënyre. Në seancën në Kolegj, në përgjigje të pyetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar, subjekti pretendoi për marrëdhënie të distancuara mes saj e bashkëshortit me vëllanë e kunatën.

18.14. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi aktet në fashikull, pretendimet e Komisioneres Publike dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, çmon që vijimi i kryerjes së detyrës nga subjekti do të ishte në mospërputhje me qëllimin e procesit të rivlerësimit për kthimin e besimit të publikut te drejtësia. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mbajti në konsideratë ndërthurjen e ndërsjelltë, të vazhdueshme, të shtrirë në kohë e të ngushtë, si dhe përzierjen në vazhdimësi të interesave financiare të personit të lidhur me subjektin/bashkëshortit, sikurse edhe të vetë subjektit me kunatin dhe bashkëjetuesen e tij, që cilësohen si persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përkufizimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe nën dritën e procedimit penal të regjistruar në vitin 2020, për vepra që përfshihen në nenin 75/a të Kodit Penal. Për rrjedhojë, pretendimet e Komisioneres Publike janë të bazuara. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mban në konsideratë vlerësimin e kryer pas analizës së aspekteve të shtjelluara gjerësisht në vijim.

⁶²https://www.gjp.gov.al/Gjykata_e_Posacme/Njoftime/Njoftime_per_shtyp/P_RMBLEDHJEESEANCAVE_GJYQ_SORE-05_TETOR_2023.html

18.15. *Së pari* dhe si premisë e arsyetimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se raporti i subjektit dhe bashkëshortit të saj me kunatin e bashkëshorten e tij [z. M. M. dhe me znj. S. G.] dhe me individët e shoqëritë e tjera, iu nënshtrua vlerësimit të trupit gjykues të Kolegjit për shkak të disa aspekteve që lidhen me mënyrën sesi janë ndërthurur interesat në periudha të gjata kohore, përfshirë edhe pasi subjekti i rivlerësimit ishte emëruar në detyrë apo kishte lidhur martesën ligjore me bashkëshortin⁶³. Një ndër aspektet është edhe momenti pasi ka nisur hetimi penal në ngarkim të kunatit të subjektit dhe bashkëshortes së tij. Analiza dhe vlerësimi u fokusua përtej dhe pa paragjykuar marrëdhënien dhe afrimitetin e natyrshëm familjare, duke u fokusuar në elementët e interesit pasuror e social dhe impaktin që ata kanë për efekt të procesit të rivlerësimit për mënyrën sesi ato perceptohen nga publiku. Në funksion të kësaj analize integrale, trupi gjykues ka analizuar edhe rrethanat e ndërthurjes së interesave të subjektit e bashkëshortit edhe me individët e personat juridikë, që i janë nënshtruar hetimit pasuror nga SPAK.

18.16. *Së dyti*, nga aktet në fashikull⁶⁴, rezulton se në datën 13.11.2020, në Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) është regjistruar procedimi nr. {***}, për veprat penale të *shpërdorimit të detyrës, korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë dhe korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*, parashikuar përkatësisht nga nenet 248, 245 dhe 260 të Kodit Penal. Më datë 21.05.2021, për këtë procedim, është regjistruar edhe emri i bashkëshortes së kunatit të subjektit, znj. S. G., për veprat penale parashikuar nga nenet 245⁶⁵ dhe 287, gjerat “a” dhe “b”⁶⁶ kryer në “në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 25 i të Kodit Penal. Njoftimi publik është bërë më datë 14.12.2021. Ky procedim, në momentin e kryerjes së hetimit administrativ në Komision, ka qenë në fazë hetimi. Nga burimet e hapura rezulton se bashkëshortja e kunatit të subjektit, znj. S. G., z. K. Z., z. A. M. dhe shoqëritë e themeluara/në pronësi/në administrim të tyre që prej vitit 2014 [{"***"} sh.p.k., dhe [{"***"} [{"***"}]⁶⁷ sh.p.k.] ishin nën hetim nga SPAK, që prej korrikut dhe nëntorit të vitit 2020. Çështjet u dërguan për gjykim, në fillim të vitit 2023⁶⁸.

18.17. Kunati i subjektit, z. M. M., nuk ka qenë i regjistruar si person në hetim gjatë kohës kur Komisioni kryente hetimin administrativ për subjektin. Gjatë zhvillimit të procesit në Kolegj, në referim të njoftimit në faqen zyrtare të SPAK⁶⁹, kunati i subjektit u dërgua për gjykim dhe u shpall në kërkim, për veprat penale të *korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, dhe pastrimi e produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*, kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 260 dhe 287/2 të Kodit Penal. Nga

⁶³ Sipas certifikatës së martesës, subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me z. E. M., më datë 29.01.2008.

⁶⁴ Shkresa e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nr. {***} prot., datë 02.06.2022.

⁶⁵ Neni 245 – Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë.

⁶⁶ Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: (a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; (b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; [...].

⁶⁷ Shoqëria [{"***"}] ShPK, sipas njoftimeve të SPAK, është shoqëria që ka përfutur koncesionin, ndërsa shoqëria [{"***"}] ShPK, është shoqëria që ka zbatuar punimet për ndërtimin e objektit të koncesionit.

⁶⁸ <https://spak.al/2022/12/12/njoftim-kerkese-per-gjykim/>; <https://spak.al/2022/12/20/njoftim-per-shtyp-9/>; <https://spak.al/2022/11/16/njoftim-62/>; <https://spak.al/2022/03/29/njoftim-46/>

⁶⁹ <https://spak.gov.al/njoftim-kerkese-per-gjykim/>

njoftimet në faqen e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim “GjKKO”), më datë 05.10.2023⁷⁰, z. M. M., znj. S. G. dhe z. K. Z. janë deklaruar fajtorë dhe janë dënuar për kryerjen e veprave penale “*korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë kryer në bashkëpunim dhe pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale e kryer në bashkëpunim*”. Gjithashtu, të njëjtat vepra penale i janë ngarkuar edhe shoqërive tregtare “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, janë deklaruar fajtorë dhe dënuar nga kjo gjykatë, për të njëjtat vepra penale sikurse edhe është caktuar dënimi i *mbarimit të personit juridik dhe konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit i pasurive*, për të cilat është caktuar masa e sigurimit pasuror *sekuestro preventive*.

18.18. Pa përsëritur sa analizuar gjerësisht në vlerësimin e shkaqeve të ankimit për kriterin e kontrollit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që kunati i subjektit dhe bashkëshortja e tij kanë dhënë kontribut financiar të konsiderueshëm nëpërmjet dhurimit të një vlere prej 1.000.000 lekësh, për apartamentin e blerë nga subjekti e bashkëshorti në vitin 2012, në Fier. Sikurse referuar më sipër, subjekti ka deklaruar si burim të dhurimit shitjen e kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK, nga bashkëjetuesja/bashkëshortja e kunatit të subjektit, znj. G., një individ tjetër të përfshirë në hetimin penal, z. A. M.⁷¹. Po ashtu, marrëdhënia e ngushtë dhe e ndërsjellë, si aspekt kyç i këtij konkluzioni, rezulton edhe nga investimet e përbashkëta të bashkëshortit me vëllanë dhe bashkëjetuesen e tij, analizuar më sipër. Sikurse analizuar gjerësisht në rubrikën për mosdeklarimin e aksioneve në pronësi të bashkëshortit, në shoqërinë “{***}” ShA, ky person juridik ka vijuar të ekzistonte të paktën formalisht deri në maj 2017 dhe prej tij janë deklaruar paga të përfituara nga kunati i subjektit dhe bashkëshortja deri në vitin 2010, deklaruar nga subjekti si një ndër burimet për shumat e dhuruara asaj.

18.19. Në këtë vlerësim, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje edhe punësimin në periudha të ndryshme kohore të personit të lidhur⁷² pranë personave juridikë të themeluar e menaxhuar nga i vëllai e kunata, por edhe personat e tjerë, po ashtu, pjesë e të njëjtit procedim penal. Me fjalë të tjera, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka qenë punësuar në pozicione drejtuese në bizneset të cilët janë objekt i procedimit penal të sipër referuar, për vepra penale që përfshihen në krimin e organizuar. Konkretisht: (i) nga prilli i vitit 2003 deri në shkurt të vitit 2006 ai ka qenë i deklaruar/punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShA, në cilësinë e drejtorit. Më herët, drejtor i kësaj shoqërie ka qenë z. M. M.; (ii) nga prilli deri në dhjetor të vitit 2007, pranë shoqërisë “{***}” ShPK, ku ortakë ishte znj. S. G. dhe z. A. M.; (iii) nga prilli i vitit 2018 deri në prill të vitit 2019 ka qenë i dypunësuar pranë “{***}” ShA, sikurse edhe pranë shoqërisë “{***}” ShPK; si dhe (vi) nga gushti i vitit 2019 deri prill 2022 ka qenë i punësuar pranë “{***}” ShPK. Kjo panoramë e ndërthurjes së punësimeve e angazhimeve rezulton edhe për kunatin e subjektit, z. M. M., kunatën, znj. S. G., si dhe vjehrrin⁷³. Nga këto të dhëna rezulton

⁷⁰https://www.gjp.gov.al/Gjykata_e_Posacme/Njoftime/Njoftime_per_shtyp/P_RMBLEDHJEESEANCAVE_GJYQ_SORE-05_TETOR_2023.html

⁷¹ *Burim i dhurimit të deklaruar në vitin 2011, sipas deklaratës noteriale të nënshkruar nga kunati i subjektit, z. M. M., janë referuar të ardhurat nga biznesi i tij. Subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së dhe në përgjigje të pyetësorëve në Komision, përkatësisht: (i) kontratën e vitit 2007 nëpërmjet të cilës kunata, znj. S. G., ka shitur një pjesë të kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK; dhe (ii) një tjetër kontratë të vitit 2008 të shitjes së kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK, nga znj. S. G. tek z. L. M.; si dhe (iii) vërtetime të punës/pagave të z. M. M. dhe znj. S. G..*

⁷² *Shkresa e ISSh-së nr. {***} prot., datë 25.06.2020, “Kthim përgjigje”.*

⁷³ *Kunati i subjektit të rivlerësimit: (i) nga prilli deri në gusht të vitit 2004 ka qenë i deklaruar/punësuar pranë {***} sh.a; (ii) nga shtatori i vitit 2004 deri në dhjetor të vitit 2010 ka qenë i deklaruar/punësuar pranë “{***}”*

punësim dhe angazhime të përbashkëta, të ndërsjella e të vazhdueshme në këto aktivitete fitimprurëse, karakterizuar nga përfshirja e disa familjarëve njëherësh ose në vend të njëri-tjetrit. Nga këto të dhëna, po ashtu, rezulton punësimi dhe, për pasojë, përfitime financiare të konsiderueshme të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit për të paktën tetë (8) vjet, përfshirë edhe në pozicione drejtuese.

18.20. Në këtë drejtim, trupi gjykues vlerëson të theksojë edhe punësimin e bashkëshortit të subjektit si Drejtor i Sigurisë në shoqërinë “{***}” ShPK, në pronësi të z. K. Z., nga 2018-2022. Referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, datë 15.07.2022, kjo shoqëri është një shoqëri *bijë* e shoqërisë “{***}” ShPK. Po ashtu, personi i lidhur me subjektin ka pasur raporte punësimi me z. M., pranë shoqërisë “{***}” ShPK. Përveçse këta individë janë në kërkim ndërkombëtar dhe janë dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë GjKKO për vepra penale që parashikohen të krimit të organizuar edhe vetë shoqëria “{***}” ShPK është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë GjKKO, sikurse referuar më sipër. Sipas njoftimeve të SPAK, kunati i subjektit është pronar *de facto* së bashku me z. K. Z. i kësaj shoqërie⁷⁴. Ndërsa për bashkëshortin e subjektit marrëdhënia nisi në prill të vitit 2018 – gusht 2022, i cili, sipas deklarimeve të subjektit mbante pozicionin e Drejtorit të Sigurisë dhe paguhej me 387.774 lekë/muaj dhe për vjehrrin e subjektit në janar 2012 – nëntor 2014. Të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e kanë burimin nga këto shoqëri, të cilat u dënuan për veprat penale që përfshihen nën nenin 75/b të Kodit të Procedurës Penale. Marrëdhënia e kunatit të subjektit të rivlerësimit, z. M. M., me këtë shoqëri, referohet të ketë nisur në vitin 2016⁷⁵.

18.21. Nga sa më sipër, rezulton se një ndër marrëdhëniet e punësimit të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, me këta persona juridikë, ka vijuar deri në vitin 2022, që nënkupton përreth dy vite pasi është regjistruar procedimi penal për veprat penale të sipër referuara, sikurse edhe pasi ishte regjistruar emri i bashkëshortes së kunatit të subjektit dhe pasi çështja u soll në vëmendje të publikut [në vitin 2018] apo u depozitua kallëzimi penal nga shoqëria civile [në vitin 2020]. Me fjalë të tjera, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë vijuar të ruajnë marrëdhënie interesash të ndërsjella pasurore e sociale, pavarësisht nga ndodhitë e pasqyruara në media apo kallëzimi penal i kryer. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerësoi edhe udhëtimin e përbashkët të subjektit e bashkëshortit të saj me bashkëshorten e kunatit të subjektit në Vjenë⁷⁶ në janar të vitit 2016 apo përdorimin e automjeteve në pronësi apo të përdorura prej personave në proces hetimi, që nuk janë familjarë të tyre [A. M. dhe K. Z.],

*ShA, në të cilën bashkëshorti i subjektit ishte aksionar. Kunata e subjektit, znj. S. G.: (i) nga tetori i vitit 2004 deri në korrik të vitit 2006 ka qenë e deklaruar/punësuar pranë “{***}” ShA, ku aksionar ishte bashkëshorti i subjektit; dhe (ii) nga qershori i vitit 2006 deri në dhjetor të vitit 2012 ka qenë e punësuar pranë “{***}” ShPK, ku zotëronte edhe kuota. Vjehrrin e subjektit të rivlerësimit ka qenë i punësuar në “{***}” ShPK nga janari i vitit 2012 – janar 2013. Pronar i kësaj kompanie, siç referon SPAK në njoftime dhe sipas gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar, ishte një ndër personat e tjerë të procedura penalisht, z. K. Z.*

⁷⁴ Sipas njoftimit zyrtar të SPAK në: <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-01-08-2023-sekuestrimi-i-integrated-energy-b-v-s-p-v/> “Nga aktet e administruara deri në këtë fazë të hetimit, në lidhje me kontratën e koncesionit [...] datë 31.08.2017 “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vendpозitimeve ekzistuese, Tiranë”, [...] ka rezultuar se shtetasit K. Z. dhe M. M. janë pronarët “de facto” të shoqërisë “{***}” ShPK, e cila ka fituar kontratën koncesionare [...], si dhe janë pronarët “de facto” të shoqërisë mëmë të saj, të themeluar në Holandë, “{***}”, ndryshuar më pas me emrin “{***}”.

⁷⁵ Shkresa e ISSh-së dërguar vëzhguesit ndërkombëtar në Komision nr. {***} prot., datë 21.06.2022.

⁷⁶ Shkresa e Drejtorisë Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e vitit 2020 dhe shpjegimet e subjektit në pyetësinorin standard, ku shprehet për vizitë turistike.

gjatë viteve 2019-2020, sikurse edhe përdorimi i një automjetit në pronësi të personit juridik të dënuar “{***}” ShPK⁷⁷, në përdorim të shoqërisë në të cilën punonte edhe bashkëshorti i subjektit.

18.22. Faktet e mësipërme tregojnë se subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë kultivuar një marrëdhënie që karakterizohet nga distancimi⁷⁸, qoftë edhe për t’u kujdesur për shkak të funksionit zyrtar të saj. Vlerësuar nën dritën e nenit 37, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje që ndonëse nga analiza e mësipërme gjejnë zbatim parashikimet që përcaktojnë rrethana që tregojnë marrëdhënie të afërt, interesa të përbashkëta edhe të natyrës pasurore dhe marrëdhënie jorastësore⁷⁹, fakti që procedimi penal ka ndodhur pasi subjekti ka plotësuar deklaratën e kontrollit të figurës, përbën rrethanë lehtësuese për ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme, në kuptim të nenit 34⁸⁰ të ligjit nr. 84/2016.

18.23. Nga ana tjetër, ndonëse këta individë prezumohen të pafajshëm derisa vendimi i fajësisë të marrë formë të prerë, trupi gjykues e vlerëson stadin procedural të hetimit penal, në tërësinë e gjithë rrethanave, pa peshë përcaktuese nën dritën e vlerësimit integral të perceptimit që publiku duhet të krijojë për funksionarët e drejtësisë. Në këtë konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit thekson, jo vetëm natyrën e ndryshme të procesit të rivlerësimit përkundër atij penal, por edhe faktorët e tjerë të analizuar më sipër e në vijim të këtij vendimi, si pasojë e të cilëve është marrë konkluzioni përfundimtar. Konkretisht, në kushtet që subjekti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe ka rezultuar me probleme në të tria kriteret, edhe në eventualitetin që çështja penale do të ketë një zgjidhje pafajësie për familjarët e saj dhe të bashkëshortit, vlerësimi në tërësi i gjithë rrethanave dhe kriterëve të tjera nuk do të ndryshonte duke mbajtur në konsideratë konkluzionet e tjera në këtë vendim, edhe duke abstraguuar nga fakti se si këto kontakte dhe raporte të ngushta familjare e biznesi mund të ndikojnë teorikisht në punën e subjektit apo në perceptimin e publikut të drejtësisë.

18.24. *Së fundmi*, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se i është cenuar jeta private, për shkak të kryerjes së procesit të rivlerësimit apo vendimmarrjes që bazohet edhe në raportet familjare. Në analizën e kryer, nën dritën e garancive të neni 8 të KEDNj-së dhe në raport me interesin publik dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, hetimi i kryer në këtë proces ka kaluar kontrollin për kushtetutshmërinë kryer qoftë nga Gjykata Kushtetuese⁸¹ apo nga Komisioni i Venecias sikurse edhe atë të kryer nga GjEDNj-ja. Referuar

⁷⁷ Nr. {***} prot., datë 25.07.2022.

⁷⁸ Neni 38, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, parashikon si rrethanë lehtësuese që subjekti i rivlerësimit ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i lidhur me kontaktet dhe është distancuar prej tyre. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me kohëzgjatjen e kontakteve ose me perceptimin e arsyeve të veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit.

⁷⁹ Parashikuar përkatësisht në gerrat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 4 të këtij neni: “[4.] Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur: [...] (b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jo rastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar; 19 (c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar; (ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar; [...]”.

⁸⁰ “Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës”.

⁸¹ Shih vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafët 62-24.

këtyre vlerësimeve e kontrollit të kryer, rezulton që procesi i rivlerësimit është në përputhje me garancitë për kufizimet e ligjshme të parashikuara nga KEDNj-ja dhe është i bazuar në interesin publik. Në çështjen kyç të rivlerësimit, në çështjen *Xhoxhaj v. Shqipërisë*⁸², sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera, është elaboruar gjerësisht, përse qëllimi që kërkohet të arrihet nëpërmjet ligjit nr. 84/2016, ishte në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve, siç përcaktohet në nenin 8, paragrafi 2 të KEDNj-së, për të ulur nivelin e korrupsionit dhe rikthimin e besimit të publikut te drejtësia.

18.25. Në nivelin konkret të pretendimeve të ngritura nga subjekti për procesin e kryer ndaj saj, trupi gjykues vëren, *së pari*, që subjekti e ka ngritur pretendimin për cenim të jetës private vetëm në Kolegj. Me fjalë të tjera, ndërkohë që ky kriter dhe të njëjtat fakte janë hetuar nga Komisioni, sikurse rezulton në faqet 40-43 të vendimit, subjekti nuk rezulton të ketë parashtruar shkelje të nenit 8 të KEDNj-së për hetimin e fakteve të njëjta. Qartazi, këto problematika për të u ngritën vetëm pasi vendimi i Komisionit iu nënshtrua kontrollit të Kolegjit. *Së dyti*, në kushtet dhe rrethanat faktike konkrete, analizës i janë nënshtruar vetëm veprimet e subjektit të rivlerësimit në funksion të krijimit e ruajtjes së interesave të saj pasurore apo ruajtjes së raporteve të ngushta e vazhdueshme sociale përpara dhe pasi familjarët e saj dhe aktivitetet e tyre, në të cilat ishte i punësuar dhe i paguar dhe personi i lidhur me të, i ishin nënshtruar hetimit për vepra penale serioze. Këto ngjarje dhe vijimësia e punësimit të bashkëshortit deri në vitin 2022, në njërin prej kompanive të cilat i janë nënshtruar hetimit penal, nuk mund të argumentohen si cenim i së drejtës së saj për jetën private kundrejt detyrimeve të saj si magjistrate për të ruajtur imazhin e drejtësisë edhe në jetën private.

18.26. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjektit të rivlerësimit nuk i është cenuar jeta private gjatë hetimit të kriterit të figurës apo gjatë procesit të rivlerësimit në tërësi apo që hetimi të ketë qenë disproporcional. Referuar edhe analizës së shtjelluar më sipër, ky konkluzion u përfshi në vlerësimin e përgjithshëm, në drejtim të mënyrës sesi rrethanat e mësipërme afektojnë subjektin në ushtrimin e detyrës apo mënyrën sesi ushtrimi i detyrës prej saj perceptohet nga publiku, sipas pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale

19. Në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, në vijim të gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioni ka hetuar edhe për disa procedime penale që lidhen me: (1) veprimin e subjektit në kushtet e konfliktit të interesit në hetimet me palë shoqërinë “{***}”

⁸² [...] 392. Është e rëndësishme të theksohet se qëllimi i ligjit nr. 84/2016, siç parashikohet në nenin 1, është të “garantojë funksionimin e duhur të shtetit ligjor, pavarësinë e vërtetë të sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut në institucionet e [atij] sistemi” (shih paragrafët 102 dhe 120 më lart). Komisioni i Venecias u shpreh, gjithashtu, se rivlerësimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve “ishte jo vetëm i justifikuar, por i domosdoshëm për të mbrojtur [vendin] nga murtaja e korrupsionit, i cila, nëse nuk trajtohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor” (shih 59 paragrafin 96 më lart). Gjykata Kushtetuese shtoi më tej se çdo kufizim i vendosur nga ligji nr. 84/2016 justifikohet nga interesi publik i uljes së nivelit të korrupsionit dhe i rikthimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, i cili, nga ana tjetër ishte i lidhur me interesat e sigurisë kombëtare, rendit publik dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve (shih paragrafin 175 më lart). 393. Në këto rrethana, GjENDj-ja nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se qëllimi i ndjekur nga ligji nr. 84/2016 në përgjithësi, dhe ndërhyrja në çështjen e kërkueses në veçanti, nuk ishte në përputhje me qëllimet e identifikuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve, siç përcaktohet në nenin 8, paragrafi 2 [...].

ShA/punonjës të saj, si dhe me Bashkinë Fier/punonjës të saj; ashtu edhe (2) mangësitë gjatë kryerjes së hetimeve për zbatimin e elementeve të të drejtës materiale dhe asaj procedurale. Përfundimisht, Komisioni nuk ka konstatuar problematika dhe ka konkluduar se subjekti e arrin nivelin minimal kualifikues, që përcakton neni 59, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

19.1. Mbështetur edhe në rekomandimin e ONM-së, Komisionerja Publike në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe ka treguar mangësi, sipas nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, që lidhen me aftësinë për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime. Po ashtu, sipas Komisioneres Publike, subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Mangësitë e vërejtura, potencoi ajo, duhet të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes, pasi në kuptim të nenit 4, pika 2 lidhur me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit⁸³. Në shkaqet e ankimit, të cilat inkorporojnë nëpërmjet rekomandimit gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, janë potencuar pesë (5) procedime penale, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin.

19.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi aktet në fashikull, pretendimet e Komisioneres Publike dhe shpjegimet e subjektit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, vëren se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit e, konkretisht, në dy procedimet penale që lidheshin me shoqërinë “{***}” ShA. Kjo situatë u konstatua edhe në dy çështje penale për kallëzimet që lidheshin me Bashkinë Fier. Për sa i përket çështjeve të sjella në vëmendje nga ankimi dhe referuar gjetjeve të Vëzhguesit Ndërkombëtar e, konkretisht, aftësisë për të hetuar, për të marrë vendime dhe urdhra, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar se ka treguar mangësi. Këto mangësi të para bashkërisht me gjendjen e konfliktit të interesit, trupi gjykues i vlerësoi si një aspekt përbërës i vlerësimit të përgjithshëm, ndonëse jo të mjaftueshme për të passjellë masë disiplinore veçmas.

III. a. Për situatën e konfliktit të interesit

19.3. Komisionerja Publike pretendon se të dhënat e administruara nga dy procedime penale⁸⁴, ku të kallëzuar janë punonjës të shoqërisë “{***}” ShA, duhen vlerësuar në raport me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Së bashku me mungesën e kujdesit për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit dhe mangësitë e tjera, përbëjnë bazë për vlerësimin në drejtim të cenimit të besimit të publikut. Për të dyja këto çështje, Komisioni, pasi ka hetuar, referuar në Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, ka vlerësuar se nuk provohet asnjë problematikë.

a./1. Procedimi i parë [nr. {***}, datë **12.11.2012**] lidhet me urdhrin e prokurimit të Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë “{***}”, në vitin 2009, për *blerje autosonde me kullë 30 ton*. Pasi pajisja është kolauduar e marrë në dorëzim në vitin 2011, Kontrolli i Lartë të Shtetit (në vijim “KLSH”) ka konstatuar shkelje të punonjësve të cilët e kanë marrë atë në dorëzim. Sipas KLSH-së, autosonda nuk i plotësonte kriteret teknike dhe nuk është dorëzuar në afat. Në vijim, më datë 30.09.2012 KLSH-ja ka bërë kallëzimin për pesë punonjës të shoqërisë “{***}” ShA, për veprat penale të *shpërdorimit të detyrës, në bashkëpunim dhe mashtrimit*. Çështja është ndjekur

⁸³<https://ikp.al/wp-content/uploads/2023/02/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-606-dat%C3%AB-21.12.2022.pdf>

⁸⁴ Përkatësisht, procedimet penale nr. {***} dhe nr. {***}.

nga subjekti i rivlerësimit dhe procedimi penal është regjistruar më datë 12.11.2012. Në datën 29.10.2013, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit në regjistrimin e njoftimit të veprave penale. Pas përfundimit të hetimeve paraprake, më datë 17.03.2014, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për gjykim për disa punonjës në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier. Paraqet rëndësi të veçantë fakti që pasi ka nisur hetimi e, konkretisht, në datën 17.10.2013 bashkëshorti i subjektit është punësuar nga shoqëria “{***}” ShA, në pozicionin e drejtorit të Qendrës së Prodhimit dhe Shpërndarjes [{***}]. Përpara se të niste hetimi, subjekti apo bashkëshorti nuk kishin ndonjë lidhje me shoqërinë. Kjo marrëdhënie pune ka vijuar deri më datë 11.09.2019.

a./2. Procedimi i dytë [nr. {***}, datë **22.06.2015**] është pasojë e një kallëzimi të paraqitur në Drejtorinë e Policisë Fier, nga përfaqësues të dy firmave pjesëmarrëse në një procedurë ankandi të zhvilluar nga shoqëria “{***}” ShA, për veprën penale të *shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera*. Në kuadër të këtij kallëzimi, në datën 26.06.2015, Drejtoria e Policisë Fier ka kryer referimin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Kjo çështje i ka kaluar për ndjekje subjektit të rivlerësimit, e cila më datë 07.07.2015 ka nisur verifikimet paraprake. Në kuadër të hetimit, subjekti kërkoi informacion në shoqërinë “{***}” ShA, në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe në Komisionin e Prokurimit Publik. Më datë 14.10.2015, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe më datë 11.03.2016 ka vendosur pushimin e hetimeve.

19.4. Në zbatim të barrës së provës që i ka kaluar Komisioni, subjekti ka pretenduar se mungonte shkak ligjor për të paraqitur kërkesë për heqje dorë në këto dy çështje, meqenëse bashkëshorti i saj nuk ishte pjesë e drejtorisë që zhvillonte ankandet/tenderat. Prokurori është i detyruar të heqë dorë kur i pandehur është punëdhënësi i bashkëshortit/personit të lidhur. Marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit në shoqërinë “{***}” ShA nuk përbëjnë shkak për konflikt interesi. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti u shpreh se nuk ka hequr dorë nga procedimi penal nr. {***}, pasi ai lidhej me veprime që ishin kryer në vitin 2009 dhe të kallëzuar ishin anëtarë të komisionit të kolaudit, që morën në dorëzim autosondën. Marrëdhënia nuk ka ekzistuar, sipas saj, pasi titullari i institucionit, që ngriti komisionin e kolaudit, nuk ishte administratori/titullari që punësoi bashkëshortin e subjektit. Ndërsa për procedimin nr. {***}, nuk ka vlerësuar se gjendej në kushtet e konfliktit të interesit, pasi shoqëria “{***}” ShA përbëhej nga 16 drejtorë dhe 11 qendra, që kanë kompetenca dhe përgjegjësi të ndara. Bashkëshorti i saj nuk ka qenë pjesë e drejtorisë që ka zhvilluar tenderin/ankandin. Në një rast tjetër [procedimi penal nr. {***}] ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga procedimi dhe është zëvendësuar, pasi të dyshuar ishin vartës të bashkëshortit të saj.

19.4. Sikurse referuar më sipër, bashkëshorti i subjektit është punësuar nga “{***}” ShA, në një pozicion të lartë drejtues⁸⁵, në datën 17.10.2013, ndërsa subjekti ishte duke ndjekur njërin prej këtyre dy procedimeve penale. Kjo marrëdhënie punësimi ka vijuar deri në vitin 2019. Pavarësisht se bashkëshorti i subjektit nuk ishte pjesë e drejtorisë që zhvillonte prokurimet dhe ankandet, nga organigrama e shoqërisë “{***}” ShA⁸⁶, administruar edhe nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se i gjithë personeli ka varësi hierarkike nga administratori. Për pasojë, në detyrën e tij si Drejtor i Qendrës së Prodhimit dhe Shpërndarjes ({***}),

⁸⁵ *Bashkëshorti i subjektit është punësuar si drejtor, pranë Qendrës së Prodhimit dhe Shpërndarjes {***}.*

⁸⁶ https://www.albpetrol.al/wp-content/uploads/2023/11/Organigrama_Albpetrol.pdf.

bashkëshorti i subjektit ishte nën varësinë direkte të administratorit të shoqërisë. Kjo nënkupton edhe që gjatë ndjekjes së këtij procedimi penal, minimalisht në planin teorik mund të ishte e nevojshme pyetja e eprorit direkt të bashkëshortit apo shqyrtimi i urdhrave e udhëzimeve të lëshuara prej tij.

19.5. Në zbatim të nenit 26, i lidhur me nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, prokurorët duhet të paraqesin kërkesë për heqje dorë, për shkaqe të rëndësishme të njëanshmërisë. Po ashtu, nën dritën e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9367/2005”), konflikti i interesit është gjendja e *konfliktit* ndërmjet *detyrës publike* dhe *interesave privatë* të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike. Sikurse Kolegji ka vlerësuar në raste të ngjashme⁸⁷ në interpretim të normave ligjore të sipërcituara, ekzistenca e dyshimeve të arsyeshme e objektive për paanësi është determinante në vendimmarrjen për heqjen dorë të prokurorit.

19.6. Në rrethanat konkrete, edhe duke abstraguuar nga fakti që punësimi në këtë shoqëri u materializua gjatë kohës që praktikantët e tenderimit ishin nën kontrollin e organit të prokurorisë, e çështja caktuar vetë subjektit, vijimi i ndjekjes së çështjes prej saj ngre pyetje të rëndësishme për kryerjen e punës në mënyrë të drejtë⁸⁸, pasi paraqet shkaqe që në pamje të jashtme tregojnë gjendje të konfliktit mes interesave private – punësimi i bashkëshortit – dhe detyrës publike – ndjekja penale dhe detyrat për hetim efikas dhe përkushtim e paanshmëri. Me fjalë të tjera, në kushtet që subjekti heton individë të caktuar brenda shoqërisë dhe praktikën e një tenderimi të kryer, në të cilin sipas KLSH-së ka pasur shkelje të atilla që kanë pasqyruar kallëzimin penal, përpos krijimit të kësaj marrëdhënieje punësimi, vijimi i ndjekjes penale nga subjekti si prokurorja e ngarkuar nga institucioni, paraqet konflikt në dukje interesi. Për rrjedhojë, trupi gjyqësor vlerësoi se subjekti duhet të kishte paraqitur kërkesën për heqje dorë nga hetimi, për të shmangur perceptimin e gjendjes në kushtet e konfliktit në dukje të interesit. Fakti që vepra për të cilën ishte ushtruar kallëzimi kishte ndodhur në vitin 2009, është pa peshë përcaktuese, nën dritën e faktit që subjekti vijoi të ndiqte çështjen dhe dërgoi në gjyq gjashtë punonjës për shpërdorim detyre ndërkohë që bashkëshorti kishte lidhur marrëdhënie punësimi me këtë shoqëri.

19.7. Procedimi tjetër penal me fokus shoqërinë “{***}” ShA [nr. {***}] ishte po ashtu i lidhur me procedurat e prokurimit. Kallëzuesit kanë pretenduar se nuk ishin lejuar nga rojet të merrnin pjesë në një ankand e dorëzuar ofertat e tyre. Pasi regjistroi procedimin për shkelje të barazisë në tendera e ankande, subjekti konkludoi me vendim për pushimin e hetimeve në

⁸⁷ *Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 46/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, Julian Xhengo – paragrafi 90, lidhur me vendimet e GjEDNj-së në çështjet: Ferrantelli dhe Santangelo v. Italy, 1996, § 58; Padovani v. Italy, 1993, § 27 dhe Micallef v. Malta [GC], 2009, § 97.*

⁸⁸ *Neni 3, pika 2 e ligjit nr. 9367/2005, parashikon: [2] “Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësisë” është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit. “[3.] “Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësisë” është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij neni për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit, sipas pikës 1 të këtij neni. [...]”.*

ngarkim të shoqërisë/punonjësve. Komisioni fillimisht konstatoi se subjekti ka kryer hetim me të meta të dukshme përfshirë regjistrimin e vonuar të çështjes (nga qershori në tetor 2015), mosnxjerrja e vendimeve për shtyrjen e veprimeve hetimore çdo tre muaj, vonesa në kryerjen e hetimit për mbledhje informacioni, mosmbledhjen e tabulateve telefonike, mosmbledhja e dëshmive të pjesëmarrësve të tjerë që mbetën jashtë ankandit – nga 10 pjesëmarrës, vetëm një arriti të hynte në ambientet e shoqërisë në kohën e duhur për të marrë pjesë. Sipas Komisionit, subjekti duhet të mos ishte kufizuar me hetimin vetëm të komisionit të ankandit, por duhet të kishte marrë në pyetje edhe administratorin si përfaqësues i autoritetit kontraktor. Në vendimin përfundimtar, Komisioni ka pranuar gjithë shpjegimet e subjektit dhe ka vlerësuar se ajo ka vepruar në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

19.8. Trupi gjykues vëren se konstatimet fillestare të Komisionit qëndrojnë dhe subjekti nuk arriti të përmbyste barrën e provës. Subjekti duket të ketë kryer hetimin jo shterues duke mos kryer një sërë veprimesh hetimore nëpërmjet të cilave do të ishte hedhur dritë e plotë për shkaqet për të cilat nuk u lejuan të hynin e të merrnin pjesë në ankand kallëzuesit, përfshirjen në veprime në mospërputhje me rregullat e drejtuesit/eprorit të bashkëshortit, mbledhjen e dëshmive në kohë, përfshirë edhe ato të individëve të tjerë të cilët u referuan si pjesëmarrës potencialë në ankand. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, këto mangësi dhe moskërkimi i heqjes dorë tregojnë për një sjellje që duket se pasur në kontekst favorizimin e punëdhënësve të bashkëshortit, në raport me individët e tjerë që pretendohet të jenë dëmtuar nga mosmundësimi i pjesëmarrjes në ankand nëpërmjet veprimesh keqbesimi.

19.9. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se është e pabazuar analogjia me qëndrimin e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita (JR) nr. 15/2021. Në atë gjykim, trupi gjykues i ndau situatat ligjore e faktike në dy grupe duke mos konstatuar konflikt interesi në disa raste në të cilat bashkëshortja e subjektit nuk kishte asnjë rol. Ndonëse në rastin konkret, bashkëshorti i subjektit nuk kishte asnjë rol përfaqësues apo vendimmarrës në ngjarjet e ardhura për hetim, situata faktike e ligjore është e ndryshme për dy arsye. *Së pari*, ndryshimi qëndron tek natyra e ndryshme e procedimeve penale kundrejt konfliktit civil/administrativ. Në procedimet penale janë në verifikim fakte penale e veprime të kryera me vullnet për të cilat disponohet me dënim penal individual. Në çështjet administrative të apelit, që shqyrtonte subjekti Kastriot Selita, në pikën fundore eprorët e bashkëshortes nuk mund të argumentohet se do të mbanin përgjegjësi personale e penale në kushtet që konflikti civil/administrativ e institucional ka pasoja financiare kryesisht të pashoqëruara me përgjegjësi personale. Për pasojë, interesat e administratës tatimore, për të cilën punonte bashkëshortja e subjektit, ishin institucionale. *Së dyti*, pozita e bashkëshortes së subjektit në çështjen JR nr. 15/2021 ishte ajo e një punonjëseje të shërbimit civil, me garancitë e pavarësisë në vendimmarrje dhe në kryerjen e tagrave sipas përshkrimit të punës, sikurse edhe me garanci për vijimin e marrëdhënies së punës.

19.10. Në kontrast me atë kuadër garancish, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në çështjen konkrete, ishte teorikisht vulnerabël dhe punësimi i tij i kushtëzuar nga vullneti i eprorit. Teorikisht, kjo mori rrethanash faktike nënkupton që edhe subjekti do të ishte e ndërjegjshme dhe e prirur ta ruante këtë balancë, në dobi të punësimit të bashkëshortit, që passjell edhe pikëpyetje për konfliktin në dukje të interesit në procedimin penal me palë shoqërinë “{***}” ShA. Në kontekstin e vulnerabilitetit të marrëdhënies së punësimit të bashkëshortit, qoftë edhe

në nivel teorik, trupi gjykues thekson edhe faktin që bashkëshorti i subjektit u punësua nga shoqëria “{***}” ShA, vetëm gjatë kohës që ky i fundit/punonjës të tij ishin nën hetim pas kallëzimit të KLSH-së për shpërdorim detyre.

19.11. Këto vlerësime u përfshinë në analizën tërësore, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Ky konstatim u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit në drejtim të vlerësimit tërësor, së bashku me mangësitë në hetimin e çështjes nr. {***}, në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve të duhura hetimore, vendimmarrjes e urdhrave, nën dritën e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, shtjelluar edhe në vijim, referuar ankimit dhe gjetjeve të Vëzhguesit Ndërkombëtar.

19.12. Për situatën e konfliktit të interesit në hetimet me palë përfaqësues të *Bashkisë Fier*, Komisionerja Publike ka sjellë në vëmendje të Kolegjit, bazuar edhe në rekomandimin e ONM-së dhe Gjetjet e Vëzhguesit Ndërkombëtar, se subjekti duhet të kishte hequr dorë nën dritën e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, e cila përbënte arsye për njëanshmëri. Këto mangësi, sipas Komisioneres Publike, së bashku me mangësitë e tjera të vërejtura [që do të trajtohen në seksionin e kontrollit të aftësive të subjektit për të nxjerrë urdhra dhe për të marrë vendime], përbëjnë bazë të mjaftueshme për vlerësimin në tërësi të çështjes, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me pikën 5 të nenit 61 të këtij ligji. Të njëjtin qëndrim, Komisionerja Publike e mbajti edhe gjatë gjykimit në Kolegj.

19.13. Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit për shkak të kredisë së marrë nga Bashkia Fier për hetimet me palë këtë institucion, referuar edhe më sipër në rubrikën që i përket kredisë me kushte lehtësuese [pjesa I.a.2 e këtij vendimi]. Kredia është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak si organ kolegjal dhe nuk është revokuar. Njëkohësisht, arsyetoi Komisioni, subjekti nuk ka ushtruar ndjekje ndaj ndonjë anëtari të Këshillit Bashkiak.

19.14. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se përfitimi i kredisë nuk justifikon pretendimin për mundësinë e qëndrimit paragjykes në hetim, sipas nenit 17 e vijim të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti shpjegoi se nuk ka depozituar kërkesë për heqje dorë nga hetimi, pasi: (i) kishin kaluar 2 vjet nga përfitimi i kredisë; (ii) përbërja e Këshillit Bashkiak kishte ndryshuar pas zgjedhjeve të datës 08.05.2011; dhe se (iii) në këto hetime/procedime nuk ishin të kallëzuar anëtarë të Këshillit Bashkiak që kishin miratuar kredinë me kushte lehtësuese. Sipas subjektit, Bashkia dhe Këshilli Bashkiak janë dy organe të ndryshme. Subjekti shpjegon se hoqi dorë nga procedimi penal nr. {***}, objekt i të cilit ishte konstituimi i Këshillit të Bashkisë Fier. Ndërsa në Kolegj subjekti u shpreh se përfitimi i kredisë me kushte lehtësuese nuk justifikon pretendimin për një qëndrim paragjykes, sipas nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale në hetimin e çështjeve me këtë palë.

19.15. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka trajtuar disa materiale kallëzuese që lidhen me Bashkinë Fier. Ndër to, pasi asaj i është akorduar kredia në kushte lehtësuese në vitin 2011 e në shkelje të dispozitave ligjore, arsyetuar më sipër, e përpara ndryshimeve të passjella nga zgjedhjet vendore të vitit 2015 në organet drejtuese të këtij institucioni, subjekti ka vendosur mosfillimin në dy procedime penale, në dukje në favor të Bashkisë Fier. Në kushtet kur subjekti nuk rezulton të ketë kërkuar dorëheqjen dhe në analizë të mangësive të konstatuara, nën dritën e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, referuar edhe Gjetjeve të Vëzhguesit Ndërkombëtar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ankimi i Komisioneres Publike,

lidhur me këtë çështje, është i drejtë dhe iu nënshtrua vlerësimit të përgjithshëm të Kolegjit. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

19.16. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier nga 28.10.2009 deri më 18.04.2016, kur u transferua dhe emërua në Tiranë. Pasi u kualifikua për kredi me kushte lehtësuese nga Këshilli Bashkiak Fier në vitin 2010, subjekti e ka përfituar atë në vitin 2011. Nga aktet rezulton se subjekti ka paraqitur kërkesë për heqje dorë në një procedim penal të shtatorit 2011⁸⁹, për të evituar një konflikt në dukje të interesit, për shkak: (i) se objekt hetimi ishte konstituimi i Këshillit të ri Bashkiak; dhe (ii) të kohës së afërt të këtij hetimi me përfitimin e kredisë, me arsyetimin se kishte përfituar kredinë nga kjo bashki. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga drejtuesi i prokurorisë, i cili ka urdhëruar subjektin të vijojë hetimet. Në çështje të tjera në vijim me palë Bashkinë Fier apo struktura të këtij institucioni, subjekti nuk ka paraqitur kërkesë për heqje dore nga hetimi.

19.17. Sikurse referohet më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi problematika të ndërthurjes së konfliktit të interesit dhe mangësive në hetime në dy çështje me palë Bashkinë Fier e, konkretisht, dy procedime të kryera në periudhën kohore mes përfitimit e lëvrimit të kredisë e deri në zgjedhjet vendore të majit të vitit 2015, pas së cilave pësoi ndryshim edhe Këshilli Bashkiak. Këto dy procedime janë me nr. {***}⁹⁰ dhe nr. {***}⁹¹, përkatësisht në lidhje me një kallëzim të referuar nga Sektori Kundër Krimin Financiar të Policisë me fokus përdorimin e fondeve të Bashkisë për Ndërtimin e Pallatit të Sportit në qytet dhe një kallëzim nga një individ [z. A. K.] për kryerjen e veprave penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve, nga Bashkia Fier. Në të dyja këto çështje, subjekti ka munguar kryerjen e veprimeve verifikuese dhe përfundimisht ka vendosur mosfillimin e hetimit.

19.18. Në çështjen e parë [nr. {***}], hetimet e kryera nga subjekti kanë konsistuar vetëm në dërgimin e një shkrese me kërkim informacioni bashkisë më 30 prill 2013. Përfundimisht, ndonëse nga aktet rezultonte një vendimmarrje e vonuar e prapavepruese e bashkisë në vitin 2013, për një procedurë të ndodhur në vitet 2011-2012, subjekti ka vendosur mosfillimin pa identifikuar arsyet për praktikën e përdorimit të fondeve publike dhe atyre të mbartura nga vitet e mëparshme nga bashkia, pavarësisht nga informacioni me të dhëna të rëndësishme të referuara nga policia edhe prefekti i fierit.

19.19. Në procedimin tjetër penal [me nr. {***}], subjekti ka marrë vendimin për mosfillim pa kryer asnjë veprim, ndonëse kishte një vendim të Gjykatës së Apelit që ka urdhëruar ndërprerjen e cenimit të së drejtave të pronësisë ndaj kallëzuesit në vitin 2011. Subjekti vendosi mosfillimin pa kryer asnjë hetim, pavarësisht vendimit të Gjykatës së Apelit i vitit 2011, që kishte disponuar për pezullimin e ndërtimit dhe pushimin e cenimit të të drejtave të pronësisë së kallëzuesit, përpos akteve të vitit 1993, sipas së cilave prokuroria kishte konstatuar që nënshkrimet e mbivendosjes së pronave nuk ishin origjinale. Subjekti nuk rezulton të ketë hetuar për falsitetin dhe as për të vlerësuar nëse dëmi pasuror kishte ndodhur për shkak të

⁸⁹ *Procedimi penal me nr. {***}, datë 21.09.2011.*

⁹⁰ *Kallëzim i Drejtorisë Kundër Krimin Financiar, Tiranë për ligjshmërinë e ndërtimit të "Pallatit të Sportit të lojërave me dorë", si dhe me verifikimin e të ardhurave të trashëguara të Bashkisë Fier të vitit 2011.*

⁹¹ *Kallëzimi në fjalë ishte paraqitur për Bashkinë Fier [Drejtorinë e Urbanistikës], për vendime të marra gjatë vitit 2008 për ndërtimin e një objekti banimi 10 katesh. Në kallëzim janë ngritur akuza se ka dy projekteve të ndryshme për të njëjtin shesh ndërtimi, e për pasojë falsifikim ose shpërdorimi i detyrës nga punonjësit e bashkisë.*

veprimtarisë së paligjshme të KRrT-së Fier, sikurse edhe nëse vendimi i gjykatës që kishte urdhëruar bashkinë të respektonte parametrat e ndërtimit ishte respektuar prej kësaj të fundit.

19.20. Sikurse analizuar më sipër, për sa i përket procedurës së përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, procedimet e mësipërme në të cilat subjekti duket se ka favorizuar bashkinë, analizuar së bashku me mangësitë në veprimet hetimore të kryera prej saj, tregojnë minimalisht që subjekti nuk ka kushtuar kujdes të mënjanonte konfliktin e interesit. Nga ana tjetër, nën dritën e dispozitave ligjore që përcaktojnë statusin dhe detyrat e organeve kolegjiale⁹², trupi gjykues arsyeton se shpjegimet e subjektit, se në këto çështje *nuk ka qenë i kallëzuar anëtar/Këshilli Bashkiak dhe se Bashkia e Këshilli Bashkiak janë dy organe të ndryshme*, janë përpjekje sipërfaqësore nëpërmjet të cilave subjekti mënjanon përgjegjësinë. Organet kolegjiale të administratës shtetërore janë subjekte të së drejtës publike që ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë kolegjiale. Sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, organi përfaqësues i bashkisë është Këshilli Bashkiak. Nga gjuha e ligjit rezulton se bashkia është institucioni, ndërsa Këshilli Bashkiak është organi përfaqësues i saj. Këshilli Bashkiak funksionon sipas kompetencave ligjore dhe për interesa të bashkisë. Subjekti e ka bërë aplikimin në Bashkinë Fier, pasi funksionimi i organeve të saj (dhe i Këshillit Bashkiak) është në funksion të qytetarëve në atë bashki. Organi ekzekutiv i bashkisë është Kryetari i Bashkisë⁹³. Në këtë kuptim, Këshilli Bashkiak është organ dhe përfaqësues i bashkisë. Personalitet juridik në kuptim të këtij ligji ka bashkia. Në këtë kontekst, shpjegimet e subjektit, ashtu sikurse edhe konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka proceduar asnjë anëtar të Këshillit Bashkiak, nuk janë të bazuara. Në këtë kuptim, institucioni dhe përfaqësuesi nuk mund të analizohen si dy institucione të ndryshme.

19.21. Në përmbledhje të sa më lart, në vlerësim të trupit gjykues, trajtimi i materialeve kallëzuese, që lidheshin me veprime të kryera përpara ndryshimeve të passjella nga zgjedhjet vendore të vitit 2015 në organet drejtuese të Bashkisë Fier dhe pas akordimit të kredisë me kushte lehtësuese në vitin 2011, në shkëlqje të dispozitave ligjore, përbën gjendje të subjektit në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit. Gjendur përpara faktit që subjekti nuk kërkoi dorëheqjen nga këto dy raste dhe në analizë të mangësive të konstatuara, nën dritën e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, analizuar në vijim, referuar edhe Gjetjeve të Vëzhguesit Ndërkombëtar, trupi gjykues vlerëson se ankimi i Komisioneres Publike, lidhur me këtë çështje, është i drejtë dhe u mbajt në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm.

III.b. Aftësitë e subjektit për të kryer veprimet hetimore

- 20.** Komisionerja Publike parashtroi në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj se subjekti i rivlerësimit ka kryer hetim me të meta të dukshme procedurale në pesë çështje penale, përfshirë edhe ato që lidhen me “{***}” ShA dhe Bashkinë Fier (analizuar më sipër në drejtim të konfliktit të interesit). Sipas saj, mangësitë në kryerjen e veprimeve hetimore, mungesës së arsytimit ligjor apo aftësisë për të marrë urdhra e vendime, duhen vlerësuar në raport me përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Së bashku

⁹² Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

⁹³ I njëjti parashikim ishte edhe në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

me vendimmarrjet e subjektit në kushtet e konfliktit të interesit, këto konstatime, sipas Komisioneres, përbëjnë bazë të mjaftueshme për vlerësimin për cenim të besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit.

20.1. Nga verifikimi i çështjeve të parashtruara në ankim, si dhe referuar Gjetjeve të Vëzhguesit Ndërkombëtar, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit në disa raste ka treguar mangësi në drejtim të identifikimit të saktë të normës juridike dhe të respektimit të disa prej rregullave procedurale penale, që përfshijnë, ndër të tjera, moszbatim të *afateve të hetimeve* paraprake dhe moszbatim të afatit të *verifikimeve* paraprake. Ndër to, veçohen: (i) procedimi penal nr. {***}, me të kallëzuar punonjës të shoqërisë “{***}” ShA, në të cilin konstatohen shkelje të afateve të veprimeve; (ii) arsyetimi mbi bazën e të cilit subjekti ka vendosur mosfillimin e një kallëzimi penal tjetër [kundër ish-gjyqtarit A. B.], në dukje me një arsyetim sipërfaqësor që zhvlerëson të drejtën e individëve për të ushtruar të drejtën e kallëzimit; si dhe (iii) procedimi penal me nr. {***} – analizuar pjesërisht edhe më sipër në kontekstin e konfliktit të interesit – për të cilin subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor. Po ashtu, në disa nga çështjet e referuara në ankim, subjekti rezulton të mos ketë treguar diligjencë në ndërmarrjen e veprimeve të duhura hetimore, për të mbledhur prova të mjaftueshme apo për shtyrjen e afatit të hetimeve. Këto mangësi, të para bashkërisht me gjendjen e konfliktit të interesit, trupi gjykues i vlerësoi si një aspekt përbërës i vlerësimit të përgjithshëm, ndonëse jo të mjaftueshme për të passjellë masë disiplinore veçmas.

20.2. Për procedimin penal nr. {***} dhe përpos sa është përmbledhur e arsyetuar më sipër, subjekti ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit thuajse katër (4) muaj pasi ka marrë kallëzimin nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, që nënkupton në shkelje të qartë të afatit për verifikim fillestar prej 30 ditësh, parashikuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar (në vijim “Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm”)⁹⁴. Konkretisht, kallëzimi [për veprën penale të *shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera*] i është dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në datën 26.06.2015, ndërsa subjekti ka kryer regjistrimin e saj në datën 14.10.2015. Ndërkohë, ajo rezulton të kishte nisur verifikimet paraprake më datë 07.07.2015, nëpërmjet kërimit të informacionit në shoqërinë “{***}” ShA, në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe në Komisionin e Prokurimit Publik. Më datë 14.10.2015, subjekti ka vendosur regjistrimin e veprës penale dhe pas 6 muajsh hetime paraprake dhe afërsisht 9 muajsh nga referimi në prokurori, më datë 11.03.2016, ka vendosur pushimin e hetimeve.

20.3. Pasi ka hetuar për mangësitë në hetimin e kësaj çështjeje, Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit dhe konkluduar se veprimet e saj dhe hetimet janë kryer në përputhje me dispozitat procedurale e nuk konstatohet problematikë për kriterin profesional. Komisioni i ka gjetur bindëse shpjegimet e subjektit, qoftë për mungesë të konfliktit të interesit apo për mënyrën e procedimit.

⁹⁴ 2.3 Gjatë periudhës 30-ditore, të parashikuar në pikën 2.2 të këtij Udhëzimi, prokurori, kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Gjatë kësaj periudhe, prokurori, nuk kryen veprime hetimore nga ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

20.4. Komisionerja Publike, bazuar edhe në rekomandimin e ONM-së, potencon se përfundimi i Komisionit për këtë çështje nuk është rrjedhë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe rrethanave. Subjekti ka treguar mangësi gjatë kryerjes së hetimeve. Hetimi mund të përfshinte edhe persona të tjerë përveç atyre të hetuar, përfshirë eprorin e bashkëshortit të subjektit, administratori i shoqërisë. Sipas ankimit dhe rekomandimit të ONM-së, subjekti nuk ka kryer hetime substanciale nga momenti i marrjes së kallëzimit [në qershor], deri më 14.10.2015, kur vendosi të regjistronte çështjen. Po ashtu, pretendimi për mungesë të limit kohor për të verifikuar kallëzimin, meqenëse nuk kishte autor për t'i atribuuar veprën penale, nuk qëndron në kushtet që kallëzimi u bë kundrejt rojeve të shoqërisë “{***}” ShA. Në drejtim të veprimeve hetimore të munguara në këtë procedim, rekomandimi specifikon që subjekti duhet të kishte nxjerrë regjistrimet telefonike, sipas deklarimeve të palëve, si dhe të kishte marrë në hetim, *ex officio*, administratorin e shoqërisë “{***}” ShA.

20.5. Në procesin e zhvilluar në Kolegj, subjekti theksoi ngarkesën e konsiderueshme në punë, duke specifikuar se në vitin në fjalë ajo ka trajtuar 533 çështje penale, përpos ngarkesës në Njësinë e Përbashkët Hetimore. Afati 30-ditor i Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nuk përbënte afat procedural, sipas përcaktimit të nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, tejkalimi i tij këtij afati nuk rezulton të ketë sjellë ndonjë pasojë dhe as lidhje me mungesën e veprimeve të kryera nga subjekti. Kohëzgjatja ishte pasojë e pritjes së përgjigjeve për kërkesat për verifikime. Mungesa e vendimit të *zgjatjes* së hetimeve ka ndodhur për shkak se vepra penale ishte pa autor dhe sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale regjistrimi kryhej në momentin në të cilin rezulton emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale. Neni 323, pika 1 e këtij Kodi nuk gjente zbatim në rastin konkret, pasi nuk kishte autor të shënuar në regjistrin e njoftimeve.

20.6. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i Komisioneres është i bazuar dhe hetimi i subjektit rezulton me disa të meta, edhe duke marrë në konsideratë ngarkesën në punë të përballuar prej saj në periudhën kohore konkrete. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mban në konsideratë disa aspekte. *Së pari*, udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm përcaktonte që gjatë afatit prej më së shumti 30 ditëve, prokurori duhet të verifikojë vetëm për të përcaktuar nëse ka rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal⁹⁵ dhe, nëse është rasti, të shënojë emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Në rrethana specifike, kur *është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësorë të faktit dhe/ose të elementëve të figurës së veprës penale*⁹⁶, afati mund të zgjatet 30 ditë. Mospërmbushja e këtyre detyrimeve, sipas pikës 5 të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, përbën shkelje disiplinore. Nga sa më sipër, rezulton që në procedimin konkret vendimi që subjekti ka marrë në tetor 2015 duhet të ishte marrë më së fundmi në fund të korrikut 2015. Në të njëjtën linjë, prapësimet e subjektit se shkelja e këtyre detyrimeve nuk ka passjellë asnjë problematikë dhe nuk jemi përpara afateve procedurale është e pabazuar, pasi në bazë të ligjit të kohës, urdhrat

⁹⁵ Kodi i Procedurës Penale, në nenin 290 - Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, parashikon: - 1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur: (a) personi ka vdekur; (b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale; (c) mungon ankimi i të dëmtuarit ose ai e tërheq ankimin; (ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston; (d) vepra penale është shuar; (dh) është dhënë amnisti; (e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

⁹⁶ https://www.pp.gov.al/Legjislacioni/Akte_Nenligjore/Udhezime_te_Prokurorit_te_Pergjithshem, paragrafi 2.2, Udhëzimi nr. 241/2005.

e udhëzimet e prokurorit më të lartë ishin të detyrueshme për zbatim⁹⁷, ndërsa vonesa në dhënien e një qartësie për procedimin penal ishte me rëndësi qoftë për palët, ashtu edhe në dobi të hedhjes dritë mbi faktet e aluduara, duke mënjeluar efektin e kohës. *Së dyti*, referuar procesverbalit të Oficerit të Policisë Gjyqësore, kallëzuesit janë shprehur se janë penguar nga përgjegjësi i rojeve të objektit e që kallëzimi ka për objekt anëtarët e komisionit të ankandit dhe individë që ishin/mund të ishin përgjegjës për kryerjen e veprës penale të pretenduar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se vepra ishte pa autor nuk pasqyron plotësisht realitetin në kushtet që regjistrimi është kryer për persona të cilëve u atribuohet vepra penale⁹⁸. Nenet 323 e 324 të Kodit të Procedurës Penale përcaktojnë që çështja dërgohet për gjykim/pushim ose pezullim, brenda tre (3) muajve nga data në të cilën shënohet emri i personit që i atribuohet vepra penale dhe deri në dy vjet, për hetimet komplekse. Në çdo rast, prokurori duhet të nxjerrë urdhër për zgjatjen e afatit të hetimeve.

20.7. Po ashtu, duke abstraguuar nga fakti që teorikisht subjekti mund të vendoste për pezullim hetimesh, nëse pretendimi për padijeni autorësh të veprës penale pranohet, rezulton që subjekti nuk ka kryer hetime shteruese në zbulimin e autorëve. Subjekti nuk ka hetuar tabulatet telefonike të individëve të pranishëm në ditën e ankandit apo pyetur personat e tjerë të interesuar për të marrë pjesë në ankand për vërtetësinë e fakteve të pretenduara nga kallëzuesit. Në përmbledhje të këtyre aspekteve, vonesat procedurale, të shoqëruara me mungesën e hetimeve të duhura për përgjegjësinë individuale duke përfshirë edhe zyrtarët e shoqërisë “{***}” ShA, me të drejtë janë konsideruar si mangësi në hetimet e subjektit nga Komisionerja Publike, pasi shkaktojnë pengesë në mbledhjen e fakteve të pamanipuluara nga koha, të deklarimeve në kohë reale dhe të pashtrembëruara nga kujtesa, të cilat vështirësojnë zgjidhjen e çështjes dhe evidentimin e fajtorëve.

20.8. *Së treti*, në vendimin e pushimit të hetimit, subjekti ka referuar legjislacion që në atë moment ishte i shfuqizuar. Konkretisht, subjekti i është referuar ligjit nr. 7971, datë 26.07.1995, “Për prokurimin publik” dhe VKM-së nr. 335, datë 23.06.2000, “Për rregullat e prokurimit publik” dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 01.01.1996, “Për prokurimin publik” (në vijim UKM nr. 1/1996). Procedura e prokurimit (ankandit) nga “{***}” ShA është zhvilluar në vitin 2015. Duke filluar nga 1 janari 2007, ligji i sipër referuar ishte shfuqizuar dhe zbatohet një ligj tjetër, ai me nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”⁹⁹. Po ashtu, në vitin 2008, ka hyrë në fuqi ligji nr. 9874, datë 14.02.2008, “Për ankandin publik” (në vijim ligjit nr. 9874/2008) dhe VKM-ja nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, ndryshuar. Këto akte janë ende në fuqi. Nga sa më sipër, rezulton se kuadri ligjor që gjente zbatim nga autoritetet kontraktore/“{***}” ShA ishte ai që rregullonte procedurat e ankandit dhe jo të prokurimit publik – sikurse ka referuar subjekti.

⁹⁷ Ndër të tjerë, neni 3/c i ligjit nr. 8737 “Për organizimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, i shfuqizuar nga ligji nr. 97/2016.

⁹⁸ Në kuptim të Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3/2002: “[...] termi “person të cilit i atribuohet vepra penale” i marrë në kontekstin e nenit 287 të K.Pr.Penale plus momentin procedural në të cilin përdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe as me termin “i pandehur”. Emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur kallëzuesi mendon se e di se kush është autori i krimit. Por kjo nuk do të thotë se ai është vërtet autor i veprës penale [...]”.

⁹⁹<https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Ligji-PP- nr- 9643 date 20 11 2006 i- ndryshuar 22.pdf>

20.9. Procedura e ankandit është e ndryshme nga procedura e prokurimit publik. Në referim të ligjit nr. 9874/2008, ankandi ka për qëllim shitjen publike dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pjesëmarrjeve në ankand, rritjen e eficiencës, nxitjen e pjesëmarrjes së blerësve në procedurë, *sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për pjesëmarrësit në procedurë* dhe sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e ankandit publik. Nga ana tjetër, prokurimi publik mbulon një fushë tjetër -- blerjen e mallrave, punëve apo shërbimeve – dhe jo shitjen. Për sa më lart, subjekti nuk ka identifikuar saktë legjislacionin që rregullonte situatën faktike në dy aspekte. Po ashtu dhe me të njëjtën peshë, vlerësohet nga trupi gjykues edhe fakti që nëpërmjet referimit në pikën 2 të UKM-së¹⁰⁰, për delegimin e kompetencave, subjekti ka arritur të shmangë hetimin e Drejtorit të Përgjithshëm të “{***}” ShA. Nga ana tjetër, në legjislacionin e zbatueshëm për ankandin [VKM nr. 1719/2008], në pikën 5/a parashikohet se: *“a) Titullari i autoritetit shitës ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës së ankandit”*. Të gjitha aktet janë të nënshkruara nga titullari, njëherësh edhe eprori i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Sipas këtij parashikimi, ai është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës. Nga aktet në dosje, nuk rezulton ndonjë autorizim apo akt i delegimit të kompetencave për organizimin dhe realizimin e kësaj procedure ankandi, gjë që e bën të pabazuar referimin e subjektit në pikën 2 të UKM-së. Mbi të gjitha, nga kjo analizë, rezulton se shpjegimet e subjektit janë jobindëse, sikurse edhe të pambështetura në ligj e prova, ndërsa konstatohet që është shmangur nga hetimi titullari i entit kontraktor, që ka rezultuar me pasoja favorizuese për të [titullarin]. Kjo mangësi në identifikimin e normave ligjore në këtë hetim u vlerësua nga trupi gjykues edhe nën kontekstin e veprimeve të kryera nga subjekti në kushtet e konfliktit të interesit.

20.10. *Kallëzimi penal nr. {***} kundër ish-gjyqtarit A. B. është sjellë në vëmendje të Komisionit nga një denoncues¹⁰¹. Çështja u regjistrua më datë 20.5.2020 për veprat penale mashtrim, fshehje e aseteve, shpërdorim detyre dhe refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje apo deklaram i rremë i pasurisë dhe i interesave private¹⁰². Trajtimi i këtij kallëzimi iu caktua subjektit të rivlerësimit. Më datë 28.5.2020, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me argumentin se nëse do të ishin konstatuar elementë të veprës penale, kallëzimi do të paraqitej nga komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përmbushje të detyrimit që rrjedh nga neni 281¹⁰³ i Kodit të Procedurës Penale, si dhe me arsyetimin se fakti nuk është parashikuar si vepër penale. Subjekti argumentoi se ndërsa hetimi i kryer nga Komisioni¹⁰⁴*

¹⁰⁰ Në pikën 2, të UKM-së përcaktohet mënyra e delegimit të kompetencave nga Kryetari i Entit Prokurues, si dhe objekti i prokurimit, fondi limit, procedura dhe emërohen anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Detyrat e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave janë të detajuara në kapitullin IV të UKM-së, të cilat janë në zbatim të nenit 32 “shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”. KVO-ja ka përgjegjësinë e përzgjedhjes së ofertës më të leverdishme, duke u bazuar në kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit në përputhje me nenin 32 të ligjit nr. 7971/1995.

¹⁰¹ Z. F. D..

¹⁰² Parashikuar përkatësisht nga nenet 143, 143/a/6, 248 dhe 257/a të Kodit Penal.

¹⁰³ Neni 281, kallëzimi nga nëpunësit publikë.

¹⁰⁴ Subjekti i rivlerësimit iu referua pjesës konkluzionit të vendimit të Komisionit, sipas së cilit gjyqtari A. B.: (1) u konstatua me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet për vitet 1991-2016; (2) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të të ardhurave; (3) ka bërë deklaram të pasakta dhe të rreme të pasurisë dhe burimeve të ligjshme; (4) ka bërë deklaram të pamjaftueshme në lidhje me kriterin e vlerësimit të aseteve, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016; (5) nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme burimet e ligjshme të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur, sipas nenit D të Kushtetutës; dhe (6) ndodhet në situatë konflikti interesi.

synon të rivendosë besimin e publikut te organet e drejtësisë, anëtarët e asaj trupe gjyquese nuk kanë paraqitur asnjë kallëzim penal për gjetjet e tyre. Gjithashtu, ajo theksoi faktin që rasti ishte në shqyrtim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

20.11. Përfundimisht, Komisioni ka vlerësuar se kjo çështje ka në themel vendimmarrjen e magistrates dhe arsyetimin e saj bazuar në bindjen e brendshme. Pa konkluzion konkret për rastin, por në vlerësimin përfundimtar për aftësinë profesionale, Komisioni ka konkluduar se nuk konstatoi shkelje dhe subjekti ka arritur nivel minimal kualifikues.

20.12. Në mbështetje të rekomandimit të ONM-së, Komisionerja Publike parashtron se mungesa e hetimeve nga subjekti i rivlerësimit është e pajustificuar dhe duhet të vlerësohet në përputhje me pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Po ashtu, Komisionerja Publike argumenton se me veprimet e saj, subjekti i rivlerësimit, nuk ka mbajtur në konsideratë të drejtën/detyrën individuale për të ushtruar kallëzim, sipas nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale. Interpretimi i subjektit në këtë rast shmang edhe hetimin e fakteve të kallëzuara. Mbështetur edhe në rekomandimin e ONM-së, Komisionerja Publike potencon se subjekti nuk e ka përmbushur barrën e provës. Veprimet e subjektit përbëjnë një mungesë të pajustificuar të veprimeve hetimore.

20.13. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti shpjegoi se nga konkluzionet e Komisionit në procesin e rivlerësimit të ish-gjyqtarit A. B. rezulton se fakti i pretenduar nuk përmban elemente të veprës penale, pasi *duhen të gjenden të konsumuar elemente të kryerjes apo moskryerjes së veprimeve të kundërligjshme me dashje, duke dëmtuar, ndër të tjerë, interesa të shtetit*. Kallëzuesi nuk e ka ankumuar këtë vendim dhe vendimmarrja e saj është në linjë me atë të prokurorëve të tjerë në raste të ngjashme.

20.14. Nga analiza e akteve në fashikull dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjyqësor i Kolegjit konstaton se pretendimi i Komisioneres Publike është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit ka kryer një interpretim sipërfaqësor e formal të elementëve të anës subjektive/objektive të veprave penale, por pa kryer hetime apo një analizë të pavarur të fakteve të paraqitura nga kallëzuesi. Arsyetimi i subjektit është sipërfaqësor edhe për shkak të referencës/kushtëzimit të veprimeve hetimore nga ana e saj meqenëse mungon një kallëzim nga Komisioni, pasi bie ndesh me mundësinë/detyrimin e shtetasve për të bërë kallëzime penale, bazuar në nenin 283 të Kodit Penal. Neni 283 parashikon që *çdo person që ka marrë dajeni për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë* atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm. Në të njëjtën kohë, Kolegji vlerëson se pavarësisht shpjegimeve të subjektit që veprimtaria e saj kontrollohet nga gjykata, gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrolli i veprimtarisë së subjekteve kryhet në kuadër të vlerësimit të aftësive të tyre për të konkluduar në drejtim të aftësive për të interpretuar ligjin apo ndërmarrë veprime hetimore. Po ashtu, interpretimi i subjektit ka sjellë si pasojë shmangien nga hetimi i fakteve të kallëzuara dhe përfundimisht moshedhje dritë mbi mundësinë e përgjegjësisë penale të z. A. B. për faktet e parashtruara nga denoncuesi brenda një harku kohor i cili i nënshtrohet afateve të parashkrimit. Së fundmi, për sa më sipër, edhe konkluzioni i Komisionit në vendim është i pabazuar në ligj dhe përbën anashkalim të detyrimeve ligjore të këtij organi të rivlerësimit për të hetuar aftësinë profesionale të subjekteve bazuar në indikatorë të qartë e të mirëpërcaktuar, që në rastin konkret parashikohen në pikat 2 e 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

20.15. Përpos sa është arsyetuar më sipër në drejtim të *konfliktit të interesit*, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi disa mangësi të subjektit në drejtim të kryerjes së veprimeve hetimore në të paktën dy çështje të tjera të thirrura për analizë nga Komisionerja Publike e, konkretisht, kallëzimin penal nr. {***} dhe atë me nr. {***}, me palë Bashkinë Fier. Në të dy këto raste, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Çështja e parë lidhet me një kallëzim penal të referuar për mënyrën e përdorimit të fondeve publike nga Bashkia Fier në vitin 2013 për ndërtimin e Pallatit të Sportit nëpërmjet një procedure të ndodhur në vitet 2011-2012. Dispozitat ligjore në fuqi¹⁰⁵ përcaktonin që fondet e mbartura transferohen në vitin pasardhës dhe miratohen me vendim të këshillit, në rastin konkret, të Këshillit të Bashkisë Fier. Çështja e dytë lidhej me kryerje veprash penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve, pretenduar nga një individ, i cili ka potencuar cenimin e të drejtave të tij pronësore nga Bashkia Fier. Ndërsa një pjesë e analizës për aspektet e konfliktit të interesit të pretenduara në veprimet e subjektit në këto çështje, në këtë pjesë shtjellohen aspektet nën dritën e indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, për aftësitë profesionale të subjektit për të kryer hetime e arsyetuar vendimmarrjen e saj.

20.16. Nga analiza e veprimeve dhe arsyetimit mbi të cilin është bazuar vendimi i mosfillimit për çështjen e parë, rezulton se subjekti ka treguar mangësi, qoftë në arsyetimin e vendimmarrjes së saj për mosfillimin, bazuar përgjithësisht në informacionin e referuar nga policia dhe gjetjet e kontrollit të ushtruar nga prefekti¹⁰⁶, apo edhe në mungesën e kryerjes së veprimeve të duhura hetimore. Subjekti nuk ka arsyetuar sesi e ka vlerësuar vendimmarrjen prapavepruese të majit 2013 të Bashkisë Fier për një procedurë të kryer vitin e mëparshëm, sikurse as nuk ka arsyetuar mungesën e hetimeve për pretendimet për përdorimin në mënyrë të paligjshme të fondeve të trashëguara pa një akt të organit kompetent.

20.17. Subjekti duket të jetë mjaftuar vetëm me konstatimin se përdorimi i fondeve pa miratim të këshillit *është kompetencë e pushtetit vendor përdorimi i të ardhurave të trashëguara*. Hetimi dhe arsyetimi i subjektit mbi bazën e të cilës vlerësoi se vepra penale nuk ekziston përmban të meta të dukshme. Në kushtet që sipas ligjit që gjen zbatim¹⁰⁷, çdo shkelje, me përjashtim të atyre që përbëjnë vepër penale, përbën kundërvajtje administrative, subjekti duhet më së paku të argumentonte nëse ishin përdorur këto fonde pa miratim të këshillit dhe nëse kishin sjellë dëm ekonomik. Shpjegimi i subjektit se vendimmarrja e saj është kontrolluar dhe lënë në fuqi nga Drejtuesi i Prokurorisë nuk përjashton atë vetë nga përgjegjësia për kryerjen e detyrave me dilijencë. Në këtë rast, përpos mangësive që subjekti ka treguar në drejtim të zbatimit të standardeve të hetimit, sipas pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, trupi

¹⁰⁵ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 39, paragrafi i fundit parashikon: “Të ardhurat e buxhetit vendor [...] të papërdorura gjatë vitit buxhetor, trashëgoohen në vitin buxhetor pasardhës”. Në nenin 71 të këtij ligji, është përcaktuar që çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë [...]. Neni 19 i ligjit nr. 8652/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, pika 5, parashikonte: “[5.] Buxheti i çdo njësie të qeverisjes vendore miratohet nga këshilli përkatës. Miratimi i buxhetit dhe i bilancit të tij mbyllet, bëhen në afatet e përcaktuara në ligjin nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”.

¹⁰⁶ Sipas Prefektit të Qarkut Fier, kishte dyshime se përdorimi i të ardhurave të trashëguara për Bashkinë Fier ishte bërë pa miratim të Këshillit Bashkiak.

¹⁰⁷ Neni 29 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

gjykues mbajti në konsideratë edhe çështjen e konfliktit të interesit me Bashkinë Fier, që lindi nga përfitimi i kredisë me kushte lehtësuese pa plotësuar kriteret ligjore.

20.18. *Kallëzimi penal nr. {***}, për shpërdorim detyre dhe mashtrim është ushtruar nga një individ [z. A. K.] për dy projekte ndërtimi që, sipas tij, janë miratuar në shkelje të ligjit nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Fier, në favor të një kompanie ndërtimi. Gjykata e Apelit në vitin 2011 kishte vendosur anulimin e vendimit të KRRT-së Fier, duke dhënë detyrime konkrete për Bashkinë Fier për të respektuar distancën dhe që ndërtimi të ndiqte parametra që nuk cenonin të drejtën pronësore të kallëzuesit [moshapja e dritareve]. Pavarësisht nga ky vendim gjyqësor, sipas kallëzuesit, disa projekte të dorëzuara në vitin 2014 nga Bashkia Fier për të njëjtin ndërtim që prek pronën e tij paraqisnin ndryshime nga aktet e nxjerra nga kryetari i bashkisë gjatë korrespondencës së tyre për të njëjtën çështje gjatë viteve 2009-2011 e, për pasojë, dyshime për konsumim të veprave penale të shpërdorimit të detyrës apo falsifikimit. Më 24.06.2014, subjekti ka vendosur mosfillim të procedimit penal, me arsyetimin që fakti i parashtruar në kallëzim nuk përmban elementet e ndonjë veprave penale. Sipas analizës së subjektit, dëmi që mund t'i vijë kallëzuesit duke i cenuar hapësirën mund të zgjidhet me padi për shpërbllim dëmi, pasi kjo është marrëdhënie juridiko-civile.*

20.19. *Në vijim të parashtrimeve të Komisioneres Publike në ankim, vlerësimi i kryer në Kolegj u fokusua në drejtim të mangësisë në hetimin e akuzave të kallëzuesit, në raport me standardet e vendosura në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, për sa i përket aftësisë për të marrë urdhra dhe vendime. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime të besueshme për çështjet e ngritura e, konkretisht, për vendimin e mosfillimit nëpërmjet të cilit nuk ka marrë në konsideratë dyshimet për cenim të të drejtave të pronësisë sikurse as nuk ka vijuar hetimet për falsitet aktesh¹⁰⁸ në kushtet që kishte vendim gjykate ku konstatohet se nënshkrimet nuk janë origjinale e kallëzimi lidhet me falsitet dokumentesh. Gjithashtu, në kushtet e provimit të dëmit me akt ekspertimi, subjekti duhet të verifikonte nëse dëmi kishte ardhur për shkak të veprimtarisë së paligjshme të KRRT-së Fier. Këto aspekte mungojnë si parakushte të vendimmarrjes për mosfillim marrë prej saj. Po ashtu, subjekti duhet të kishte hetuar nëse ishte zbatuar vendimi i Gjykatës së Apelit që kishte detyruar Bashkinë Fier që *faqja e ndërtimit e cila prekte kallëzuesin të ishte kallkan në të gjithë lartësinë dhe të respektojë distancën 1 metër*, në kushtet që kallëzuesi pretendonte se ndërtimi vinte në kundërshtim me këtë vendim.*

20.20. *Shpjegimet e subjektit gjatë procesit të kryer në Kolegj ishin jobindëse edhe as shteruese për mungesën e hetimeve. Subjekti në thelb pretendoi se çështja kishte ndjekur rrugën gjyqësore, pretendimet për falsitet janë pjesë e shqyrtimit gjyqësor, sipas nenit 195 të Kodit të Procedurës Penale¹⁰⁹ dhe kallëzuesi nuk është ankuar ndaj vendimit të mosfillimit, i cili është lënë në fuqi nga drejtuesi i prokurorisë. Në kushtet kur rezulton qartë një linjë arsyetimi e saj që anashkalon thelbin e kontestimit në prokurori për falsitet dokumentacioni dhe moszbatim të ndërgjegjshëm të urdhrat të mëparshëm të gjykatës, si pasojë e të cilave kallëzuesi pretendonte se i ishin shkaktuar dëme nga veprime të paligjshme, subjekti paraqet mungesë të aftësive për të hetuar, sipas pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Edhe ky rast u mbajti në*

¹⁰⁸ *Për këto dy projekte ndërtimi që dyshohen për falsitet, Prokuroria e Rrethit Fier kishte kryer një hetim dhe në vitin 1993 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fierit ka konstatuar që nënshkrimet e mbivendosjes nuk janë origjinale.*

¹⁰⁹ *Gjykata, kur çmon se një dokument i marrë është fals, pas përfundimit të procedimit njofton prokurorin duke i dërguar dhe dokumentin.*

konsideratë në vlerësimin tërësor të subjektit, pasi duket se hetimet janë në favor të Bashkisë Fier, veprime këto që janë rrjedhë e përfitimit në kundërshtim me ligjin të kredisë me kushte lehtësuese nga subjekti.

20.21. Nga verifikimi i çështjeve të sjella në vëmendje nga ankimi dhe referuar gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtim të identifikimit të saktë të normës juridike, të respektimit të disa prej rregullave proceduralë penale, që përfshijnë, ndër të tjera, moszbatim të afateve të hetimeve paraprake, moszbatim të afatit të verifikimeve paraprake, në rastin e kallëzimit nr. {***}, me të kallëzuar punonjës të shoqërisë “{***}” ShA, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 241/2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, që përbënte shkelje disiplinore. Përpos problematikës së identifikuar në mosfillimin e kallëzimit penal kundër ish-gjyqtarit A. B., në dukje me një arsytim sipërfaqësor e të munguar të dispozitave mbi të cilat bazohet kallëzimi e që zhvlerëson të drejtën e individëve për të ushtruar të drejtën e kallëzimit, në disa nga çështjet e referuara në ankim, subjekti rezulton të mos ketë qenë e vëmendshme për të ndërmarrë veprimet e duhura hetimore edhe pas kryerjes së regjistrimit të procedimit penal, mbështetur në rrethanat që diktonin kryerjen e veprimeve hetimore, për të mbledhur prova të mjaftueshme apo për shtyrjen e afatit të hetimeve. Këto mangësi, të para bashkërisht me gjendjen e konfliktit të interesit, trupi gjykues i vlerësoi si një aspekt përbërës i vlerësimit të përgjithshëm, ndonëse jo të mjaftueshme për të passjellë masë disiplinore veçmas.

21. Në përmbledhje të sa më lart, në një vlerësim tërësor të çështjes, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me pikën 5 të nenit 61 të po këtij ligji, trupi gjykues vlerëson të mbajë në konsideratë elementet e mëposhtëm:

(a) për kriterin e vlerësimit të pasurisë: (i) pamundësinë e personit tjetër të lidhur, vjehrrit të subjektit për dhënien e huasë për blerjen e apartamentit në Fier; (ii) përftimin e kredisë me kushte lehtësuese në kundërshtim me kriteret ligjore; (iii) shitjen e apartamentit në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm nr. 9232/2004; (iv) mosdeklarimin e zotërimit të aksioneve në shoqërinë “{***}” ShA; si dhe (v) pasaktësinë e deklarimit të vlerës së pagës së bashkëshortit;

(b) për kriterin e kontrollit të figurës, kontaktet faktike të papërshtatshme u mbajtën në konsideratë në drejtim të mënyrës sesi rrethanat e afektojnë subjektin në ushtrimin e detyrës apo mënyrën sesi ushtrimi i detyrës prej saj perceptohet nga publiku; si dhe

(c) për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, u mbajt në konsideratë veprimi në kushtet e konfliktit të interesit në çështjet me palë shoqërinë “{***}” ShA – në të cilën ishte punësuar personi i lidhur dhe në çështjet me palë përfaqësues të Bashkisë Fier përpara ndryshimeve të zgjedhjeve vendore të vitit 2015 – të ndikuara nga përfitimi i kredisë me kushte lehtësuese, shoqëruar me mangësitë e konstatuara në respektim të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

22. Përfundimisht, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të tria kriterëve të rivlerësimit, e sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet e papërshtatshme për të vijuar detyrën, pasi rrethanat faktike e ligjore të konstatuara, cilësohen sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji, në drejtim të cenimit të besimit të publikut. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa ka vendosur Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se vendimi nr. 606, datë

21.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet të ndryshohet dhe subjekti i rivlerësimit të shkarkohet nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në germën “b” të pikës 1 të neni 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 606, datë 21.12.2022, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 29.01.2024.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi